

Dr. Avzi Mustafa

ZHVILLIMI I SHKOLLËS FILLORE SHOQIPÉ  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË  
1945-1975

Dr. Avzi Mustafa

ZHVILLIMI I SHKOLLËS FILLORE SHQIPE  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË  
1945-1975

*Logos-A*

Shkup, 1998

Recensent

*Dr. Nexhat Abazi*

*Dr. Gjylimsere Kasapi*

Të gjitha mendimet dhe pikëpamjet e autorit  
nuk janë doemos edhe të botuesit

СИР – Каталогизација во публикација Народна и  
Универзитетска библиотека “Климент Охридски” – Скопје

373.3(497.17)1945/75

MUSTAFA, Avzi

Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975 / Avzi Mustafa. -  
Shkup: Logos-A, 1998. - 200 str. : 23 cm. - (Biblioteka Libri shkollor)

Фуспоги кон текстот. Summary. – Библиографија: стр. 188-198

ISBN 9989-601-71-2

а) Основно воспитание и образование - Развој - 1945-1975

Dr. Avzi Mustafa

---

ZHVILLIMI I SHKOLLËS FILLORE SHQIPE  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 1945-1975

# **PËRMBAJTJA**

---

PARATHËNIE.....	9
-----------------	---

## **I**

1. RRETHANAT SHOQËRORE-POLITIKE DHE EKONOMIKO-KULTURORE PAS ÇLIRIMIT, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË MBI POZITËN E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI .....	11
2. RRETHANAT ARSIMORE NË MAQEDONI ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË SHKOLLIMIN E SHQIPTARËVE.....	20
3. DETERMINIMI I ZHVILLIMIT TË SISTEMIT EDUKATIV-ARSIMOR TË SHKOLLIMIT .....	25
3.1. TRADICIONALIZMI .....	26
3.2. ZHVILLIMI I ARSIMIT TE MAQEDONASIT.....	29
3.3. ZHVILLIMI I MENDIMIT TEORIK DHE I KËRKESAVE PEDAGOGJIKE .....	31

## **II**

1. ETAPAT E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS NË RS TË MAQEDONISË .....	35
2. ARSIMI SHQIP SI PJESE INTEGRALE E SISTEMIT EDUKATIVO-ARSIMOR NË MAQEDONI.....	38
3. SPECIFIKAT E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS SHQIPE .....	41
3.1. GJUHA AMTARE (SHQIPE) DHE LETËRSIA.....	42
3.2. GJUHA MAQEDONASE .....	43
3.3. HISTORIA KOMBËTARE .....	44
4. PROBLEMET PËRCJELLËSE TË SHKOLLËS FILLORE SHQIPE .....	46
4.1. NËNÇMIMI I SHKOLLËS - PËRKATESISHT "Ç'NA DUHET SHKOLLA" .....	47
4.2. VIJIMI I MËSIMIT FETAR .....	48
4.3. RRJETI SHKOLLOR .....	50
4.4. FORMIMI I KUADRIT ARSIMOR .....	51

<b>5. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE .....</b>	<b>53</b>
<b>5.1. SHKAPËRDERDHJA E NXËNËSVE .....</b>	<b>60</b>

### **III**

<b>1. PROCESI I HAPJES DHE I PLANIFIKIMIT TË SHKOLLËS FILLORE SHQIPE .....</b>	<b>67</b>
<b>1.2. REFORMAT SHKOLLORE DHE SHKOLLA FILLORE SHQIPE GJATË TYRE.....</b>	<b>73</b>
<b>2. ORGANIZIMI I SHKOLLËS FILLORE PËR PAKICAT .....</b>	<b>79</b>
<b>2.1. RRJETI I SHKOLLAVE FILLORE.....</b>	<b>82</b>
<b>3. PLANPROGRAMET MËSIMORE .....</b>	<b>89</b>
<b>4. TEKSTET SHKOLLORE .....</b>	<b>98</b>
<b>4.1. MJETET MËSIMORE.....</b>	<b>101</b>
<b>5. AKTIVITETET E LIRA .....</b>	<b>103</b>
<b>5.1. PUNA E DOBISHME SHOQËRORE NË SHKOLLË.....</b>	<b>107</b>
<b>5.2. KOOPERATIVAT E NXËNËSVE .....</b>	<b>108</b>
<b>5.3. ORGANIZATAT E NXËNËSVE .....</b>	<b>109</b>
<b>5.4. BASHKËSIA SHKOLLORE DHE KLASORE E NXËNËSVE .....</b>	<b>111</b>
<b>5.5. MBLEDHJET PRINDËRORE .....</b>	<b>112</b>
<b>5.6. ROLI I SINDIKATËS NË PUNËN E SHKOLLËS .....</b>	<b>113</b>

### **IV**

<b>1. KUADRI ARSIMOR.....</b>	<b>117</b>
<b>1.1. BURIMET E KUADRIT ARSIMOR .....</b>	<b>119</b>
<b>1.2. HAPJA E SHKOLLËS SË PARË NORMALE SHQIPE .....</b>	<b>121</b>
<b>1.3. AKADEMIA PEDAGOGJIKE DHE KATEDRA E GJUHËS SHQIPE....</b>	<b>125</b>
<b>2. NGRITJA PERMANENTE PROFESIONALE-PEDAGOGJIKE E KUADRIT ARSIMOR .....</b>	<b>128</b>
<b>2.1. ROLI I SHËRBIMIT ARSIMOR-PEDAGOGJIK NË PËRSOSJEN E KUADRIT ARSIMOR .....</b>	<b>132</b>
<b>2.2. PROVIMET SHTETËRORE-PROFESIONALE TË MËSUESISË .....</b>	<b>134</b>

### **V**

<b>1. QEVERISJA SHOQËRORE NË SHKOLLË .....</b>	<b>137</b>
<b>1.2. KËSHILLI I SHKOLLËS .....</b>	<b>140</b>
<b>1.2.1. PËRBËRJA, MËNYRA E ZGJEDHJES DHE LIGJSHMËRIA NË PUNËN E KËSHILLIT TË SHKOLLËS .....</b>	<b>140</b>
<b>1.3. KËSHILLI I ARSIMTARËT .....</b>	<b>141</b>
<b>1.4. DREJTORI (UDHËHEQËSI) I SHKOLLËS.....</b>	<b>142</b>
<b>1.4.1. UDHËHEQJA ME ADMINISTRATËN SHKOLLORE.....</b>	<b>143</b>
<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>145</b>

SUMMARY .....	149
SHTOJCAT .....	153
Shtojea nr.1 .....	153
Shtojea nr.2 .....	154
Shtojea nr.3 .....	155
Shtojea nr.4 .....	156
Shtojea nr.5 .....	157
Shtojea nr.6 .....	159
Shtojea nr.7 .....	165
Shtojea nr.8 .....	174
Shtojea nr.9 .....	174
Shtojea nr.10 .....	178
Shtojea nr.10a .....	179
Shtojea nr.11 .....	179
Shtojea nr.12 .....	180
Shtojea nr.13 .....	180
Shtojea nr.14 .....	181
Shtojea nr.15 .....	182
Shtojea nr.16 .....	182
Shtojea nr.17 .....	184
BIBLIOGRAFIA .....	188
<i>LËNDA ARKIVORE DHE LITERATURA .....</i>	188
A. E CITUAR .....	188
B. E KONSULTUAR .....	196



## PARATHËNIE

Lënda e këtij punimi është studimi i rrugës zhvillimore të shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 1945-1975. Për t'u përcaktuar në këtë punë, pa dyshim ndikoi dëshira që të ndriçohet kjo periudhë që ka baticat dhe zematicat e një sistemi që duam apo s'duam ta pranojmë si realitet.<sup>1</sup>

Ashtu si në të gjithë lëmenjtë e veprimit shoqëror-politik, po ashtu edhe në lëmin arsimor, shoqëria jonë ka kaluar një rrugë të gjatë të mundimshme në drejtim të realizimit të asaj që e krijoj.

Menjëherë pas Lufitës së Dytë Botërore u vunë parimet themelore të politikës arsimuese në fryshtën e një sistemi të ri socialist. Që vitet e para, kjo politikë arsimuese filloi të ndërtohet mbi parimet e një politike të atillë, ku nëpërmjet shkollës do të formojë qytetarë të ardhshëm dhe të dëgjueshëm të një sistemi të ri socialist. Edhe populli shqiptar në këtë drejtim në bazë të asaj që iu dha, hyri në këtë rrugë të arsimimit të qenies së vet, ashtu siç u gjet me të gjitha karakteristikat si individ dhe si kolektiv në këtë bashkësi të re. Ai, së bashku me nacionallitetet tjera të Jugosllavisë, u nis drejt realizimit të aspiratave shumë të pritura dhe të proklamuara në dokumentet partiake si dhe ato ligjore, në zhvillimin e vet të lirë dhe ngritjen kulturore në përgjithësi në kuadër të bashkësisë maqedone dhe jugosllave.

Përpjekja për të hedhur sadopak drithë mbi një periudhë 30 vjeçare, në të cilën janë trajtuar problemet më të ndieshme të organizimit të shkollës me mësim në gjuhën shqipe në R. e Maqedonisë, është një punë shumë e vështirë.

Qëllimi i këtij punimi është ta përfshijë rrugën e konsolidimit dhe zhvillimit të arsimit fillor të shqiptarëve në R. e Maqedonisë gjatë viteve 1945-1975.

Shkollimi fillor shqiptar, si pjesë e pandarë e shkollimit të përgjithshëm jugosllav, në sistemin socialist edhe pse ka pasur shumë specifika të zhvillimit të vet, është zhvilluar dhe mbështetur në konцепционet ideologjike dhe shkencore të bashkësisë jugosllave.

<sup>1</sup> Ky punim është paraqitur si tezë e magistraturës dhe punuar sipas sugjerimeve të prof. dr. Mihailo Ogrizoviç (mentor) dhe mbrojtur në Zagreb (1981) para komisionit në përbërje: prof. dr. Nedelko Kujunxhiç, prof. dr. Vlladimir Poljak dhe prof. dr Nikica Niksha Soljan.

*Jemi munduar që në kuadër të sistemit edukativ-mësimor të bashkësisë jugosllave ta shikojmë shkollimin fillor shqiptar në Maqedoni me të gjitha specifikat e veta nëpër vite e dekada, të cilat janë po ashtu lëndë e këtij punimi.*

*Duke marrë parasysh pikën nistore dhe atë që arriti shkolla shqipe deri në vitin 1981, që janë rezultate që nuk duhet të mohohen, por megjithatë mund të thuhet se ekzistojnë edhe probleme që kanë qenë dhe janë evidente gjatë zhvillimit, si: lokal shkollor, shkapërderdhja e nxënësve, struktura kualifikuese e kuadrit arsimor, rrjeti shkollor etj. Këtyre çështjeve në këtë punim u është kushtuar kujdes i posaçëm.*

*Studimit të shkollimit fillor në këtë periudhë i jam qasur me shqyrtim kritik, rëndom duke marrë parasysh punimet e publikuara në revistat tona pedagogjike, në gazetat e përditshme, si dhe dokumentet e organizatave shoqërore-politike. Si material themelor kam shfrytëzuar dokumente origjinale arkivore që gjenden në Arkivin e Maqedonisë në Shkup<sup>1</sup> - Fondi i Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë, mandej në arkivat e disa shkollave, materialin nga Sekretariati Republikan i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës në Shkup, memoaret e disa mësuesve të vjetër, nxënësve dhe punëtorëve arsimorë që kanë shërbyer në vende të ndryshme, analet shkollore etj.*

*Ky punim jep material të bollshëm për një qasje analitike-komparative dhe për studimin e zhvillimit të shkollimit fillor të shqiptarëvet në R. e Maqedonisë, duke shfrytëzuar metodën statistikore dhe metodën deskriptive. Gjithashtu i kam shfrytëzuar bisedat me individë të ndryshëm si mësues, drejtore, inspektorë, këshilltarë etj., dhe të gjithëve u jam mirënjohës.*

*Meqë ky punim është i pari i këtij lloji, mendoj se deri diku do t'i kontribuojë shkencës pedagogjike, gjithsesi do t'i ndihmojë gjeneratës së re të njoftohet me procesin e zhvillimit të shkollimit në gjuhën mësimore shqipe në R. e Maqedonisë gjatë viteve 1945-1975.*

*Autori*

---

<sup>1</sup> Arkivi shtetëror i Maqedonisë m' i dha në disponim dokumentet arkivore deri në vitin 1959. Pas këtij viti materiali nuk është i megulluar dhe u nënshtrohet disa obligimeve ligjore. Është shfrytëzuar edhe materiali i SR për Arsimit, Shkencës dhe Kulturë në Shkup.

# I

---

## 1. RRETHANAT SHOQËRORE-POLITIKE DHE EKONOMIKO-KULTURORE PAS ÇLIRIMIT, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË MBI POZITËN E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI

Eshtë vështirë që të mund të përshkruhen në disa faqe rrethanat në të cilat jetonte populli shqiptar në mes dy luftërave botërore. Ajo periudhë nëpër të cilën kaloi populli shqiptar nën okupimin e Serbisë imbetet e pashlyeshme në vetëdijen e shqiptarëve sepse politika e saj ishte politikë e shfarosjes fizike, grabitjeve, dëbimit me dhunë, kolonizimit dhe asimilimit. Prandaj, lufta katërvjeçare që bënë popujt e Maqedonisë bashkë me shqiptarët, ishte një shpresë e madhe se njëherë e përgjithmonë do të çrrënjoset padrejtësia politike dhe sociale.

Luftërat i kanë bërë masat e gjera popullore të udhëhequra nga Partia Komuniste, duke besuar në sistemin e ri ekonomik shoqëror, në barazinë nationale, në zhvillimin e drejtë dhe të barabartë të arsimit dhe kulturës së shqiptarëve me etnikumet tjera që jetonin në Maqedoni, gjegjësisht në Jugosllavinë e atëhershme.

Sloganet e ndryshme dhe programet e PK në luftën katërvjeçare, nuk parashihnin vetëm luftën për ta përzënë okupatorin, por një farkëtore të vërtetë të vëllazërim-bashkimit.

Më 29.IX.1943 u mor vendimi historik me të cilin federalizmi jugosllav mori formën e tij të plotë. Vendimet e Mbledhjes II të AVNOJ-it që u morën në Jajce, pra deklaratat e AVNOJ-it, që kishin vlerën e karakterit kushtetues, parashihnin që “Jugosllavia të ndërtohet

mbi parimin demokratik-federal si bashkësi shtetërore e popujve të barabartë”<sup>1</sup>.

Këto vendime të AVNOJ-it filluan t'i zbatojnë të gjitha republikat, kështu që më 2.VIII.1944 u mbajt mbledhja e parë e ASNOM-it në Maqedoni, në të cilën u vunë themelet e shtetit maqedonas, në shtetin e ri demokratik jugosllav.

Në mbledhjen e tij të parë, mbajtur më 6.VIII.1944, Kryesia miratoi konkluzionet për formimin e tetë komisariateve, në mesin e të cilave u formua edhe Komisariati për Arsim.

Në këtë mbledhje u morën disa vendime të rëndësishme, ndër të tjera edhe Deklarata me të cilën “garantohet liria dhe barazia e çdo qytetari në Maqedoni, pa dallim feje, kombësie dhe përkatësie politike, e drejta për çdo qytetar të moshës mbi 18 vjet për të zgjedhur dhe të jetë i zgjedhur, liria e vetëdijes, konfesionit fetar, e drejta për arsim pa pagesë” etj.<sup>2</sup>

Me ASNOM-in fillon një epokë e re në historinë e popullit maqedon dhe shqiptar dhe pakicave të tjera të Maqedonisë, të cilët shekuj me radhë ndajnë fatin e njëjtë.

Pas shkatërrimit të plotë të fashizmit, për herë të parë populli maqedonas dhe të ashtuquajturat pakica shqiptare dhe turke fituan lirinë<sup>3</sup> dhe bashkërisht u nisen për të ndërtuar socializmin. Ashtu sikurse të gjitha kombet dhe pakicat në Jugosllavi, edhe shqiptarët në Maqedoni filluan të verifikohen në procesin e revolucionit socialist.

Pra, zhvillimi i shqiptarëve, në të gjitha sferat e zhvillimit shoqëror, politik dhe kulturor, ishte i garantuar me Kushtetutën e vitit 1946, të cilën e miratoi Republika Popullore e Maqedonisë, ku në nenin 12 thuhet: “Pakicat kombëtare në Republikën Popullore të Maqedonisë i gëzojnë të drejtat dhe mbrojtjen e zhvillimit të tyre kulturor dhe përdorimin e lirë të gjuhës së tyre”.<sup>4</sup>

Pushteti i ri popullor, përmes organizatave shoqërore e politike, në krye me PKJ-në, PKM-në, Frontin Popullor, Lidhjen e Sindikatave, Lidhjen e Rinisë, FAG-un, mori mbi vete detyra të rëndësishme në mënyrë që urgjentisht të ndërtohet dhe të ngrihet në aspektin kulturor,

<sup>1</sup> Mbledhja e Parë dhe e Dytë e AVNOJ-it, “Stvarnosti”, Zagreb 1963, f.207;

<sup>2</sup> ASNOM-i, Përbledhje dokumentesh, 1942, 1964, INI, Shkup, 1964, f.271;

<sup>3</sup> Në këtë punim do të përdoren termat ashtu siç janë përdorë në kushtetutat. Sipas Kushtetutës së 31 dhjetorit 1946, shqiptarët dhe turqit janë quajtur pakica nationale, kurse sipas Kushtetutës së vitit 1963 është përdorë termi edhe pakica edhe kombësi, kurse si kombësi janë quajtur me Kushtetutën e vitit 1974

<sup>4</sup> Kushtetuta e RPM-së, “Gazeta zyrtare” e RPM-së, Shkup, 1945;

arsimor dhe ideologjik. Ndër të tjera, si detyra më të rëndësishme ishin:

1. Që sa më shpejt të arsimohet populli përmes hapjes së shkollave fillore katërvjeçare, shtatëvjeçare dhe shkollave profesionale.
2. Të organizohen kurse analfabetike, të ngrihet niveli i përgjithshëm kulturor-arsimor.
3. Të transformohetjeta shoqërore, kultura të zhvillohet mbi parime marksiste, rinia të edukohet në fryshtë socialiste dhe të kapërcehen format e vjetra ideologjike-reakzionare të jetës.
4. Të ngrihet industria, bujqësia etj.

Të gjitha këto detyra filluan të zgjidhen në sistemin e ri socialist. Si gjë e parë dhe më e rëndësishme duhet theksuar se ekzistonte prapambetja shoqërore dhe ekonomike, e cila akoma rëndonte në ndërgjegjen e njeriut.

Maqedonia, për shkak të pozitës së saj gjeografike, kishte qenë një vend në të cilin në të kaluarën janë kryqëzuar ndikime dhe interesa të ndryshme, në të cilat pushtues të ndryshëm kishin imponuar jetën e rëndë.

Maqedonia e paraluftës ishte një nga viset më të prapambetura, jo vetëm në Jugosllavi, por edhe në tërë Evropën. Meqë baza ekonomike ka qenë e dobët, prapambetja ka qenë vazhdimisht e pranishme. Baza e dobët ekonomike në këto vise ka kushtëzuar mosdijeninë, konservatorizmin, paragjykimet religioze, pabarazinë etj. Në mesin e pakicës shqiptare, e cila po ashtu ka jetuar nën këto kushte ekonomike, ka pasur analfabetë, fanatikë, gjakmarrje etj.

Pas 1944/45 filloj i ashtuquajturi Revolucion ideologjik dhe kulturor. Nga radhët e partizanëve, në zonat e çliruara, sipas direktivave partiake filluan të organizohen kurset analfabetike, u formuan grupe dramatike etj.

Me fitoren definitive mbi fashizmin, kombet dhe të ashtuquajturat pakica nationale iu qasën ndërtimit dhe realizimit të rendit të ri socialist, realizimit të marrëdhënieve të reja shoqërore, ndërtimit të vetëdijes njerëzore. Populli, duke u mbështetur në forcat e tij, në mënyrë të palodhshme dhe me entuziazëm të madh filloj t'i përtërijë themellet e atdheut të shkatërruar. Vetë populli me besim dhe me punën e pakursyer filloj të krijojë vepra të mëdha, të cilat për gjeneratat e reja me shekuj do të jenë dëshmi se njeriu në liri dhe në një sho-

qëri humanitare është i aftë të ndërtojë: hidrocentrale, ujësjellës, fabrika, shkolla, spitale, të cilat do t'i shërbejnë popullit.

Parimet e proklamuara qysh gjatë luftës, tanë shndërrohen në vepër, siç janë:

- arsimimi pa pagesë;
- në shkollat e pakicave mësimi të zhvillohet në gjuhën amtare;
- PKJ-ja gjatë luftës “në sferën e edukimit dhe arsimimit është udhëhequr nga teoria revolucionare marksiste, e cila ia doli ta zbatojë dhe realizojë në mënyrë të mençur në situatën konkrete historike të luftës së popujve tanë për çlirimin e tyre nacional dhe social dhe krijimin e shtetit të ri demokratik”<sup>1</sup>. Një nga parimet më të rëndësishme që u krijuar gjatë luftës, ishte vëllazërim-bashkimi ashtu dukshëm dhe i preferueshëm nga pushteti i atëhershëm ndërmjet kombeve dhe pakicave nacionale të Jugosllavisë.

Gjatë luftës dhe pas saj, në RP të Maqedonisë filloj të zhvillohet një betejë për çrrënjosjen e analfabetizmit dhe ngritjen kulturore të popullit. Problemi i parë me të cilin u ballafaquan në rrugën e realizimit të barazisë në edukim dhe arsimim, ishte çrrënjosja e analfabetizmit të popullsisë. V.I.Lenin, duke i kushtuar rëndësi të madhe përhapjes së arsimimit të punëtorëve, shkruan: “... Në vendin e analfabetëve është e pamundshme të ndërtohet shoqëria komuniste”<sup>2</sup>.

Puna në arsimimin e shqiptarëve zhvillohej përmes shumë formave dhe metodave të ndryshme, që në fillim dukeshin se janë forma të dhunës e jo të arsimimit, meqë shqiptarit i dukej se edhe ky sistem është jo i drejtë sepse ai mendonte se së pari duhej të sigurohej buka e pastaj shkolla. Sipas regjistrimit të popullsisë të datës 25.IX deri më 05.X.1946, te pakica shqiptare në RP të Maqedonisë kishte 90 për qind analfabetë<sup>3</sup>. Edhe në fillim, e sidomos me miratimin e Planit pesëvjeçar në të gjithë lëmenjtë, e po ashtu edhe në në atë të arsimit, në viset ku ishte e koncentruar dhe jetonte pakica shqiptare organizohen kurse analfabetike, hapen salsa leximi, biblioteka, formohen grupe kulturore-artistike, shfaqen filma me tematikë të ndryshme etj.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Dr. M. Ogrizoviq, Parimet themelore të shkollës dhe arsimit në revolucionin populor “Pedagogika stvarnost”, Novi-Sad, 1957, Vepra të zgjedhura, Kultura, 1980, Bleni 14 - f.415-416;

<sup>2</sup> Lenin, I.V. Polnoe Sobr.Sobr.t.41, f.315;

<sup>3</sup> Si analfabetë konsideroheshin edhe ata që dinin vetëm të nënshkrueheshin;

<sup>4</sup> L. Lazarov, Format e aktivitetit arsimor - kulturor dhe artistik të organizatave shoqërore-politike në RPM dhe rezultatet e tyre (1944-1948), Shkup, 1978, f.322;

Me ndërrimin revolucionar të marrëdhënieve shoqërore pas luftës, shqiptarët bashkë me popujt tjerë në Maqedoni dalëngadalë filluan t'i jepin një dimension të ri jetës në kushtet e reja të sistemit politik-shoqëror.

Sipas Kushtetutës së vitit 1946, Maqedonia proklamohej se është atdhe i maqedonasve, shqiptarëve, turke dhe të gjithë së bashku duhet të kontribuojnë për zhvillimin e saj në çdo pikëpamje. Qysh në vitin e parë të pasluftës, në Maqedoni u zbatuan masat shtetërore, siç janë: reforma agrare, nacionalizimi i industrisë dhe xehetarisë, elektrifikimi i vendit etj.

Për realizimin efikas të këtyre masave, Kuvendi Popullor miraton projektin e Planit pesëvjeçar për periudhën 1947-1951<sup>1</sup>, periudhë kjo gjatë së cilës vendi filloi të ndërtohet me plan. Kujdes të veçantë pushteti i kushtoi çrrënjosjes së analfabetizmit, i cili sidomos te pakica shqiptare sillej deri 90 për qind.

Maqedonia e re, e përcaktuar për rrugën e zhvillimit socialist, filloi tërësisht të merret me realizimin e interesave nacionale (atyre maqedone, shqiptare, turke dhe të grupeve tjera etnike). Qytetarëve u garantohej me ligj e drejta juridike dhe politike si dhe arsimimi në të gjitha nivelet.

Në vitin 1947/48 mësuani shkrim-lexim rreth 12.013 shqiptarë të shtresave të ndryshme sociale, duke përfshirë fshatarët, punëtorët industrialë. U formuan 196 kurse ndërkaq, për arsimimin e pjesëtarëve të pakicës shqiptare, punonin edhe nga tre kurse në një rreth të njëjtë. Dëshira e shqiptarit që ta mësojë alfabetin e tij ishte tepër e madhe, ndaj në disa rrethe u tejkalua plani i paraparë.

Barra e arsimimit dhe e ngritjes kulturore të kombeve dhe pakicave ra mbi organizatat shoqërore-politike: Frontin Popullor, FAG-un, Organizatën Rinore, Sindikatën, organizatat shoqërore, që punonin sipas direktivave të LKM-së. Fushata zhvillohej edhe më tutje, në mënyrë që sa më shumë të arsimohen të rinjtë dhe punëtorët që punonin në objekte të mëdha ndërtimore. Problemi i analfabetizmit ishte më i theksuar te femra shqiptare, e cila në numër tejet të vogël iu përkushtua këtyre kurseve. Komisionet dhe aktivet, si dhe këshillat popullore, nuk iu qasën me përgjegjësi dhe me seriozitet kësaj fushatë<sup>2</sup>. Për t'i përballuar këto pengesa kërkohej angazhim i madh, me-

<sup>1</sup> Realizimi i planit pesëvjeçar dhe raporti ndaj tij paraqiste kriter për patriotizmin jugosllav;

<sup>2</sup> Dimçe Levkov, Lufta kundër analfabetizmit në Republikën Popullore të Maqedonisë, Knizhevne novine, dt.08.VI.1948;

qenëse për socializmin analfabetizmi ishte një nga armiqtë kryesorë, që qëndron para njeriut dhe në përgjithësi para shoqërisë. Duke folur për këtë, Lenini ndër të tjera ka thënë: "Njeriu analfabet qëndron jashtë politikës. Duhet së pari mësuar alfabetin. Pa këtë nuk ka politikë, pa këtë ekziston vetëm ajo më thae - të thashë, intriga, përralla, paragjykimi, por jo edhe politika"<sup>1</sup>.

Analfabetizmi te femra shqiptare ishte edhe më tutje i pranishëm. Në kurset analfabetike në qytete mund të gjendej edhe ndonjë femër, por në fshatra haseshin vetëm pak, nga shkaku se femra shqiptare ishte përjashtuar ngajeta për shkak të burrit, fanatizmit, Kanunit etj. Gjithashtu si pengesë paraqiteshin disa udhëheqës religjioz<sup>2</sup>, traditat e ndryshme, fanatizmi nga ana e burrit. Femra shqiptare trajtohej vetëm si "rob shtëpie", kurse në familje konsiderohej vetëm si mjet për punë dhe "për shtimin e familjes"<sup>3</sup>.

Roli shoqëror dhe pozita e femrës janë tregues të sigurt të zhvillimit të përgjithshëm të çdo shoqërie. Për këtë Fourier që moti ka thënë: "Shkalla e emancipimit të femrës është masë e natyrshme për emancipimin e përgjithshëm shoqëror"<sup>4</sup>.

Fryma e re socialiste nuk i përfshiu disa shqiptarë. Ata nuk lejuan që t'i kaplojë impulsi i jetës së re socialiste, të tërhoqen nga traditat dhe zakonet e deriatëhershme dhe të hapërojnë sa më shpejtë në drejtim të progresit material dhe arsimor. Këto ishin disa familje shqiptare që e ruanin konservatorizmin dhe rezervimin ndaj çdo gjëje që ishte e re dhe progresive. Megjithatë, ky konservatorizëm në planin shoqëror-politik dhe arsimor kishte pasoja negative. Ai shpiente në egoizëm, në ndarje, në ruajtjen e zakoneve patriarkale, në ruajtjen e shprehive të jetës etj.

Në mesin e zakoneve që u ruajtën në jetën e shqiptarëve, duhet përmendur "ferexhenë" me të cilën femra shqiptare e pashkolluar ishte e mbuluar, me të cilën mendohej se ia kufizonte pjesëmarrjen e barabartë në jetën shoqërore.<sup>\*\*</sup>

<sup>1</sup> Lenin, I-V, Vepra të zgjedhura, "Kultura", Beograd, 1960, Bleni 14, f.416;

<sup>2</sup> Dukuria e këtillë ishte një lloj përgjigjeje kundër sulmit agresiv ateist ndaj fesë, e jo kundër arsimimit, meqë urdhri i parë kur'anor është "Lexo" (v. bot.).

<sup>3</sup> Gjergj Lushi, Roli i femrës shqiptare në familje dhe shoqëri, Sarajevo, 1977, f.132;

<sup>4</sup> Cit.sipas F.Engelsit "Antidiring", Beograd, 1935, f.

<sup>\*\*</sup> Duhet bëre dallim mes ferexhesë/perçes (mbulimi i fytyrës, që nuk përmendet në Kur'an) dhe hixhabit si irregull e caktuar fetare për mbulesën e femrës muslimane. Natyrisht, dihet se me "ferexhe" asokohe është sulmuar veshja fetare islame e femrës në përgjithësi. Mirëpo, sot jemi dëshmitarë se si në Lindje ashtu edhe në Perëndim,

Në qershor të vitit 1950 u miratua Ligji i parë për qeverisjen me ndërmarrjet ekonomike nga ana e këshillave të punëtorëve dhe këshillave drejtues, kështu që vjen deri te "decentralizimi dhe deburokratizimi". Gradualisht zhvillohet dhe ndërtohet sistemi i ri shoqëror-politik i cili mbështetet mbi baza të reja. Femrës shqiptare në atë kohë i kufizohej pjesëmarrja në prodhim në realizimin e planit të paraparë dhe në ngritjen e mëtejshme kulturore.

Më 26 dhe 27.IX.1950, në RP të Bosnjë e Hercegovinës u miratua Ligji për ndalimin e mbajtjes së feroxhesë. Ky ligj u miratua edhe në Maqedoni. Veprimi i organizatave shoqërore-politike, sidomos i FAG-ut, e cila që në vitin 1949 kishte zhvilluar aktivitet të madh nëpër fshatra në mesin e shqiptarëve dhe turqve, duke gjetur forma dhe metoda të posaçme që edhe femra myslimanë të ngrihet në aspektin kulturnor dhe arsimor, ishte një nga pikat më të rëndësishme të programit aksional të LKM-së<sup>1</sup>. Aktivitetet masive filluan çdokund, duke u mbajtur mbledhje e konsultime të ndryshme. Për këtë apelohej edhe nga ana e kryetarit - Ulemasë së Mexhlisit, hafëz Idriz Fetahut<sup>2</sup>, se në Kur'an nuk thuhet asgjë për feroxhenë<sup>\*</sup>. Disa gra, feroxhetë i hiqnin në vetë mbledhjet, ndërkaq disa familje nuk e pranuan ligjin e as apelet dhe duke i mbetur besnikë parimeve fetare të tyre, shpërnguleshin për në Turqi.

Me zhvillimin dinamik ekonomik, teknik dhe teknologjik në RS të Maqedonisë, u bënë ndryshime në strukturën ekonomike dhe sociale të popullsisë. Me transformimin e profesionit të popullsisë nga bujqësia në sektorë tjerë të punës, një pjesë e shqiptarëve që ushtronin funksione partiale dhe shtetërore u inkadrua drejtpërsëdrejti në realizimin e marrëdhënieve shoqërore vetëqeverisëse socialiste. Si të tjerët ashtu edhe shqiptarët në Maqedoni vetëkujdeseshin për ardhmérinë e tyre, e kjo lidhej me thënien e E.Kardel: "Fatin e njeriut nuk mund ta sjellë as shteti, as sistemi, as partitë politike. Fatin e njeriut mund ta krijojë vetëm ai vetë. Forcat avangarde të socializmit dhe të shoqërisë socialiste, sipas kësaj, mund të kenë vetëm një qëllim - që në bazë të mundësive në momentin e dhënë historik të krijojnë kushte në të cilat njeriu do të jetë sa më i lirë në shprehjen e tillë dhe krijimin personal

---

femrat muslimane e veshur sipas rregullave fetare është prezente në të gjitha sférat e jetës. (v. bot.)

<sup>1</sup> Kongresi I i LKM-së, "Kultura", Shkup, 1949, f.258;

<sup>2</sup> "Flaka e vëllazërimit", organ i Frontit Popullor të RP të Maqedonisë, Shkup, 30.01.1951, f.2;

\* Shih më lart vërejtjen \*\* të botuesit.

dhe të mundet, në bazë të pronës shoqërore mbi mjetet për prodhim - të punojë lirisht dhe të krijojë fatin e tij”<sup>1</sup>.

Sistemi socialist asnjëherë nuk e nxori në diskutim çështjen nationale në Jugosllavinë shumëkombëshe, gjoja se kësaj çështje i kanë dhënë fund në dokumentet partiake dhe se nacionalja nuk paraqitet si problem shtetëror, por paraqitet si përkrahje e zhvillimit demokratik të tërë bashkësisë sonë<sup>2</sup>. Edhe në Rezolutën e LKM-së është theksuar nevoja e domosdoshme që kombësitë të bëhen subjekte aktive në jetën shoqërore, politike dhe kulturore. Paralelisht me këtë “shqiptarët dhe turqit, së bashku me maqedonasit, marrin pjesë aktivisht në zgjidhjen e të gjitha problemeve dhe vështirësive në tërë Republikën”<sup>3</sup>.

Shqiptarët në periudhën e pasluftës përjetuan batica dhe zbatica në aspektin material, kulturore dhe arsimor. Për këto 30 vjet,jeta e shqiptarëve në R. e Maqedonisë kërkonte ndryshim të plotë sa i përket mënyrës së të menduarit, duke u futur nën ndikimin e rrjedhave përparimtare të kohës, e sidomos duke e vënë arsimin dhe kulturën në plan të parë. Si shembull do ta përmend ninullën, të cilën nëna e pashkolluar ia këndon djalit të saj, në mënyrë që nesër djali i saj të bëhet inxhinier, mjek, profesor etj.:

“*Nina nana djali jem  
kur të shkojsh në shkollë  
nana të çon për inzhinjer*”<sup>4</sup>

Zhvillimi i përgjithshëm shoqëror-ekonomik, kontribuoi që në këtë periudhë edhe në fshat të bëhen transformime të gjithanshme. Posaçërisht duhet theksuar se kishte gjithnjë e më shumë fëmijë të prodhuesve individualë që kryenin shkolla dhe fakultete. Rreth 80 për qind të popullatës shqiptare në Maqedoni jeton në fshatra. Me vetëkontribut dhe me kontributin e pjesërishtëm të shtetit të gjitha fshatrat fituan energjinë elektrike, në disa fshatra u asfaltuan rrugët, u ndërtuan ujësjellës, ambulanca, posta, kurse në fshatrat më të mëdha u ndërtuan edhe shtëpi të kulturës, salsa leximi etj.

<sup>1</sup> E. Kardel, Kahet e zhvillimit të sistemit politik të vetëqeverisjes socialiste, “Komunist”, Shkup, 1968, f.8;

<sup>2</sup> Kombësitë në shoqërinë vetëqeverisëse “Komunist”, Shkup, 1968, f.31;

<sup>3</sup> Rezoluta e Kongresit V të LKM-së, 1968;

<sup>4</sup> Bahtije Feriti, fshati Leshnicë, Kërçovë, amvise e pashkolluar, e moshës 86 vjeç, dr. Petro Janura, Nina-nani, Shkup, 1971, f.7-14;

Në komunat me popullatë të përzier (shqiptare-maqedonase-turke dhe me grupe tjera etnike) u desh të krijohet bazë materiale për një zhvillim të shpejtë ekonomik. Kuvendi i RS të Maqedonisë planifikonte që në komunat e përziera të ndërtohen kapacitete të rëndësishme industriale, por kur duhej të ndërtohej, ata ndërtoheshin në qytetet e mëdha të Maqedonisë. Nuk është zhvilluar një politikë e drejtë ekonomike, që nga radhët e kombësive të krijohet klasa punëtore, si garanci për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi. Sipas të dhënave statistikore të 31 marsit të vitit 1967, nga gjithsej 223.033 të punësuar, 7 për qind i përkisnin kombësisë shqiptare. Nëpër komuna situata ka qenë si vijon: Dibër 35,6%, Gostivar 33,2%, Idadi (Shkup) 17%, Kisella Vodë (Shkup) 13,9%, Kërçovë 10,4%, Kumanovë 8,3%, Ohër 8,8%, Resnjë 14,3%, Strugë 23,4%, Tetovë 36,2%<sup>1</sup>. Në këto komuna të RS të Maqedonisë janë investuar edhe fonde të posaçme, ngase këto komuna konsideroheshin si komuna të pazhvilluara. Në Dibër 32 milionë, Gostivar 130,2, Kumanovë 43,8, Resnjë 10,6, Strugë 30 milionë, Tetovë 153, Kale (Shkup) 105 milionë, gjithsej 539 milionë dinarë.

Në periudhën e pasluftës në RPM respektivisht RSM, prodhimi material ka shënuar rritje dinamike. Prodhimtaria shoqërore në ekonominë e përgjithshme gjatë vitit rritej sipas shkallës prej afro 7 për qind. Zhvillimi i ekonomisë dhe industrisë në vitet e fundit ka pasur rritje dinamike. Zgjerimi i bazës materiale në lëmin e prodhimit është realizuar sipas shkallës mesatare vjetore prej rrëth 11,2%, kurse në vitin 1972 prodhimi arrii rritje 14 herë më të madhe<sup>2</sup>.

Për forcimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e barazisë nacionale mbi baza vetëqeverisëse, popullata shqiptare gjatë 30 viteve të kaluara, ashtu si të gjitha nacionalitetet tjera filloj nga Abetarja e arriti deri në Akademitë Pedagogjike dhe Fakultetet, deri në veprimtarinë botuese, skenike-muzikore, amatore dhe në veprimtaritë tjera. Edhe pse popullata shqiptare paraqitej si subjekt në të gjitha sferat e jetës, ajo nuk u përfshi aq sa meritonte në strukturat e administratës shtetërore me të vetmin arsyetim se nuk ekziston kuadër i kualifikuar. Kur në Brione u shkarkuan nationalistët serbë në krye me Rankoviqin dhe e gjithë kjo mundësoi që kjo kombësitetë marrin përpjetën, sidomos në sferën e arsimit dhe kulturës ku kemi një rritje në hapjen e shkollave filllore dhe të mesme.

<sup>1</sup> Kombësítë, (OP.Cit.f.46);

<sup>2</sup> Disa karakteristika të zhvillimit të pasluftës në RS të Maqedonisë, Shkup, shkurt 1974, f.9;

Sipas të dhënave, në këtë periudhë 30 vjeçare janë botuar libra në tirazh prej 336 mijë copë<sup>1</sup>. Po ashtu, janë bërë hapa të vogla edhe në veprimtaritë informative. Prej vitit 1945 del gazeta “Flaka e vëllazërimit”, në fillim si gazetë javore, e mandej (1971) paraqitet tri herë në javë, si organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë. Revista për shkencë dhe kulturë “Jehona” paraqitet me 10 numra në vit, ndërkaq, btohen edhe revista për fëmijë “Gëzimi” dhe “Fatosi”. Përmes Radio-Shkupit emetohen lajme dhe transmetohen manifestime të ndryshme kulturore, si dhe emisione shkolllore enkas të organizuara. Prej vitit 1970 në gjuhën shqipe emitohet çdo ditë program 120-minutësh. Programi televiziv është zgjeruar: emetohet dy herë në javë nga 20 minuta, më vonë 5 herë në javë dhe të dielave emetohej emision i posaçëm për fëmijë. Në të gjitha qytetet ku jeton kombësia shqiptare kanë vepruar disa orë në ditë edhe radio-stacionet lokale. Veprimitaria bibliotekare po ashtu. Janë pasuruar me literaturë shqipe bibliotekat komunale në Shkup, Dibër, Kërçovë, Tetovë, Gostivar etj., që luanin një rol të rëndësishëm në ngritjen kulturore.

Rol të rëndësishëm në emancipimin e kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë ka luajtur edhe Teatri i Kombësive në Shkup, si dhe Shoqëria kulturore-artistike “Xheladin Zeqiri” në Tetovë, “Bajram Shabani” në Kumanovë, “Besa” në Gostivar, “Liman Kaba” në Dibër, “Emin Duraku” në Shkup etj.

Kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë i është ofruar mundësia ta zhvillojë kulturën e vetë nationale nëse ajo përshkohej në frymën e vëllazërimit, bashkimit dhe barazisë dhe qytetarit të bindshëm të sistemit socialist jugosllav.

## 2. RRETHANAT ARSIMORE NË MAQEDONI ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË SHKOLLIMIN E SHQIPTARËVE

Populli shqiptar është një nga ata popuj, i cili gjatë tërë historisë ka luftuar për të fituar të drejtat shoqërore-politike, ekonomike dhe nationale. Çështja e shkollimit te shqiptarët ka qenë imperativ i kohës.

<sup>1</sup> Zhvillimi socialist vetëqeverisës shoqëror-ekonomik i RPM-së, 1973-1977, Shkup, 1978, f.112;

Regjimet jopulllore, mundësinë e hapjes së shkollave shqipe e shihnin si vatër e rrezikshme potenciale nacionale, ndaj shpeshherë jetërat e njerëzve, të patriotëve shqiptarë që tentonin të hapnin shkolla në gjuhën amtare, përfundonin tragjikisht<sup>1</sup>. Të gjitha regjimet, në viset ku jetonte popullata shqiptare hapnin shkollat e tyre, kështu që popullata shqiptare fitonte arsimim edhe në shkollat greke, turke, serbe, bullgare, italiane etj. Fat të njëjtë ka pasur edhe shkolla maqedonase<sup>2</sup>.

Gjatë kohës së Rilindjes Kombëtare, prej vitit 1887-1908, është punuar shumë në hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Në këtë kohë hapen shkolla në gjuhën shqipe në shumë qytete (në Korçë, Manastir, Shkup, Shkodër, Prizren, Gjakovë, Prishtinë etj.). Për nder të hapjes së shkollës së parë shqipe ka thurë këngë edhe vetë populli si dhe shkrimitarët shqiptarë. Ja në ç'mënyrë, me krenari shkruante poeti kombëtar shqiptar, Naim Frashëri, me rastin e hapjes së shkollës së parë shqipe e lejuar me dekret nga Sulltanati në Korçë:

*"Lumja ti, moj Korç' o lule  
Ç'i le pas shoqet e tua,  
Si trimi në ballë u sule  
T'a paçim përjetë hua"*<sup>3</sup>

Shkolla e re e posahapur nuk zgjati shumë, ngase regjimi i atëherëshëm shkollat i konsideronte si "qendra të rrezikshme kulturore-edukuese" dhe për këtë arsyen mbyllte, ndërsa organizatorët i vriste. Me të drejtë mund të thuhet se kanë qenë të pakta ato shkolla kombëtare që kanë kaluar përmes kaq vështirësish, si shkolla shqipe.

Në situatë të ngjashme ndodhej edhe shkolla shqipe ndërmjet dy luftërave botërore. Në këtë periudhë, edhe për popullin maqedonas edhe për kombësinë shqiptare krijohet një valë e re denacionalizimi nga ana e tri shteteve ballkanike, Mbretërisë së SKS-së, përkatësisht Mbretërisë së Jugosllavisë së vjetër, Greqisë dhe Bullgarisë<sup>4</sup>. Të gjitha këto shtete në mënyrat e tyre dëfinitivisht, në aspektin nacionale, sociale, politike, kulturore, edukative, e cila është përfundonit tragjikisht.

<sup>1</sup> Shih gjerësisht dr. Jashar Rexhepagiq, Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, Prishtinë, 1970; Hysni Myzeri, Shkollat e para kombëtare shqiptare, Tiranë, 1978 (Botimi i dytë i plotësuar).

<sup>2</sup> Shih gjerësisht dr. Risto Kantarxhiç, Makedonskoto prerodbenko učilište, Shkup, 1965;

<sup>3</sup> Naim Frashëri, - Vepra I, "Rilindja", Prishtinë, 1978, f.111

<sup>4</sup> Historia e popullit maqedonas, Libri III, Shkup, 1969, f.7;

Kur shqiptarët gjatë Mbretërisë së SKS-së filluan të paraqiten si problem shoqëror-ekonomik, kulturor dhe arsimor, atëherë borgjezia serbomadhe u orientua që kësaj kombësie t'i ofrojë më shumë arsimim fetar se sa arsimim të përgjithshëm. Sipas disa të dhënave, në shkollat serbe kjo kombësi përfshihej me vetëm 25 për qind<sup>1</sup>.

Në Jugosllavinë e vjetër formalisht me ligj ishte rregulluar shkollimi i obligueshëm në kohëzgjatje prej 8 vjetësh, por ai asnjëherë jo vetëm që nuk u realizua, por edhe nuk u ndërmor asgjë që të realizohet.

Disa vjet pas miratimit të Ligjit të vitit 1929, autoritetet borgjeze serbe kishin paraparë të hapin shkolla popullore tetëvjeçare me plane dhe programe të reja mësimore. Në planet dhe programet mësimore vend me rëndësi kishte mësimi i fesë, me qëllim që edhe më tutje të edukohen “në frymën e jugosllavizmit”, lojalitetit ndaj shtëpisë mbretërore dhe kishës, përkatësisht religionit<sup>2</sup>. Kështu, autoritetet serbe, në realitet insistonin më shumë në hapjen e shkollave fetare. U hapën Sibian Mektebet pranë çdo xhamie. Prej vitit 1925 në Shkup filloi të punojë Medreseja e madhe me emrin “Medreseja e Mbretit Aleksandër I”. Prej vitit 1935 sërisht filloi të punojë edhe “Medreseja e Gazi Isak Beut”, po ashtu në Shkup,<sup>3</sup> të cilën e financonte Bashkësia Fetare Islame. Përveç disa shkollave serbe “popullore” dhe fetare, shkolla të tjera për shqiptarët nuk ekzistonin. Suksesi i shkollimit përfëmijët shqiptarë pothuaj ishte kurrrfarë, ngase këto shkolla përxenësit ishin “vende mundimi” dhe shkuarja në to përxenësit shqiptarë dhe prindërit e tyre, ishte vetëm humbje kohe. Duke u nisur nga përvojat e politikës së këtillë arsimore pas revolucionit, shpeshherë paraqitej mosbesimi në rëndësinë e shkollës, kështu qëj mund të dëgjoheshin edhe fjalë të tilla: “Ç’na duhet shkolla? Më mirë të ruajmë dele dhe dhi, më mirë të punojmë në fushë dhe të fitojmë koren e bukës se sa të mësojmë në shkollë”.

Periudha para luftës shqiptarëve jashtë trojeve etnike u ngulfaste çdo shpresë dhe dëshirë për çlirim nacional, ekonomik, politik dhe kulturor-arsimor. Prandaj, me të drejtë periudhën para luftës Ali Hadri

<sup>1</sup> Avzi Mustafa, Shkollat filllore private fetare në Gostivar dhe rrëthine, prej 1920-1940, Referat nga Takimet V shkencore-kulturore të Bigorit, mbajtur më 21-22.XI.1980;

<sup>2</sup> Nikolla Potkonjak, Nga bazat etatiste në drejtim të bazave vetëqeverisëse socialiste “Prosveta”, Beograd, 1977, f.22;

<sup>3</sup> Përkujtimorja 20 - Përvjetori i çlirimtë të Serbisë Jugore, 1912-1937, Shkup, f.947;

e karakterizoi si: "Historia e Jugosllavisë deri në vitin 1941, në realitet është histori e një krize nationale, politike dhe ekonomike"<sup>1</sup>.

Kur fillooi lufta, situata në vend ishte edhe më e vështirë, kurse rrrethanat ende të pakonsoliduara, dhe e gjithë kjo i shkonte përshtati okupatorit, i cili shërbehej me të gjitha mjetet për realizimin e qëllimeve të tij.

Siq dihet, Maqedonia Perëndimore ka qenë nën okupimin italian, kurse ajo Lindore nën atë bullgar. Fashistët italianë për t'i realizuar qëllimet e tyre, në mënyrë tejet të shkathët përdornin një strategji duke luajtur rolin e shpëtuesve: pasi kombësia shqiptare ka jetuar në pjesën perëndimore të Maqedonisë, duke marrë parasysh prapambeturinë nationale dhe kulturore, për të fituar simpatinë, okupatori masave populllore u premtonte se do ta shkatërrojë prapambeturinë dhe robërinë shekulllore. Pas ardhjes në Maqedoni u treguan si organizatorë mjaf të mirë. Përmes formimit të "bashkive" (komunave) dhe prefekturave i kontrollonin të gjithë sektorët, ndaj edhe sektorin e arsimit<sup>2</sup>.

Në vjeshtën e vitit 1941, në Maqedoninë Perëndimore u hapën shkollat e para shqipe. Rrjeti shkollor në periudhën 1941-1944 u zgjerua mjaf. Në vend të të gjitha shkollave të mëparshme serbe (varësisht nga kuadri arsimor), tanë punojnë shkollat në gjuhën shqipe. Politika fashiste me damagogjinë e saj që shqiptarët të arsimohen, qysh pas muajit të parë e tregoi fytyrën e saj të vërtetë edhe në këto shkolla, ku krahas mësimit në gjuhën shqipe dëshironë të fuste edhe gjuhën italiane. Me dekretin e muajit maj të vitit 1941, në plan-programet mësimore u aplikua si i domosdoshëm mësimi i gjuhës italiane<sup>3</sup>. U hapën edhe kurse verore për mësimin e gjuhës italiane. Mungesa e kuadrit arsimor ishte tepër e madhe dhe kështu në territorin e Kosovës, në Prishtinë hapet Shkolla Normale, ku gjatë pushimeve verore mbahen kurse dhe seminare për përgatitjen e kuadrit arsimor dhe administrativ, në mënyrë që rrjeti shkollor të zgjerohej edhe më tepër. Në Shkollën Normale dërgohen fëmijët shqiptarë nga Maqedonia dhe Kosova. Përveç në vendet e banuara me popullatë shqiptare,

<sup>1</sup> Dyzet vjet të luftës revolucionare të LKJ-së "Socializam", Beograd, 1959, nr.2, f.5;

<sup>2</sup> Dr. Ali Hadri, Lëvizja nacional-çlirimtare në Kosovë, 1941-1945, Prishtinë, 1971, f.107;

<sup>3</sup> Arkivi i shkollës filllore "Vellazërimi", Dibër, Sasia e orëve të mësimit, Ministria e Arsimit të Mbretisë Shqiptare (plani mësimor gjatë okupimit që është shfrytëzuar në shkollat me mësim në gjuhën shqipe gjatë periudhës 1941-1944);

shkolla të tilla hapen edhe në vendet me popullatë maqedonase, kurse mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Me rastin e fillimit të vitit shkollor, ministri i Mbretërisë shqiptare, Ernest Koliqi, lëshon një enqiklikë më 25. 10.1941 në të cilën thuhet: Për herë të parë themelohen shkollat jashtë kufijve të vjetër shtetërorë, të cilat në kuptimin e plotë janë me vlerë historike, që premtojnë se do ta çrrënjosin papambeturinë dhe do t'i shërojnë plagët e robërimit dhe se shkolla shqipe do të jetë në shërbim të popullit“<sup>1</sup>

Në Maqedoninë Lindore vendet e banuara me popullatë shqiptare ishin nën fashizmin bullgar. Po ashtu edhe bullgarët hapnin shkolla në gjuhën bullgare dhe në mënyrë të njëjtë, si edhe fashistët italianë, zhvillonin politikë denacionalizuese ndaj maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe grupeve tjera etnike<sup>2</sup>

Edhe pse gjendja në këto treva ishte tepër e mijeruar në çdo fushë, nuk u kursyen as mjetet as vullneti që shqiptarët e këtyre trevave të arsimohen në gjuhën amtare. Një angazhim të tillë e të pamohueshëm dha Mbretëria shqiptare në krye me ministrin e arsimit, Ernest Koliqi. Koliqi mori guximin me përgjegjësinë personale të themelojë shkollat shqipe në Maqedoninë Perëndimore dhe në Kosovë dhe si ministër i arsimit në këto treva dërgoi 200 mësues shqiptarë, që pas mbarimit të luftës i vunë themelet e forta të arsimit në gjuhën shqipe<sup>3</sup>

Edhe pse këto shkolla të kësaj periudhe janë trajtuar si shkolla me ideologji fashiste, sidqoftë nxënësit merrnin dëftesa për klasët e kryera. Ne nuk mund të konsiderojmë se këto nuk ishin shkolla të vërteta shqipe, ngase ishin hapur vetëm për qëllime arsimimi, pa hyrë në qëllimet e fshefta të politikës së shteteve të mëdha. Ato, megjithatë, janë shkollat e para shqipe në të cilat në rajone të ndryshme zhvillohej mësimi në gjuhën amtare.

<sup>1</sup> Avzi Mustafa, Përdorimi i teksteve shkollore gjatë periudhës 1941-1944, E Vërteta, Shkup, nr. 2, 1996, 36

<sup>2</sup> Ratislav Terziovski, Veprimtaria denacionalizuese e institucioneve kulturore-arsimore bullgare në Maqedoni, INI, Shkup, 1974;

<sup>3</sup> E. Koliqi, Tregtar flamujsh, NB, “Gjon Buzuku”, 1991, 5

### **3. DETERMINIMI I ZHVILLIMIT TË SISTEMIT EDUKATIV-ARSIMOR TË SHKOLLIMIT**

Sistemi shkollor është i determinuar me faktorë të shumtë, siç janë: zhvillimi shoqëror-ekonomik, shkencor-teknik, zhvillimi i shkencës, sidomos zhvillimi i shkencës sonë pedagogjike, i politikës arsimore dhe mënyra e orientimit dhe zgjidhja e çështjeve arsimore, struktura e kuadrit edukativ-arsimor etj.

Arsimimi fillor është themel i arsimimit të mëtejshëm për jetë dhe punë, ku shkolla fillore jep bazë të gjerë për prodhim, duke dhënë kulturën e përgjithshme. Arsimimi fillor si fenomen vështirë mund të veçohet nga totaliteti i punës së bashkuar. Puna e bashkuar është mjaft e interesuar për transformimin e shkollimit fillor. Në raportin ndërmjet punës së bashkuar dhe arsimimit si dhe transformimit vetëqeverisës, kemi pika nistore për transformimin e sistemit shkollor.

Detyrat themelore, sa i përket edukimit dhe arsimimit të gjeneratës së re, dalin nga vetë detyrat shoqërore në një shkallë të caktuar të zhvillimit. Qëllimi i edukimit dhe arsimimit në sistemin socialist vetëqeverisës është definuar qartë: “Që të aftësohet gjenerata e re, e cila me punën, të mbështetur në të arriturat bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, do t’i kontribuojë zhvillimit të përhershëm të forcave shoqërore-prodhuuese”<sup>1</sup>.

Dhoma kulturore-arsimore e Kuvendit Federativ, në mbledhjen e saj të datës 18-19 mars 1964, e shqyrtoi problemin lidhur me zbatimin e reformës së shkollimit dhe arsimimit. Me këtë rast u miratuan rekomandimet që dalin nga kushtetuta “që edhe më tutje të bëhen përpjekje maksimale për zbatim më të plotë dhe më të tërësishëm të reformës së arsimimit fillor, si element qenësor i politikës në lëmin e arsimimit dhe si parakusht për zhvillim të shpejtë ekonomik, shoqëror dhe kulturor të bashkësisë socialiste”<sup>2</sup>. Fenomenin e arsimimit të përgjithshëm është vështirë ta veçosh nga arsimimi profesional, ngase duke marrë parasysh zhvillimin e shkencës, këta në aspektin dialektik ndërvaren njira me tjetrin. Kështu, edhe zhvillimi i shkencës pedagogjike i kontribuon kulturës më të gjerë arsimore dhe ndihmon që

<sup>1</sup> Ligji për shkollat fillore, “Gazeta zyrtare” nr.9-10, 1959, f.163, shih neni 3;

<sup>2</sup> Rekomandimet lidhur me gjendjen dhe problemet në lëmin e arsimimit fillor, Revista e shkollës dhe dokumentacioni arsimor nr.1, 1964, f.69-70;

njeriu të ngrihet në vetëqeverisës, në pikëpamje marksiste ndaj botës dhe të zhvillojë pjekurinë e tij ideologjike-politike<sup>1</sup>.

Ndryshimet mjaft dinamike, që krijojen në shoqërinë socialiste vetëqeverisëse, shprehen edhe në sferën e arsimit, të cilat determinojnë ndryshimet qenësore në sistemin si tërësi, përbajtjet e reja arsimore-edukuese, si dhe vetë filozofinë e arsimimit. Shikuar nga ky aspekt, arsimimi themelor paraqet pjesë të luftës klasore në realizimin e sistemit shkollor edukues-arsimor, i cili është në funksion të punës së bashkuar dhe kështu krijon njeriun e ri, që është promotor i zhvillimit të mëtejshëm të arsimit dhe të shoqërisë në tërësi. Ai edhe më tutje është bartës i risive edukuese-arsimore dhe shoqërore, të cilat kanë synuar ta zhvillojnë personalitetin e gjithanshëm të nxënësit, të krijojnë shprehi pune, ta kultivojnë patriotizmin jugosllav dhe bindjen sociale ne të. Përveç modernizimit të procesit edukues-arsimor, duhet ndërtuar marrëdhënie aktive të nxënësve në mësim përmes metodave dhe formave të ndryshme.

Pas ndryshimeve të mëdha që u krijuan në shoqëri, pasuan edhe ndryshime në edukim dhe arsimim, në mënyrë që shkolla të mos imbetet pas jetës. Këto ndryshime mbështeten në ndryshimet radikale, të mbështetura edhe në orientimin ideopolitik të unitetit të procesit arsimor-edukues dhe të punës, duke synuar humanizimin e personalitetit, dhe me modernizimin e përhershëm të punës edukative-arsimore, me ç'rast rol jo të vogël ka sistemi i punës së bashkuar. Determinantet që dilnin nga zhvillimet e ndryshme shoqërore-historike, shoqërore-ekonomike, socio-politike dhe kulturore-arsimore të vendit tonë, implikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në sferën arsimore-edukuese.

### 3.1. TRADICIONALIZMI

Përkundër ndryshimeve që bëheshin në sferën shoqërore-politike, gjithsesi ato ngértheheshin edhe në përbajtjet mësimore. Krahas planprogrameve dhe teksteve të reja mësimore, ka qenë e pamundshme që gjatë periudhave të kaluara të evitohen disa dobësi që e kanë përcjellur sistemin tonë edukativ-arsimor. Këto dobësi, dr.Frankoviq i konsideron si "dobësi të rritjes, të zhvillimit të shpejtë dhe specifik të

<sup>1</sup> Frankoviq, Bitna obelezha socialistike idejnosi i politiqnosti nastave, Zagreb, 1977, f.96;

shkollimit dhe arsimit në vendin tonë pas çlirimt<sup>1</sup>". Konstatimi është mjaft i qartë. Pas fitores definitive, kujdesi i bashkësisë së atëherëshme për zhvillimin e shkollimit dhe arsimimit te kombësia shqiptare në RS të Maqedonisë, ka qenë në radhë të parë i orientuar në sigurimin e mjeteve materiale dhe kuadrove, në mënyrë që të plotësoheshin nevojat momentale, kështu që shkollën fillore, deri te reformat, e karakterizojnë vetëm ndryshimet sasiore.

Edhe pse kemi realizuar suksese relativisht të mira, duke ndryshuar pak a shumë vetëm sistemin e vjetër shkollor, "nuk e kemi ndryshuar rrënjesisht, por vetëm disa segmente të tij"<sup>2</sup>.

Duke pasur parasysh rrethanat nën të cilat është zhvilluar shkolla fillore shqipe pas revolucionit, shohim se ajo është zhvilluar pa ndonjë plan të posaçëm, por ashtu siç e kërkonte nevoja. Kujdesi parësor ishte i orientuar në shkollimin katervjeçar, edhe pse me ligj ishte i paraparë shkollimi i obligueshëm shtatëvjeçar, përkatësisht shkollimi tetëvjeçar. Dhe vetëm kur u poqën kushtet, atëherë shkollat fillore katervjeçare u shndërruan në tetëvjeçare, në mënyrë që arsimimi të plotësohet. Vazhdimi në klasët e larta të shkollës fillore, për disa fëmijë të kombësisë shqiptare paraqiste privilegji. Nxënësi pas përfundimit të shkollës katervjeçare mbetej në fshat si bujk.

Edhe në propozimin e Komisionit për reformën e shkollimit, para së gjithash ishte theksuar ajo se a duhet krijuar institucion unik shkollor - shkollë fillore tetëvjeçare - ose duhet ruajtur edhe më tutje llojet e ndryshme në këtë nivel<sup>3</sup>.

Krahas të gjitha transformimeve dhe ndryshimeve në planprogramet mësimore, shumë përbajtje mësimore ishin të ngushta dhe të papërshtatshme sa i përket rolit të ri shoqëror të shkollës. Disa lëndë dhe disa përbatje të parapara me plan dhe program nuk ishin të përshtatshme, ato vetëm e ngarkonin nxënësin.

Shkolla fillore si institucion pedagogjik dhe shoqëror, ashtu siç ka qenë deri te reformat, nuk ofronte mundësi të mëdha e as gjasa përperspektivë të mëtejshme.

Megjithatë, tempi i zhvillimit të shoqërisë në tërësi, i mbështetur në parimet socialiste vetëqeverisëse, solli ndryshime dhe ofroi

<sup>1</sup> Frankoviq, (Op.cit.vepra, f.5);

<sup>2</sup> Ekspoze e Rodolub Çollakoviq, Mbi propozimin e Ligjit të përgjithshëm të shkollimit, "Gazeta zyrtare" RFPJ, Beograd, 1959, f.13;

<sup>3</sup> Propozimi i sistemit të arsimimit dhe edukimit në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë, Beograd, 1957, f.34;

mundësi të gjera për njeriun punues, në mënyrë që në shkollën fillore, mbi këto parime të edukohet dhe arsimohet. Nga kjo del se “shkollimi i obligueshëm tetëvjeçar, si minimum i arsimimit shkollor, pushon të jetë privilegj për një shtresë dhe bëhet periudhë minimale e shkollimit, bazë minimale nistore e arsimit të përgjithshëm për çdo qytetar të ri, pa marrë parasysh origjinën dhe profesionin e ardhshëm<sup>1</sup>.

Me reformën, e sidomos me miratimin e Ligjit të përgjithshëm për shkollimin, në Maqedoni u krijuar lloji unik i shkollës tetëvjeçare. Tradicionalizmi në zhvillimin e shkollimit fillor është evident në periudhën e parë të pasluftës, por gjatë etapës së dytë të zhvillimit, ky tradicionalizëm si dhe disa ngurtësi janë tejkaluar.

Shkolla fillore në fillim nuk ka mundur të zhvillohet plotësisht, ngase për një kohë doemos është dashur t'u përshtatet mjediseve të pazhvilluara, por vazhdimisht ekzistonte tendenca që edhe ajo të niset rrugës së shkollës së zhvilluar<sup>2</sup>.

Po ashtu duhet përmendur se deri në vitin 1948, sistemi shkollor i bartte të gjitha shenjat e shkollimit sovjetik. Kur u aplikua vetëqeverisja punëtore (viti 1950), administrimi i sistemit shkollor kalon nga sistemi administrativ në sistemin vetëqeverisës.

Pas reformës, “Sistemi i arsimimit dhe edukimit” dhe sistemi shkollor kanë qenë në reformë të përhershme edhe sa i përket procesit të adaptimit nevojave të ekonomise dhe kërkesave të shoqërisë sociale vetëqeverisëse. Në këtë drejtim, PKJ-ja kishte rol mjaft të rëndësishëm<sup>3</sup>.

Në RS të Maqedonisë, shkolla fillore e obligueshme për kombesinë shqiptare, ndër të tjera u bë mjet për t'u eliminuar disa shprehi të vjetra, tradita etj. Prej vitit 1950, shkolla fillore për cilindo shqiptar nuk ishte më “kohë e humbur”, ashtu siç mendonin në fillim disa prindër tanë. Tani prindërit shqiptarë perspektivën e fëmijës së tyre e shihnin vetëm te shkolla.

<sup>1</sup> Dr. Millosh Zhanko, Nxënësi dhe reforma e shkollës, “Omladina”, Beograd, 1956, f.17;

<sup>2</sup> Ante Blazheviq, Zhvillimi i shkollës fillore në RS të Kroacisë prej çlirimit deri në krijimin e shkollës unike tetëvjeçare. Tridhjetë vjet të pedagogjisë dhe shkollës sonë, Zagreb, 1976, f.66;

<sup>3</sup> Dr. Mihajlo Ogrizoviq, Tridhjetë vjet veprimitari arsimore dhe pedagogjike, ibid.f.10;

### *3.2. ZHVILLIMI I ARSIMIT TE MAQEDONASIT*

Populli maqedonas, deri më 1944 nuk mësonte në gjuhën e vet amtare. Në truallin e Maqedonisë deri në çlirimin e saj ishin hapur shkolla të ndryshme nga ana e pushtuesve të ndryshëm, me qëllim që ky popull të asimilohet dhe të jetë shërbëtor i pushtuesve. Maqedonia për shkak të përparësive të saj natyrore, për shumë okupatorë ka qenë bazë e lëndës së parë, të cilën e kanë eksplotuar në mënyrë të pamëshirshme. Edhe përkundër kushteve të vështira, në të kaluarën ky popull ka luftuar për emancipimin e vet nacional dhe kulturor. Në të kaluarën, në Maqedoni ka qenë i zhvilluar një mozaik i rrjetit shkollor<sup>1</sup> me plot ndikime kundërthënëse.

Politika arsimuese e popullit maqedonas filloi gjatë luftës, kurse qëllimin e mbërriti më 1943,<sup>2</sup> e cila më tutje u zhvillua pas fitores definitive mbi fashizmin, kur ky popull në mënyrë të gjithanshme filloi të zhvillohet në aspektin kulturor, arsimor dhe nacional.

Që në vitin 1945-1946, Ministria e Arsimit në Maqedoni mori disa vendime të rëndësishme: planprogramet e para mësimore, miratimin e drejtshkrimit maqedonas, botimin e abetares së parë maqedonase etj.<sup>3</sup>.

Nga viti në vit, në zhvillimin kulturor-arsimor edhe përkundër shenjave cilësore, u arritën rezultate sasiore edhe në ngritjen e kuadrit arsimor, zgjerimin e rrjetit shkollor, në përfshirjen e fëmijëve prej 7-14 vjet, në botimin e teksteve shkollore etj.

Në vitin shkollor 1952/53, numri i shkollave maqedonase ka qenë si vijon:<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Dr. Risto Kantarxhiev, op.cit.vepra (5-226);

<sup>2</sup> Shkolla e parë fillore maqedonase u hap në rajonin e Debarcës në nënëtor të vitit 1943 e më vonë në disa fshatra të Kërçovës dhe Llazaropoles, shih gjerësisht, Kitanovski, Boro, Shkollat e para maqedonase në LNÇ, Shkup, 1973;

<sup>3</sup> "Prosvetno dello", 1945-1960; Mile Čorvezirovski, Kontribut modest në përvetësimin e gjuhës letrare; Gërlıçkov-Simitçiev-Gjorgjiev, -Dhjetë vjet të ndërtimit të socializmit në Maqedoni, "Kultura", Beograd, f.91;

<sup>4</sup> Buletini statistikor i RPM-së, Shkup, 1954;

Shkollat		Nxënësit	Mësuesit
I-IV	1.122	105.575	1.120
V-VII	130	21.087	926
GJITHSEJ:	1.252	126.662	2.046

tabela nr.1 - Zhvillimi i arsimit fillor te maqedonasit

Çdo vit numri i nxënësve në shkollën fillore rritej, kështu që shtimi i numrit të nxënësve hapi mundësitë që në vitin 1954 të miratohet Ligji për shkollimin e obligueshëm tetëvjeçar.

Paralelisht me përgatitjet e reformave, organet arsimore i mobilizuan të gjitha forcat rrëth zgjerimit të rrjetit shkollor, sigurimit të kuadrit arsimor etj. Kështu, për një periudhë të shkurtër shkolla fillore maqedonase arriti rezultate të dalluara. Në vitin shkollor 1958/59 kishte 972 shkolla katërvjeçare, 199 tetëvjeçare. Në shkollat fillore katërvjeçare kishte 118.624 nxënës, kurse në ato tetëvjeçare 49.972 me gjithsej 5.520 arsimtarë. Shihet qartë se shkollat tetëvjeçare u shtuan për 77,5 për qind, kurse përfshirja e nxënësve prej 7-11 vjet, shënon rritje prej 6,3 për qind.

Pas reformës, shkollimi fillor maqedonas bën edhe më tutje transformim të thellë dhe në mënyrë sasiore dhe cilësore shtohet jo vetëm numri i shkollave fillore, por edhe i atyre të mesme, profesionale dhe sipërore.

Në vitin 1970, Kuvendi Federativ miratoi “Rezolutën për zhvillimin, edukimin dhe arsimimin mbi baza vetëqeverisëse”. Shkolla maqedonase, si dhe shkollat e kombësive arritën rezultate mjaft të rëndësishme, sidomos sa i përket shkollimit fillor të fëmijëve, mandej në miratimin e planprogrameve të reja mësimore, në përsosjen e kuadrit arsimor, si dhe në aplikimin e teknologjisë bashkëkohore të arsimit. Kështu, prej vitit 1970-75 në të gjitha shkollat e tërë Jugosllavisë u bënë ndryshime rrënjosore, të orientuara në bazën socialiste vetëqeverisëse, e cila përgatiti rrugën e mëtejshme në realizimin e reformave në sistemin e edukimit dhe arsimimit<sup>1</sup>.

Arsimimi dhe edukimi fillor në RS të Maqedonisë në periudhën e kaluar ka qenë në transformim të dukshëm, me të cilin është bërë hap i mëtejmë në demokratizimin e edukimit dhe arsimimit.

<sup>1</sup> Dr. M. Ogrizoviq, ibid.f.11;

Në vitin shkollor 1974/75 shkolla fillore maqedonase siguroi bazë materiale si dhe kuadër arsimor dhe zhvilloi rrjet të gjerë, për t'u përfshirë 100 për qind të fëmijëve në shkollën fillore.

### **3.3. ZHVILLIMI I MENDIMIT TEORIK DHE I KËRKESAVE PEDAGOGJIKE**

Mendimi pedagogjik në Maqedoni pas luftës ka qenë i pazhvilluar. Edhe pse ekzistonin disa libra ose ndonjë artikull në revistat pedagogjike, këto ishin nën ndikimin e botëkuptimeve të huaja, e sidomos nën ndikimin e shkencës pedagogjike gjermane. Teoria pedagogjike jugosllave deri në vitin 1941 ka pasur baza idealiste dhe i shërbente shoqërisë klasore<sup>1</sup>.

Pas fitores së Revolucionit socialist në BRSS, te një numër i vogël njerëzish mund të gjendej edhe literaturë pedagogjike në gjuhën ruse. Me fitoren e socializmit, tek ne u krijuan mundësi që pedagogu, punëtori shkencor në shoqërinë socialiste ta miratojë dhe zhvillojë mendimin pedagogjik socialist. Kështu, ishte e natyrshme dhe objektive që edhe vendi ynë ta pranojë pedagogjinë ruse, e cila zhvillohej mbi bazën teorike marksiste.

Në fillim, pra menjëherë pas përfundimit të luftës, pedagogët tanë morën mbi vete si punë më të ngutshme dhe më të nevojshme përkthimin e literaturës pedagogjike në gjuhët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë. Në fillim përkthenin në gjuhën serbokroate, e mandej edhe në gjuhët e kombeve dhe kombësive të tjera. Në fillim përktheheteshin më shumë doracakë për ndihmë arsimtarëve dhe nxënësve e më pak monografi dhe punime me karakter shkencor<sup>2</sup>.

Lidhur me zhvillimin e mendimit pedagogjik, rol të madh kanë luajtur revistat pedagogjike. Periodiku pedagogjik kishte për qëllim që të arsimojë dhe të ngrisë në aspektin kulturor njeriun tonë, mësuesin, nxënësin etj.

Që në vitin 1945 paraqiten revistat pedagogjike, në të cilat popullarizohej shkenca pedagogjike dhe teoria marksiste, si bazë e saj. Vitet 1948, 1949, 1950 dhe 1952 janë vite vendimtare për ngritjen e

<sup>1</sup> Dr. P. Shimlesha, Parathënie me rastin e përkthimit të librit të A.M.Danilov, B.P.Jesipov "Didaktika", Prishtinë, 1973;

<sup>2</sup> Ibid.

nivelit shkencor, për forcimin dhe zhvillimin e demokratizimit, sjelljen kritike ndaj të gjitha dobësive në pedagogjinë tonë. Prej vitit 1948 mendimi ynë pedagogjik u pavarësua. Pedagogët tanë të dalluar, në artikujt e tyre, pas Plenumit III të KQ të PKJ-së të vitit 1949, në revistat dhe librat e ndryshëm pedagogjikë që përktheheteshin, i paraqisnin mendimet e tyre kritike dhe silleshin në mënyrë kritike ndaj pedagogjisë sovjetike, duke zbuluar në të elemente të dogmatizmit socialist, të cilat u shprehën fuqishëm edhe në epokën staliniste<sup>1</sup>.

Në këtë periudhë, mendimi ynë pedagogjik zhvillohet dukshëm si original dhe i pavarur, i kushtëzuar me socializmin tonë. Pas vitit 1950 te ne filloj një aktivitet i fuqishëm lidhur me themelimin dhe organizimin e revistave dhe broshurave të reja pedagogjike, siç janë: "Nasha shkolla" - Sarajevë 1950; "Sllobodna pedagogika", Lubjanë 1950; "Shkollske novine", Zagreb 1950; "Nastava i vaspitanje", Beograd 1952; "Jopajtas" (në gjuhën hungareze), Novi-Sad 1953; "Prosveten rabotnik", Shkup 1954; "Pedagoshka stvarnost", Novi-Sad, 1955 etj.

Deri në reformën e shkollimit, në Jugosllavi dilnin afro 33 revista dhe broshura pedagogjike. Më të njohura janë: "Prosvetno dello", organ i shoqatave pedagogjike të Maqedonisë, botahet në Shkup; prej vitit 1945 deri në vitin 1950 dilnin si gazeta që i botonte Ministria e Arsimit e RP të Maqedonisë, kurse prej vitit 1950 dilnin si revista; "Pedagoshki rad" del nga viti 1946, si organ i shoqatave pedagogjike të RP të Kroacisë, me të cilin bashkëpunonin më se 500 shkencëtarë nga vendi dhe bota, "Savremena shkolla" etj. Pas reformës, edhe më tutje themelohen revista dhe broshura pedagogjike. Në vitin 1963 del "Shkollski vjesnik" në Zagreb, më 1962 "Shkolla danas" në Mostar, më 1963 "Pedagogija", revistë e shoqatave pedagogjike jugosllave, "Prosvetna dokumentacija" etj. Në këtë periudhë botahen më shumë revista të përbashkëta në të cilat trajtohet problematika e përgjithshme e shkollës sonë në mendimin teorik dhe praktik.

Si vepër të parë mund ta pranojmë veprën "Opqa pedagogija" në redaktim të S. Patakit, e cila shkruan në fryshtë e ideologjisë përparimtare dhe përfshin ngritjen e përgjithshme të problematikës pedagogjike<sup>2</sup>. Kjo vepër ishte ndihmë e madhe për shumë studentë, arsim-

<sup>1</sup> Dr. Jashar Rexhepagiq. Tema të zgjedhura pedagogjike, "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 1972, f.109;

<sup>2</sup> Dr. V. Muzhiq. Zhvillimi i pedagogjisë sistematike në Kroaci, (1945-1975), Tridhjetë vjet të pedagogjisë dhe shkollës sonë, Zagreb, 1976, f.14;

tarë dhe shkencëtarë të rinj pedagogjikë, si “njoftim me qasjen mark-siste ndaj problemeve pedagogjike...”<sup>1</sup>.

Paralelisht me reformën tonë të parë shkollore që filloi nga viti 1945, disa punëtorëve tanë pedagogjikë iu ofrua mundësia për t'i vizituar disa shtete të ndryshme evropiane, SHBA-të etj., për të fituar përvoja të reja dhe për të këmbyer përvojat e veta mbi disa çështje shkollore dhe pedagogjike, kështu që autorët tanë në bazë të këtyre përvojave pozitive të jashtme dhe tonat ndërtuan një sintezë produkte<sup>2</sup>. Përveç kësaj te ne filloi të botohej literaturë e jashtme pedagogjike, e cila sot është mjaf e pasur.

Duhet theksuar posaçërisht se pedagogët tanë të dalluar përveç numrit të madh të artikujve në revistat pedagogjike kanë zhvilluar edhe një veprimitari të pasur pedagogjike. Vend të posaçëm zë botimi i Fjalorit pedagogjik (1967), i Enciklopedisë, Pedagogjisë I dhe II, punë kolektive e pedagogëve tanë të dalluar, të cilën e botoi “Matica Hrvatska” në Zagreb në vitin 1968 etj.

Për këtë periudhë mund të themi se kemi veprimitari të madhe krijuese, origjinale dhe të përkthyer. Të gjitha veprat që janë botuar tek ne, shkencëtarëve të rinj, studentëve, arsimtarëve etj., u japid bazë pedagogjike për zhvillim të mëtejshëm të shkencës sonë pedagogjike, por para të rinjve mbetej ende detyra që edhe më tutje ta përparojnë mendimin pedagogjik dhe teorik.

Kombësia shqiptare, si pjesë përbërëse e bashkësisë jugosllave, gjatë kësaj periudhe e njuhu shkencën pedagogjike më shumë përmes revistave pedagogjike, që shërbenin si ciceronë për arsimtarin shqiptar dhe në bazë të të cilave ai e zhvilloi veprimtarinë e vet pedagogjike dhe mësimore. Mendimi pedagogjik shqiptar ka filluar të zhvillohet gjatë kohës së Rilindjes Kombëtare, në radhë të parë nga ana e shkrimitarëve dhe pedagogëve shqiptarë, siç janë: Sami dhe Naim Frashëri, Pandeli Sotiri, Petro Nino Luarasi, Nuçi Naçi etj. Të gjithë këta në mënyrë direkte dhe indirekte kanë dhënë një bazë modeste për zhvillim të mëtejshëm. Për zhvillimin e mendimit pedagogjik shqiptar meritë e posaçme u takon për këtë kohë pedagogëve të njuhur shqiptarë: dr. Aleksandër Xhuvanit, Jashar Rexhepagiqit, Hysni Myzeirit, Shefik Osmanit, Nijazi Azizit etj., të cilët përveç punës përkthyese kanë shkruar edhe vepra pedagogjike origjinale. Veprat më të njuhura

<sup>1</sup> Ibid., f.14-15;

<sup>2</sup> Dr. V. Poljak, Gjendja dhe perspektivat e didaktikës sonë, Tridhjetë vjet të pedagogjisë së shkollës sonë, Zagreb, 1976, f.24;

të A. Xhuvanit janë: "DIDAKTIKA" dhe "HISTORIA E PËRGJITHSHME E PEDAGOGJISË", si dhe artikujt e tjerë të botuar në revista të ndryshme pedagogjike<sup>1</sup>. Për ata që nuk kishin përgatitje të mjaftueshme pedagogjike profesionale, këto vepra shërbenin si bazë për fitimin e një kulture të gjerë pedagogjike.

Për zhvillimin e mendimit pedagogjik-metodik te kombësia shqiptare në RS të Maqedonisë, kontribuoi gazeta javore shqiptare "FLAKA E VËLLAZËRIMIT", organ i Frontit demokratik, që botahet në Shkup që nga viti 1945. Kjo gazetë shqiptare, siç thotë dr. Petro Janura, ka qenë abetarja e parë në gjuhën shqipe. Përveç informatave të ndryshme politike dhe kulturore, janë botuar edhe një sërë artikujsh metodikë, të cilët kanë kontribuar që arsimtarët e rinj të njoftohen me disa udhëzime pedagogjike-metodike.

Më vonë, prej vitit 1946, në KSA të Kosovës, në gjuhën shqipe botahet revista kulturore dhe letrare "PËRPARIMI". Në këtë revistë u botuan numër i madh artikujsh me tematikë pedagogjike. Iшин këta artikuj të përkthyer, por edhe origjinalë. Autorët më të njohur janë: dr.Jashar Rexhepagiq, Tajar Hatipi, Nijazi Azizi etj. Në RS të Maqedonisë, në vitin 1961 del revista kulturore-letrare "JEHONA", në të cilën janë botuar materiale me tematikë pedagogjike origjinale ose të përkthyera nga revistat tjera pedagogjike. Po ashtu, në këtë aspekt kanë kontribuar edhe revistat e fëmijëve "GËZIMI" dhe "FATOSI", në të cilat janë botuar numër i madh artikujsh pedagogjikë që ndikojnë në zhvillimin e edukimit moral dhe estetik si dhe në edukimin e aftësisë letrare dhe kreative te fëmijët. Në gazeten "Flaka e vëllazërimit", në vitin 1975 si shtojcë del fletushka "PEDAGOGU" e cila ekskluzivisht merret me çështje teorike-praktike. E gjithë kjo që në Maqedoni është botuar gjatë kësaj periudhe për zhvillimin e mendimit pedagogjik, nuk mjafton. Brengos fakti se në lëmin e metodikës janë botuar artikuj të paktë.

---

<sup>1</sup> Bardhyl Graceni, Aleksandër Xhuvani (Jeta dhe veprat), Tiranë, 1980, f.217-234;

## II

---

### 1. ETAPAT E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS NË RS TË MAQEDONISË

Zhvillimi i shkollës filllore shqiptare kushtëzohet nga rrethanat e zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë maqedone dhe jugosllave dhe duhet t'u përgjigjet nevojave objektive të socializmit vetëqeverisës, pra, strukturës ekonomike dhe superstrukturës shoqërore të vendit tonë. Nga ana tjetër, arsimi dhe shkolla si produkt i një strukture dhe superstrukture të shëndoshë shoqërore, luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm në të gjitha fushat e jetës.

Procesi i krijuar në një sistem të ri shkollor edukativ-arsimor daton që nga çlirimi<sup>1</sup>, pra që nga vetë fillimi i ndërtimit socialist deri në shkallën e sotme të zhvillimit, ndërsa rregullimi i ri shoqëror dhe marrëdhëni shoqërore-politike në mënyrë permanente kanë kërkuar nga shkolla jonë sistem të ri shkollor, njerëz të rinj të arsimuar etj. Ky proces i ndërtimit të së resë, kurse “e reja krijohet kur e vjetra bëhet e tretë” (Lukrecie), ka një kontinuitet të caktuar.

Shkolla filllore shqiptare në RS të Maqedonisë gjatë zhvillimit të saj kalon nëpër disa etapa<sup>2</sup>.

**ETAPA E PARË - Përfshin vitet e para pas çlirimit deri në vitin 1950. Karakteristikë themelore e kësaj etape është transformimi de-**

<sup>1</sup> Dr. M. Ogrizoviq, Zhvillimi i shkollës në territorin e çliruar të Kroacisë, 1941-1945, Zagreb, 1975;

<sup>2</sup> Edukimi dhe arsimimi si veprimtari me rëndësi të posaçme, ka kaluar nëpër shumë etapa të zhvillimit, kurse autorët që kanë trajtuar këtë problematikë bënë ndarje sipas kritereve të tyre: Potkonjak, Nikolla: Etapa e parë prej 1945-1958, etapa e dyte prej 1958, Op.cit.vepra., Bezdanov, Nikoliq: Etapa e parë prej 1945-1955, e dyta 1955-1960, e treta prej 1960-1966, e katërtë prej 1966-1970 dhe e pesta prej vitit 1970 deri në integrimin e arsimimit në sistemin unik të punës së bashkuar.

mokratik socialist në të gjitha fushat e jetës. Në këtë etapë, që është më dinamikja dhe më e vështira, konstituohet shkolla fillore shqiptare mbi parime të barazisë.

Më 26.X.1945 u miratua ligji i parë për shkollimin e obligueshëm shtatëvjeçar për të gjithë fëmijët e moshës 7-14 vjeçare, pa marrë parasysh përkatësinë fetare, nacionalitetin, gjininë dhe statusin social<sup>1</sup>.

Në vitin e ardhshëm, 1946, miratohet Kushtetuta e parë e RPM-së, në të cilën shkollimi i fëmijëve shqiptarë është i garantuar. Shkollat janë të shtetit, mësimi fillor zhvillohet në gjuhën amtare dhe pa pagesë<sup>2</sup>.

Miratohen planprogramet mësimore, sigurohen mjete materiale për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve shkollore, si dhe për shkollimin e kuadrove arsimore përmes kurseve dhe seminareve.

Në këtë periudhë, me rëndësi është edhe miratimi i planit të ri pesëvjeçar (1947-1952). Edukimit dhe arsimimit i përgjigjej sistemi administrativ i qeverisjes.

Prej 10-15 qershor të vitit 1948 u mbajt konferenca e parë, në të cilën në mënyrë të plotë u përpunua sistemi i shkollimit fillor<sup>3</sup>. Kjo etapë përfundon me një (aktivitet të fuqishëm dhe të pasur), kurse në vitin 1949 mbahet Plenumi III i KQ të PKJ-së, i cili rëndësi të madhe i kushtoi arsimit dhe formimit të shkollës dhe u miratua edhe rezoluta nga kjo fushë.

**ETAPA E DYTË - Përfshin periudhën 1950-1960.** Karakteristikat themelore të saj janë: bëhen përpjekje që shkolla fillore shtatëvjeçare të kalojë në tetëvjeçare dhe të jetë e obligueshme për të gjithë. Shkollimi fillor shndërrohet në tetëvjeçar përmes hapjes së klasëve V, VI, VII dhe VIII në shkollat fillore, përkatësisht bashkohen katër klasët e para me progimnazet<sup>4</sup>.

Në vitin 1950 u miratua Ligji për administrimin me ndërmarrjet shtetërore dhe ekonomike. Në këtë vit të rëndësishëm vihen themelet e demokratizmit socialist në lëmin e edukimit dhe arsimimit në shkollë. Në këtë periudhë vend qendror zë reforma e shkollave fillore, të cilat në vitin 1952 (udhëzim i përgjithshëm mbi shkollimin në shkollat për arsimim të përgjithshëm, "shtatëvjeçaret" shndërrohen në tetëvjeçare).

<sup>1</sup> Kushtetuta, JFD, Beograd, 1945;

<sup>2</sup> Kushtetuta e RPM, Shkup, 1946;

<sup>3</sup> Mësimi fillor në RFPJ, Komiteti për shkollë dhe shkencë i RFPJ, Beograd, 1948, Pjesa hyrëse;

<sup>4</sup> Nikolla Potkonjak, Op.cit.vepra, f.41;

Prej 5-7 maj të vitit 1952, në Beograd mbahet Kongresi I i pedagogëve të Jugosllavisë<sup>1</sup>. Ligji i parë për administrimin shoqëror në lëmin e shkollimit filloi prej vitit 1953. Me Kushtetutë, Ligji u miratua në mars të vitit 1955. Me verifikimin e administrit shoqëror në arsim, shuhet KOMISARIATI I ARSIMIT dhe formohen këshillat e arsimit<sup>2</sup>. Shkolla në këtë periudhë mori karakterin e drejtë socialist. Në vitin 1958 miratohet ligji i përgjithshëm për shkollimin. Po ashtu kontribut të madh për zhvillimin e shkollimit jep edhe miratimi i Programit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (Kongresi VI i LKJ-së, 1952).

**ETAPA E TRETË -** Përfshin periudhën 1960-1970. Në këtë etapë, shkollimi fillor shqiptar në RS të Maqedonisë, përvèç ndryshimeve sasiore (ka fituar edhe ndryshime cilësore), dhe sa i përket zhvillimit ka pasur edhe ndryshime cilësore siç janë: shkollimi i arsimtarëve, edukimi dhe arsimimi i nxënësve, përpilimi i teksteve etj. Me miratimin e Kushtetutës së RSFJ-së (1963), arsimimit në Kushtetutën e re i qasen si pjesë përbërëse të kulturës nationale dhe si faktor i zhvillimit shoqëror-ekonomik<sup>3</sup>. Kurse për shkollën fillore me rëndësi të posaçme ka qenë viti 1969, gjatë të cilit janë shqyrtuar dhe analizuar thallisht çështjet e shkollimit fillor. Këto çështje filluan të zgjidhen në pajtim me afatet dhe mundësitë e reja të zhvillimit shoqëror. Në këtë etapë, shkollimi ynë fillor lidhet ngushtë me zhvillimin tonë ekonomik. Po ashtu, kjo etapë është karakteristike për arsyen se shkolla shqipe si qendër edukuese-arsimore dhe kulturore vepron mbi masat e gjera dhe ndihmon që të bëhet emancipimi i femrës, të kapërcehen disa mënyra të jetesës dhe të ndryshojë mënyra e të menduarit. Edhe ai shqiptar, i cili asnijëherë s'e kishte dëgjuar fjalën "shkollë", dëshironë që fëmija i tij të mësojë dhe të kryejë shkollën.

**ETAPA E KATËRT -** Prej vitit 1970-1975. Në këtë periudhë, problemet që dalin nga shkolla jonë fillore nuk do të mund të zgjidhen ndaras - pa lidhshmëri me punën e bashkuar. Kështu, Kuvendi Federativ miraton Rezolutën për zhvillimin e arsimimit dhe edukimit mbi baza vetëqeverisëse (1970), amendamentet e Kushtetutës së RSFJ-së (1971), Rezolutën e Kongresit II të vetëqeverisësve të

<sup>1</sup> U mbajt Kongresi I i pedagogëve të Jugosllavisë. Referatin kryesor e paraqiti dr. Paratski, "Detyrat e metodologjisë në punën shkencore-pedagogjike dhe kërkimore lidhur me rezolutën e Plenumit III të LKJ-së;

<sup>2</sup> Ivo Leko, Qeverisja shoqërore në arsim dhe shkollë "Naprijed", Zagreb, 1958, f.129;

<sup>3</sup> S. Nikolić - M. Bezdanov, Arsimi në Vojvodinë ndërmjet të kaluarës dhe së ardhmes, Novi Sad, 1978, f.69;

Jugosllavisë (1971), Kushtetutën e RSFJ-së (1974), Rezolutën e Kongresit X të LKJ-së mbi detyrat e LKJ-së në transformimin socialist të edukimit dhe arsimimit (1974).

Të gjitha këto dokumente të rëndësishme kishin për qëllim që edukimin dhe arsimimin “ta mbështesin në rrjedhat e shkencës bashkëkohore dhe sidomos të marksizmit si bazë e socializmit shkencor, t'i shërbejnë aftësimit të njerëzve punues për punë dhe vetëqeverisje dhe edukimit të tyre në fryshtë e rrjedhave të revolucionit socialist, etikës socialiste, demokratizimit vetëqeverisës, patriotizmit socialist, vëllazërim-bashkimit”<sup>1</sup>.

Ndryshe nga etapat e mëparshme, për këtë etapë është karakteristike ajo se bëhen “reforma më të vogla”, por vetën në arsimin e mesëm, pra bëhet realizimi i arsimimit të orientuar në RS të Maqedonisë, i cili për herë të parë filloi të aplikohet në vitin shkollor 1974/1975.

## **2. ARSIMI SHQIP SI PJESE INTEGRALE E SISTEMIT EDUKATIVO-ARSIMOR NË MAQEDONI**

Dihet se kombësia shqiptare me shekuj të tërë ndan fatin me kombet e kombësítë tjera të Maqedonisë, përkatësisht Jugosllavisë. Në të kaluarën së bashku i kanë duruar edhe padrejtësitë dhe kanë marrë pjesë në luftërat kundër pushtuesve. Thuhej se historia e kombësive në RSM është histori e vendit dhe e popujve të cilët jetojnë, të cilët ndajnë fatin e përbashkët dhe të cilët ndërtojnë së bashku ardhmërinë më të mirë.

Të gjitha kombësítë në Jugosllavi, kudo që jetojnë ato, “janë pjesëtare të një situate të njëjtë ekonomike, politike dhe kulturore, e cila është e jona dhe e cila këtu, në këtë truall, kur jemi njëlloj të ku-shtëzuar dhe të varur nga të arriturat kulturore dhe teknike në atdheun tonë të përbashkët, në mënyrë që interesat, mirëqenia, rregullimi dhe marrëdhëniet shoqërore të mos janë vetëm të përbashkëta, por edhe të njëjtë”<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Rezoluta e Kongresit X të LKJ-së mbi detyrat e Lidhjes së Komunistëve në transformimin socialist vetëqeverisës të edukimit dhe arsimimit;

<sup>2</sup> AM-Shkup, FM, Mbi problemet e shkollës së pakicave kombëtare, përgatiti G.Janosh, Kut.116, Ark.Njësia 50;

Nga ky kontekst del qartë se shkollat e kombësive nuk mund të jenë të ndara, se në këto shkolla nuk mund të edukohen dhe arsimohen njerëz të tjerë, ngase këto shkolla në esencë paraqesin pjesë të pandarë organike të shkollës jugosllave dhe sistemit shkollor.

Shkolla shqipe në RSM është pjesë përbërëse e shkollës maqedonase, me të drejtë që kjo kombësi të ketë zhvillimin e saj të plotë dhe “çdo gjë që është e nevojshme, për t'i ruajtur dhe zhvilluar veçoritë e tyre pozitive kombëtare, të cilat nuk e dëmtojnë bashkësinë tonë shoqërore”<sup>1</sup>.

Sipas kësaj, puna edukative arsimore në të gjitha shkollat zhvillohet mbi bazë unike socialiste. Në Ligjin për organizimin e shkollave në gjuhën shqipe në Maqedoni, edhe përkundër dispozitave të përgjithshme, ekzistojnë dispozita specifike për shkak të vetë natyrës së pjesëtarëve të kësaj kombësie, siç janë: mësimi në gjuhën amtare; në planprogramet mësimore është e përfshirë Historia kombëtare, edukata e muzikës etj. Të gjitha këto specifika nuk paraqesin pengesë që të realizohen qëllimi dhe detyrat, që të edukohen dhe arsimohen gjeneratat e reja, ashtu siç dëshiron sistemi i atëhershëm shoqëror vetëqeverisës. Në Kushtetutën e RSFJ-së janë përcaktuar qartë parimet të cilat i zgjidhin çështjet nacionale në bashkësinë socialiste në bazë të qeverisjes shoqërore, dhe këtu ndër të tjera, thuhet: “Kombet dhe kombësitë janë bashkuar në Republikën Federative të kombeve dhe kombësive të barabarta dhe kanë krijuar Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, në të cilën interesat e çdo kombi e kombësie, veç e veç dhe të gjitha së bashku, realizohen dhe sigurohen: marrëdhëni shoqërore-socialiste, sistemi shoqëror socialist, liria dhe barazia nacionale, vëllazërim-bashkimi dhe solidariteti i njerëzve punues”<sup>2</sup>.

Kombësia shqiptare në RS të Maqedonisë trajtohej si subjekt në jetën shoqërore vetëqeverisëse si dhe në procesin e ndërtimit të marrëdhënieve socialiste, ashtu si edhe të gjitha kombet e kombësitë tjera të Jugosllavisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në territorin e Maqedonisë, ku jetonin pjesëtarët e kombësisë shqiptare e turke, janë hapur shkolla të posaçme me administrim të posaçëm<sup>3</sup>. Kjo formë e organizuar u ruajt në

<sup>1</sup> Luftha për demokracinë socialiste, Libri VI, f.147;

<sup>2</sup> Hajredin Hoxha, Procesi i afirmimit kombëtar të kombësisë shqiptare në Jugosllavi (Teza doktorature e mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Lublanës, 1973, f.264);

<sup>3</sup> Analiza për gjendjen e disa problemeve në punën e shkollave filllore të pakicave dhe shkollave

mjediset nationale homogjene. Pas ndërrimeve shoqërore-politike të vitit 1950, iu qasën edhe riorganizimit të shkollës, përkatësisht themelohen shkolla mbi parimin territorial, të ashtuquajtura shkolla territoriale, të cilat nga territore të caktuara i përfshinë të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh gjuhën e tyre, por që në to formohen klasë të veçanta për çdo kombësi. Forma e re e organizimit shkollor, në të cilin të gjithë fëmijët edhe më tutje mësojnë në gjuhën e tyre, përveç një varg zgjidhjesh të volitshme organizative-teknike, krahas ruajtjes së plotë të lirisë nationale dhe individualitetit, ka mundësuar pengimin e izolimit nacional, synimin në drejtim të "popullsisë së përgjithshme shoqërore jugosllave socialiste"<sup>1</sup>.

Me miratimin e Rezolutës për zhvillimin e edukimit dhe arsimimit mbi baza vetëqeverisëse (1970), filloi të përforcohet politika e tillë dhe shkolla shqipe si institucion shoqëror-edukativ, gjithnjë e më pak vlerësohet nga pikëpamjet e ngushta nationale, e gjithnjë e më shumë synon nga kultura sociale dhe problemet e saj<sup>2</sup>.

Për shkollën filllore shqipe në RS të Maqedonisë, gjatë kësaj periudhe është diskutuar disa herë nga ana e Këshillit Ekzekutiv dhe organizatat tjera shoqërore-politike. Këshilli Ekzekutiv në vitin 1958 mori vendim që të themelohen këshilla të posaçëm për çështje arsimore lidhur me shkollat e kombësive, ndërkaq u formua edhe këshilli profesional<sup>3</sup>.

Këshilli i arsimit dhe kulturës në RSM kishte detyrë të posaçme që të shqyrtojë parimet dhe çështjet tjera arsimore, që kërkonin masa të domosdoshme për t'u evitar ata faktorë që pengon zhvillimin e shkollës shqipe.

Shkolla filllore shqipe, përveç detyrave dhe qëllimeve të përbashkëta të parapara me Ligjin për arsimimin fillor, për shkak të veçorive të kësaj kombësie, ka pasur edhe disa specifika.

---

të rajoneve të përziera në rrëthin e Shkupit (s.a.) f.19;

<sup>1</sup> G. Janoshi, Shumëkombësia e bashkësisë sonë si faktor në sistemin e judikaturës shkollore, Pedagogika stvarnost, V/1959;

<sup>2</sup> Ibid.f.290;

<sup>3</sup> Gazeta zyrtare e RPM-së, 5, 1958;

### **3. SPECIFIKAT E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS SHQIPE**

RSFJ është e njohur si bashkësi shumënacionale. Me Kushtetutë ishin të garantuara të gjitha të drejtat shoqërore-politike, kulturore dhe ekonomike të kombeve dhe kombësive. Paralelisht me hapjen e shkollës së parë maqedonase, janë hapur edhe shkollat shqipe. Shkolla shqipe në RPM, sipas fizionomisë së saj dhe sipas themelimit dhe orientimit të vërtetë ideologjik dhe edukativ, ishte e njëjtë sikurse edhe shkolla maqedonase dhe shkollat tjera në tërë Jugosllavinë e përbashkët. Dallime qenësore në edukim dhe arsimim nuk ka pasur dhe nuk ka guxuar të ketë. Për shkak të vetë natyrës së pjesëtarëve të kësaj kombësie, janë paraqitur disa specifika, por këto “specifika” nuk duhet kuptuar në aspektin e ngushtë, specifikat kanë të bëjnë vetëm me pjesën arsimore të planprogrameve, e kurrsesi me pjesën edukuese, e cila ka qenë unike për tërë bashkësinë jugosllave<sup>1</sup>.

Në fillim punohej sipas orientimeve që i miratoi qeveria e përkohshme e DFJ. Sipas këtij orientimi, për këtë pakicë, si specifikë pranohej vetëm gjuha amtare<sup>2</sup>. Deri në vitin 1952, në disa republika historia ligjërohej në fryshtë e orientimeve, kurse për pakicat në Maqedoni si dhe Kosovë nuk ligjërohej historia kombëtare e shqiptarëve dhe turqve<sup>3</sup>.

Me përgatitjet reformuese, Komisioni aprovoi parimin që shkolla e obligueshme tetëvjeçare të ketë detyrë të njëjtë edukative-arsimore për të gjitha gjeneratat e Jugosllavisë socialiste. Erdhën në shprehje edhe disa përbajtje të detyrave më shumë arsimuese (e jo edukative), të cilat në pjesën më të madhe i përcaktojnë këto përbajtje dhe dalin nga këto<sup>4</sup>.

Në shkollën fillore shqipe si specifika paraqiten: gjuha amtare (shqipe), gjuha maqedonase dhe historia kombëtare.

Në planprogramet mësimore të vitit 1959, specifikat e lartpërmendura zunë vendet e tyre.

<sup>1</sup> Dr. Svetozar Çanoviq, Problemet specifike të mësimit në shkollat e Kosovës dhe Metohisë, Prishtinë, 1967, f.113;

<sup>2</sup> AM - Shkup, FM. Mbi problemet e shkollave të pakicave kombëtare Kut.116, Ark.Njësia 50, f.10;

<sup>3</sup> AM - Shkup, FM. ibid.f.9;

<sup>4</sup> Dr. Svetozar Çanoviq, ibid.f.113-114;

### *3.1. GJUHA AMTARE (SHQIPE) DHE LETËRSIA*

Gjuha amtare (shqipe) dhe letërsia gjendet në planprogramet mësimore për shkollat filllore dhe është e precizuar detyra për gjuhën dhe letërsinë shqiptare: "... Që nxënësi të njoftohet me veprat letrare të shkrimtarëve shqiptarë, maqedonas, jugosllavë dhe botërorë"<sup>1</sup>.

Detyrat e mësimit të gjuhës shqipe realizohen në specificitetet e gjuhës dhe në përbajtjet nga letërsia e kësaj kombësie, por edhe në veprat letrare me rëndësi të përgjithshme jugosllave dhe botërore<sup>2</sup>.

Problemi qëndron në atë se çfarë qëndrimi do të merret ndaj veprave letrare të atyre shkrimtarëve shqiptarë që gjenden jashtë vendit tonë, e të cilët i takojnë letërsisë ballkanike dhe botërore. Këtu është mjaft e qartë se do të ishte e dëmshme nëse mohohej tradita letrare që është krijuar jashtë vendit tonë. Është e pamundur të largohen nga programi letrar ata shkrimtarë shqiptarë që kanë qenë themelues të letërsisë shqiptare, pa marrë parasysh ku kanë krijuar dhe vepruar. Ata, së bashku me shkrimtarët shqiptarë që kanë krijuar në vendin tonë, përbëjnë një letërsi. Megjithatë, kërkohej që të mbahej llogari për ata shkrimtarë të cilët trajtojnë fatin e përgjithshëm njerëzor dhe shkruajnë për afrimin e kombeve e kombësive. Të tillë ka shumë. T'i marrin për shembull vëllezërit Frashëri, Çajupin, Mjedën, mandej gjeneratën e mesme, Migjenin, Spassen, Xoxën, e deri te gjenerata e re dhe më e reja me Kadarenë, Rrahman Dedajn etj. Kjo vlente njësoj edhe për letërsinë botërore, pa marrë parasysh nga ç'vend e kanë origjinën.

Në atë periudhë nxënësit shqiptarë në shkollën filllore i mësonin edhe shkrimtarët nga RPS e Shqipërisë, si dhe shkrimtarët botërorë për fëmijë që janë të përshtatshëm nga aspekti i ndikimit edukativ ndaj nxënësve dhe se në qoftë se kanë pasur biografi të pastër.(shih shtojcën nr.1).

Jugosllavia si vend i painkuadruar dhe socialist, në planprogramet mësimore duhet të ketë sa më shumë përbajtje nga realiteti socialist dhe t'u kushtojë rëndësi vlerave letrare me rëndësi të përgjithshme njerëzore.

Në vitet e fundit të kësaj periudhe, ishte mjaft aktuale çështja se në ç'masë është përfaqësuar letërsia e kombësive në planprogramet

<sup>1</sup> Shkolla filllore, struktura e përgjithshme programore me planin e mësimit dhe programet, Shkup, 1973, f.21;

<sup>2</sup> Dr. Svetozar Çanoviç, ibid. f.151;

mësimore të popujve tjerë<sup>1</sup>. Po ashtu edhe në ç'masë janë përfaqësuar veprat letrare të popujve fqinj, veprat e të cilëve kanë vlera letrare.

Gjuha amtare (shqipe) në RS të Maqedonisë, si specifikë paraqitet për arsyen se mësimi zhvillohet me këtë gjuhë.

### 3.2. *GJUHA MAQEDONASE*

Në planprogramet mësimore të shkollave shqipe për periudhën që kemi në shqyrtim, ishte paraparë që gjuha maqedonase të mësohet nga klasa e tretë me nga dy orë në javë. Mësimi i gjuhës maqedonase për shqiptarët ishte i obligueshëm: e para, se kjo trajtohej se është gjuhë zyrtare, kurse e dyta, se me mësimin e gjuhës maqedonase kjo kombësi përfshihet direkt në jetën shoqërore-politike dhe ekonomike dhe se kombësitë nëpërmjet kësaj gjuhe hapin derën e gjuhës serbo-kroate që ishte gjuhë e shtetit të përbashkët jugosllav.

Mësimi i gjuhës maqedonase te kombësia shqiptare nuk duhet të krijojë dilema dhe nuk duhet trajtuar si gjuhë e huaj, por as si gjuhë amtare, por duhet kuptuar si "komponentë e rëndësishme në sistemin e arsimimit të përgjithshëm të nxënësve në shkollat e pakicave kombëtare"<sup>2</sup>. Po ashtu, gjuha maqedonase, para së gjithash, përveç anës shoqërore-pedagogjike ka edhe anën e rëndësishme praktike. Kjo gjuhë, kombësisë shqiptare i mundëson njoftimin dhe shfrytëzimin e literaturës së pasur, zhvillon ndjenjën e bashkëjetesës dhe bëhet ndërmjetëse në komunikimin me kombet dhe kombësitë tjera.

Në planprogramet mësimore të vitit 1948, në shtatëvjeçaret, përveç gjuhës maqedonase është kërkuar të mësohej edhe gjuha serbokroate, përkatësisht gjuha kroatoserbe. Por kjo nuk u arrit për shkak të ngarkimit të nxënësve.

Me rastin e përpilimit të reformave është diskutuar mjaft se a thua në shkollat e kombësive zbatohet planprogrami unik mësimor, ngase nxënësi i kombësive në RS të Maqedonisë dhe RS të Sllovenisë nga njëra anë ka qenë i ngarkuar, kurse nga ana tjetër ka qenë në pozitë jo të barabartë. Në fund, megjithatë, është vepruar drejt dhe është e arsyeshme se në planprogramet mësimore ka mbetur vetëm gjuha e re-

<sup>1</sup> Kjo problematikë u shqyrtua në emisionin TV "Sa njihemi";

<sup>2</sup> Mihajlo Pallov, Çështjet shoqërore-pedagogjike dhe disa çështje pedagogjike në mësimin në gjuhën serbokroate në shkollat e pakicave kombëtare "Savremena shkola", nr.5-6/1956, f.101;

publikës amë. Mësimi i gjuhës serbokroate, përkatësisht kroatoserbe ka mund të gjelj vend edhe në shkollat e mesme. Në shkollat fillore, me përvetësimin e gjuhës së republikës krijohet baza solide për përvetësimin e gjuhës serbokroate, përkatësisht kroatoserbe. Për këtë problem janë formuar komisione të veçanta për çështjet e mësimit në shkollat e kombësive. Lidhur me këto probleme është diskutuar mjaft dhe disa kanë ardhur në përfundim se në vendbanimet e përziera me popullatë maqedonase dhe shqiptare, maqedonasit mësojnë gjuhën shqipe<sup>1</sup>. Në bazë të disa procesverbaleve mund të shihet se çfarë reagimesh ka pasur nga prindërit maqedonas, edhe pse në planprogramet hyri si alternativë që të mësohet edhe gjuha e kombësive në vend të gjuhës serbokroate.

### 3.3. *HISTORIA KOMBËTARE*

Kjo lëndë mësimore në planprogramet mësimore, në klasën e pestë përfaqësohet me një orë, kurse në klasën e gjashtë, të shtatë dhe të tetë me nga dy orë<sup>2</sup>. Në planprogramet mësimore është definuar mjaft qartë detyra e këtij mësimi: që nxënësi të njoftohet me të kaluarën e popullit maqedonas, të kombeve dhe kombësive tjera të Jugosllavisë, të zhvillojë dashurinë ndaj kombit dhe atdheut të vetë si dhe ndjenjën e krenarisë që i takon popullit i cili ka luftuar përliri dhe dinjitet njerëzor”<sup>3</sup>.

Në bazë të asaj që është mësuar del qartë se “ndjenja e krenarisë“ nuk vinte parasysh, por detyra primare e mësimit të lëndës së historisë ishte se historia e shqiptarëve është historia e popullit me të cilin jetojnë dhe me të cilin ndërtojnë së bashku të nesërmend.

Edhe pse kjo lëndë mësimore paraqitej si specifikë deri në reformën shkolllore në RP të Maqedonisë, në shkollat shqiptare është pranuar vetëm përgjuhën shqipe<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Analiza e gjendjes së disa problemeve në punën e shkollave fillore të pakicave në rajonet e përziera në rrethin e Shkupit. Problemi i mësimit në gjuhët e pakicave në shkollat e rajoneve të përziera, f.29;

<sup>2</sup> Shkolla fillore, op.cit.vepra, f.438;

<sup>3</sup> Ibid.f.244;

<sup>4</sup> Në disa republika, historia ligjerohej në fyrmen “e kaheve”, kurse në RPM Historia kombëtare e shqiptarëve nuk është ligjruar. Në shkollat me mësim në gjuhën mësimore shqipe ishte pranuar specifika vetëm e gjuhës amtare shqipe;

Me mbajtjen e Konferencës së parë arsimore federative, prej 10-15 janar të vitit 1948 në Beograd, kjo para së gjithash tregoi një mënyrë të re për zgjidhjen e problematikës arsimore, sidomos rrëth çështjes së mësimit fillor. Gjegjësisht, kur bëhej fjalë për programin e historisë në shkollat e kombësive, kërkohej të merret qëndrim unik për tërë vendin dhe me ligj u kërkua që: "Pakicat kombëtare duhet ta mësojnë historinë e kombeve të RFPJ-së, të cilës ato i takojnë si qytetarë të RFPJ-së, ndaj edhe historinë e pakicës së tyre në truallin e Jugosllavisë, si pjesë e saj përbërëse, por jo historinë e kombeve të vendit të dikurshëm amë dhe jashtë kufijve të vendit tonë"<sup>1</sup>.

Kur filloi reforma e shkollës, e sidomos diskutimi për planprogramet mësimore, dolën propozime që nga historia e kombësive në kuadër të historisë së përgjithshme të mësohen ato ngjarje historike të cilat kanë rëndësi botërore<sup>2</sup>.

Nga propozime të ndryshme, megjithatë, në fund u pranua ajo që në kurset e historisë duhet mësuar edhe përbajtjet specifike që i takojnë kombësisë shqiptare në RP të Maqedonisë. Pas reformës, në tekstet e Historisë, në formë aneksesh, u përfshi edhe historia kombëtare e kësaj kombësie, për të cilën u parapanë 7 përbajtje mësimore, me fond të përgjithshëm prej 5 orësh, si të veçanta, dhe 2 orë në kuadër të temave të përgjithshme<sup>3</sup>.

Në programin e historisë kombëtare duhet marrë parasysh ato ngjarje dhe marrëdhënie shoqërore-ekonomike, në të cilat kombet dhe kombësitë tona ishin përfshirë me lëvizjet e përgjithshme historike, duke pasur me këtë rast parasysh momentet me të cilat ishin lidhur të gjitha kombet e kombësítë, njëkohësisht të bëhej fjalë edhe përkundërthëniet që manifestoheshin tek ato.

Këto specifika dalin nga natyra e strukturës heterogjene demografike e popullatës në RS të Maqedonisë, përkatësisht në RSFJ. Këto nuk duhet të paraqesin kurrrfarë pengese në përpunimin e atyre përbajtjeve mësimore që paraqiten si përbajtje plotësuese në shkollën filllore shqipe.

Specifikat që i përmenda, paraqiten vetëm në ato përbajtje mësimore dhe ekzistuese "përderisa në procesin e krijimit të aktivizimit në punën edukuese, nuk realizohet bindja e plotë në ndërgjegjen

<sup>1</sup> R. Teodosiq, Metodika e historisë në shkollën filllore, Mësimi fillor në RFPJ, 1948, f.78;

<sup>2</sup> AM - Shkup, FM, opt.cit.kut.116, f.9;

<sup>3</sup> Shkolla filllore, op.cit.f.258;

e gjeneratës së re të pakicës kombëtare se i përkasin bashkësisë socialiste të popujve jugosllavë”<sup>1</sup>.

Në RS të Maqedonisë, për shkak të specifikave që paraqiten, përherë merren parasysh dokumentet e përgjithshme dhe të veçanta shkolllore, se shqiptarët i gëzojnë të gjitha të drejtat politike, ekonomike dhe kulturore, por shkolla e vetë kësaj kombësie, e kishte për detyrë në të ardhmen të zhvillojë politikë të tillë që gjithnjë e më pak të vlerësohet nga aspekti i ngushtë nacional e gjithnjë e më tepër nga aspekti i përgjithshëm shoqëror, jugosllav dhe socialist i popullatës. Theks dukshëm më i vogël të vihet në specifikat kombëtare, kurse gjithnjë e më i madh në kulturën socialiste dhe në problemet e saj ideologjike<sup>2</sup>. Shkolla shqipe në RSM kërkohej të ketë qëllim të njëjtë dhe është pjesë përbërëse e shkollës maqedonase, përkatësisht jugosllave dhe se vetëm atëherë ka mundësi të njëjta për të marrë pjesë në jetën shoqërore.

#### **4. PROBLEMET PËRCJELLËSE TË SHKOLLËS FILLORE SHQIPE**

Që nga fillimi i themelimit të shkollës së parë fillore shqipe në territorin e Maqedonisë së lirë, organet tona arsimore i janë qasur zgjidhjes serioze të problemeve aktuale që paraqiteshin qoftë për shkak të faktorëve subjektivë ose për shkak të atyre objektivë.

Në periudhën prej 3 dekadash, përkatësisht prej vitit 1945-1975, shumë probleme janë zgjidhur, disa pjesërisht, e disa mbetën akoma evidente dhe kërkonin angazhim edhe më të madh dhe sigurim material.

Nga problemet që janë paraqitur, duhet shqyrtuar ato më të mëdhatë, të cilat e pengonin zhvillimin normal të shkollës fillore.

Një nga problemet e para pas formimit të shkollës fillore shqipe imbi parimet demokratike, kanë qenë botëkuptimet popullore, me të cilat nënçmohej shkolla “Ç’na duhet neve shkolla”.

<sup>1</sup> M. Pallov, Udhëheqësit pedagogjikë dhe problemet edukative-arsimore në shkollat e pakicave kombëtare, Pedagoshka stvarnost, nr.9, Novi-Sad, 1957, f.2-3;

<sup>2</sup> Gaber Janoshi, Shumënacionaliteti i bashkësisë sonë si faktor në sistemin e judikaturës shkolllore, Pedagoshka stvarnost, nr.5, Novi-Sad, 1958, f.290;

#### *4.1. NËNÇMIMI I SHKOLLËS - PËRKATËSISHT “Ç’NA DUHET SHKOLLA”*

Siç kemi theksuar në kaptinat e mëparme, shqiptarët në R. e Maqedonisë para luftës nuk kanë pasur shkollë në gjuhën amtare, dhe e dyta, në shkollat e atëhershme asnjë shqiptar nuk e ka parë ardhmërinë e vet. Pas luftës dhe revolucionit socialist, te disa shqiptarë ishte akoma i pranishëm koncepcioni i vjetër: shkolla nuk na nevojitet, më mirë është të merremi me përpunimin e tokës, kështu që në vitet e para pas luftës disa shqiptarë as që i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë, ngase shkollën e shihnin si “humbje të kohës”. Një pjesë e shqiptarëve i dërgonte fëmijët në shkollë vetëm për të mos paguar dënimë, ndërsa të tjerëve dënimet nuk u pengonin fare, ndaj edhe nuk i dërgonin fëmijët në shkollë. Ja, si një plak e arsyeton pagesën e dënimit për nipërit e tij: “Për shkak të fëmijëve (nipërvë) kam paguar 2.000 dinarë dhe për Zotin, kam llogari që çdo vit të paguaj, vetëm të më lënë të qetë. Pérndryshe, duhet t’i jap 10.000 atij që do të ma ruaj mallin”<sup>1</sup>.

Disa fanaticë, shkollën e shihnin si shkatërrim për fëmijët,shmangie nga rruga e myslimanizmit. Mendonin se fëmijët e tyre nëse kryenin shkolla të këtilla do ta harrojnë fenë dhe prindërit. Shpeshherë disa familje transferoheshin nga njëri vend në tjetrin, vetëm e vetëm që fëmijët e tyre të mos i dërgojnë në shkollë<sup>2</sup>.

Nga viti në vit, mënyra e të menduarit ndërrohej, saqë edhe në fshatra u krijua inteligjencia, e cila propagonte shkollën si rrugë e vetme për një të ardhme më të mirë. Ndodhë që imamët t’i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, ndërsa popullit i thoshin se është mirë që fëmijët e tyre t’i dërgojnë nëpër shkolla fetare. Në periudhën 1960-1975 problemi i nënçmimit të shkollës u tejkalua. Pra, u kuptua nevoja për shkollim dhe shumica e shqiptarëve ishin të gatshëm, madje edhe për sakrifica të mëdha, vetëm e vetëm t’i shkollonin fëmijët e tyre.

<sup>1</sup> Dy mijë dinarë dhe shkollë s’ka, “Flaka e vëllazërimit” e dt.13.I.1954, f.8;

<sup>2</sup> Në fshatin Grupçin të Tetovës në vitin shkollor 1953/54, KKP ishte i detyruar ta ndërpresë klasën e pestë të shkollës fillore, edhe përkundër përpjekjeve dhe masave të jashtëzakonshme. Prindërit nuk u blenin libra fëmijëve të tyre. Sipas raportit të KKP prindërit deklaruan se nuk ka nevojë për shkollim tetëvjeçar të fëmijëve të tyre. Disa familje për t’i mos i dërguar fëmijët e tyre në shkollë, shpërmguleshin në Shkup. Shih. AM-Shkup, FM., Raport i KKP Tetovë për vitin shkollor 1954/55, kut.103;

## 4.2. VIJIMI I MËSIMIT FETAR

Popujt dhe pakicat e Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore krijuan një rregullim pothuaj krejt të ri shoqëror-politik. U realizuan ndryshime të mëdha shoqërore-politike dhe ekonomike në periudhën prej vitit 1945-1975.

Regjimet antipopullore të ish-Jugosllavisë me ideologjinë e tyre reaksionare ishin fajtorë për prapambetjen e shqiptarëve në Maqedoni dhe gjetiu. Pas revolucionit, gjëja e parë që e bëri pushteti popullor është ajo që religjioni, me ligj të ndahet nga shteti. Meqë shqiptarët shekuj me radhë ishin edukuar në frymën e religjionit, kurse religjioni imbeti gjë private e popullit, shumë nxënës me kërkesë të prindërve shkonin edhe nëpër shkolla fetare, edhe pse pushteti popullor në vitin 1946 ua ndaloj fëmijëve prej 7-14 vjet të shkojnë në mektebe. Bashkësia Fetare Islame në Shkup edhe më tutje i obligonte imamët që nëpër fshatra dhe qytete të mbajnë mësim fetar. Në shkollat e këtij lloji shkohej më me ëndje se sa në shkollat shtetërore me arsimim të obligueshëm shtatëvjeçar. Ministria e Arsimit e RPM-së e shqyrtoi këtë dukuri më 14.IX.1946 dhe miratoi udhëzimet për punën e këtyre mektebeve, në të cilat ishin paraparë edhe disa kushte, si:

- që mektebet të kenë planin dhe programin mësimor,
- t'i përbushin kushtet pedagogjike dhe higjenike,
- të mos e pengojnë mësimin e rregullt,
- që mësimet fetare t'i ligjerojnë mbi baza shkencore,
- të kenë kuadër të kualifikuar, dhe
- të jenë nën kontrollin e shtetit<sup>1</sup>.

Edhe përkundër kushteve të parapara, asnjëra nga këto shkolla nuk i plotësonte as pjesërisht këto kushte, por nxënësit i vijonin me vullnet, edhe pse me planprogramin mësimor për vitin 1944/45, lënda e mësimit fetar ishte paraparë si fakultative<sup>2</sup>, nga e cila mbaheshin orë të veçanta.

Të dhëna për vijimin e mësimit fetar për vitet e para nuk kemi, por gjithsesi numri i nxënësve për dy-tri herë ka qenë më i madh sesa në mësimin e rregullt.

Kur ka filluar diskutimi për reformën e shkollës, është diskutuar seriozisht edhe për vijimin e mësimit fetar, si dhe për atë se a i dëmton

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD., Udhëzime për hapjen dhe punën e shkollave fetare, Dok.nr.4692, kut.78;

<sup>2</sup> Plani mësimor për pakicat kombëtare për vitin shkollor 1945/46, "Prosvetno delo", 1945, Shkup;

apo ndihmon ai nxënësit. Nga deklaratat e nxënësve, arsimtarëve dhe punëtorëve tjerë arsimorë, mund të nxirrej përfundimi se vijimi i mësimit të këtillë, në masë të dukshme thuhej se e dëmton nxënësin dhe e ngarkon atë. Edhe përkundër formave dhe metodave të ndryshme të pengimit të këtij mësimi, ai mbahej edhe më tutje.

Në vitin 1959 u miratua Kushtetuta e re e Bashkësisë Fetare Islame, në të cilën u proklamuan ndërrimet në rregullimin organizativ, sidomos në arsimimin fetar. Kur u miratua Ligji për arsimimin e obligueshëm tetëvjeçar të fëmijëve prej 7-15 vjet dhe kur shkolla jonë e ndërtói bazën e saj të shëndoshë, kur prindërit, sipas Ligjit filluan të përgjigjen për jorregullshmërinë dhe shkapërderdhjen e nxënësve, imamët e xhamive e ndryshojnë orarin e mbajtjes së mësimit fetar me fëmijët shkollorë prej 7-15 vjet, dhe fillojnë të punojnë me fëmijët e moshës parashkollore prej 5-7 vjet. Tani mësuesit fetarë dhe prindërit ishin të qetë para ligjeve shkollore. Por, tani, fëmijët e moshës parashkollore ngarkohen me mësimin e një gjuhe të huaj, pra të gjuhës arabe dhe me mësimin e fragmenteve nga Kurani. Nga një raport i Pleqësisë së BFI për RPM-në të datës 10.II.1963, shihet se pas një pauze të vogël, interesimi për mësimin fetar u rrit sërisht. Përveç atyre nxënësve të moshës parashkollore, rrëth 430 nxënës të rritur e vijojnë edhe mësimin e rregullt fetar.

Në periudhën e liberalizimit (1965-1972) numri i nxënësve në këto shkolla rritej çdo vit. Shtatëmbëdhjetë shkolla fetare kanë punuar vetëm në territorin e Shkupit<sup>1</sup>. Nga e tërë RS e Maqedonisë, deri në vitin 1980 në këto shkolla mësimin e kanë vijuar më se 12.000 nxënës dhe kjo shifër nuk flet për një numër bukur të madh<sup>2</sup>. Ky numër, përvëç nxënësve shqiptarë përfshin edhe myslimanët maqedonas, kurse numri i fëmijëve turq ka qenë më i vogël. Vijimi më i theksuar i mësimit fetar ka qenë në rrëthin e Pollogut (Gostivar dhe Tetovë), mandej në Shkup etj. (Shih shtojcën nr.2).

Mësimi i këtillë edhe pse ishte në kundërshtim me ideologjinë marksiste dhe i ndaluar me ligj, ai përsëri ndiqej edhe pse thuhej se tek nxënësit fut iluzion lidhur me socializmin shkencor.

<sup>1</sup> Arkivi i Bashkësisë Fetare Islame të RSM-së, Shkup, Raport për punën e BFI në RSM për periudhën tetor 1964 - tetor 1965;

<sup>2</sup> Arkivi i Bashkësisë Fetare Islame, Shkup, Pasqyrë tabelare për zhvillimin e mësimit fetar sipas këshillave të BFI në RSM, f.2;

#### *4.3. RRJETI SHKOLLOR*

Shkolla fillore shqipe prej vitit 1945-1975 ka shënuar sukses të dukshëm në zgjerimin e rrjetit shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm. Nataliteti natyror i kësaj kombësie në krahasim e popujt tjerë ishte më i madh. Rrjeti ekzistues i shkollave nuk ishte në gjendje t'i përbushë nevojat dhe të ofrojë kushte të mira për punë normale. Të gjithë neve na është e qartë se si është filluar, si është punuar dhe në çfarë kushtesh. Me vite të tëra, vështirësitë materiale paraqisnin problem, por edhe pse nuk ka asnje vend të banuar pa shkollë katërvjeçare, kurse vendet më të mëdha edhe pa tetëvjeçare, kështu që rrjeti ekzistues i shkollës ishte në gjendje t'i përfshijë të gjithë obliguesit shkollorë. Megjithatë, problemi qëndron në atë se në çfarë kushtesh kanë punuar këto shkolla. Pas luftës u miratua një zgjidhje e përkohshme, që në disa vende të hapen shkolla pranë mektebeve të xhamive ose në shtëpitë private. Raste të këtilla kemi në fshatrat Greshnicë, Leshnicë, ndërsa në Kërçovë ende ka shkolla që punojnë nëpër shtëpi private. Shembuj të këtillë kemi edhe në komunat e Gostivarit, Krushevës etj.

Me rastin e ndërtimit të shkollave të reja nuk është zhvilluar politikë e duhur për vendosjen e barabartë të shkollave si në fshat ashtu edhe në qytet. Shumë shkolla të reja u ndërtuan më tepër nëpër qytete se sa nëpër fshatra. Në fshatra, shkolla të reja u ndërtuan me vetëkontributet e fshatarëve dhe të qytetarëve, pa ndonjë plan të posaçëm. Shkollat e këtilla zgjidhnin pothuaj vetëm "problemin momental". Pas një ose dy gjeneratash paraqitej problemi i njëjtë, ndaj vetë qytetarët ndërtonin anekse, lokale.

Problemi themelor i gjendjes ekzistuese prej vitit 1945-1975 është ky: numër i pamjaftueshëm i shkollave tetëvjeçare, numër i pamjaftueshëm i shkollave qendrore dhe vetë fakti se 80 për qind të të gjitha shkollave të përmendura punonin në dy ose tre ndërrime.

Lidhur me gjendjen dhe problemet në lëmin e arsimit fillor, Dhoma arsimore-kulturore e Kuvendit Federativ, në mbledhjen e saj të datës 18 e 19 mars 1964, rekomandon: "Duhet studiuar mundësinë e aplikimit të amortizimit të ndërtesave shkollore dhe zbatimin e një politike fleksibile kredituese-investuese sa u përket fondeve shkollore, të tentohet të përcaktohen masat objektive për investime të përbashkëta të mjeteve të faktorëve të interesuar për këto qëllime. Në ndërtimin e shkollave nevojitet të shfrytëzohen mënyrat bashkëkohore të

ndërtimit të lirë racional, në bazë të prodhimit industrial, duke i respektuar me këtë rast normativat e parapara pedagogjike”<sup>1</sup>.

Gjatë kësaj periudhe rrjeti shkollor është mjaft i përhapur, kurse kushtet normale për punë në disa komuna janë minimale, sidomos nëpër fshatra. Si detyrë mbetet që përveç themelimit dhe ndërtimit të shkollave të reja, të hidhet shikimi edhe në shkollat e vjetra të ndërtuara para lufte ose pas luftës, kur nevoja për shkolla ka qenë e madhe. Në shumë vende puna zhvillohej në dy dhe tre ndërrime.

#### 4.4. FORMIMI I KUADRIT ARSIMOR

Nga kuadri arsimor, si faktor subjektiv, varej në masë të madhe edhe suksesi në këto shkolla. Pas luftës, për shkak të nevojave të domosdoshme për zhvillimin e mësimit në gjuhën shqipe, u angazhuan kuadro arsimore joprofesionale. Kështu, vetëm për 5 vjet, përmes kurseve dhe seminareve të ndryshme u aftësua kuadri arsimor, i cili i plotësonte nevojat e kërkuar, e me këtë u përmirësua edhe struktura kualifikuese. Paralelisht me zhvillimin e rrjetit shkollor dhe vijimin e nxënësve në shkollë filllore, u paraqit nevoja që të angazhohen kuadro të reja mësimore. Për shkak të nevojës së madhe për kuadro mësimore, shumë nxënësve iu ndërpre shkollimi i rregullt dhe u punësuan si arsimtarë në vise të ndryshme të Maqedonisë. Por, atyre që u angazhuan drejtpërsëdrejti pas përfundimit të shkollës tetëvjeçare dhe atyre që kryenin nga një ose dy klasë, u mbeti që përmes studimit me korrespondencë t'i fitojnë kualifikimet e nevojshme. E ky kualifikim zvarritjej me vite të tëra, ndaj kështu shumica e mësuesve, më se 80 për qind, në shkollat filllore shqipe punojnë me arsimim jo të plotë. Deri në reformën e parë, struktura kualifikuese e kuadrit të mësuesve në gjuhën mësimore shqipe ka qenë 7,30%.

Në fillim të zbatimit të reformës së arsimimit fillor, gjendja e kualifikimit të kuadrit mësimor ka qenë e pakënaqshme, sidomos në klasë të larta. Numri i kuadrit arsimor për gjuhën mësimore shqipe dhe turke në mësimin lëndor në vitin shkollor 1961/62, mund të shihet nga pasqyra vijuese:<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Rekomandimi...op.cit., f.70;

<sup>2</sup> Modernizimi i arsimit fillor, Beograd, 1970 f.75;

Kombësitë	num.i ars. profes.	num.i ars. joprofes.	gjithsej arsim. prof.në %
Maqedonas	1423	1432	50%
Shqiptarë	54	236	20%
Turq	9	30	25%
Komb.tjera	120	65	65%
	1606	1763	47,6%

tabela nr. 2 - Struktura kualifikuese e kuadrit mësimor sipas nacionaliteteve

Problemi i kuadrit mësimor të kësaj kombësie, edhe pas zbatimit të reformës ka qenë tejet serioz dhe lidhur me këtë disa herë kanë diskutuar organet arsimore, të cilat i kanë ndërmarrë edhe aksionet konkrete<sup>1</sup>.

Kur kuadri mësimor vendoste vetë për vendet e punës, e jo siç ishte më parë sipas direktivës së Ministrisë, kuadri i kualifikuar i braktiste fshatrat dhe shkonte në qytete, ndaj kështu krijohej grumbullimi i arsimtarëve nëpër qytete, kurse ata arsimtarë që nuk gjenin punë në profesionin e tyre punësoheshin në administratë. Përqindja e kuadrit joprofesional është në rritje permanente. Për vitin shkollor 1964/65 në mësimin klasor ka qenë 20,25%, kurse në atë lëndor 68,53%.

Në mësimin lëndor situata edhe më tej është e vështirë, ngase grupi për gjuhë shqipe ekziston vetëm në Akademinë Pedagogjike në Shkup dhe është mjaft i madh. Në grupet tjera në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën maqedonase kishte tejet pak studentë. Në klassë të larta akoma punonin arsimtarë që kanë të kryer shkollën normale (shih shtojcën nr.3). Struktura kualifikuese e kuadrit mësimor në mësimin klasor përmirësohet nga viti në vit, dhe në vitin shkollor 1971/72 është 6,92%, kurse ajo lëndore 54,92%. Me shuarjen e shkollave normale në RS të Maqedonisë, situata filloj të ndryshojë rrënjësisht, ashtu si edhe arritja e suksesit në shkolla, nga shkaku se shumica e studentëve që regjistroheshin në Akademinë Pedagogjike dhe në fakultete, pas vitit të parë i braktisnin studimet dhe punësoheshin nëpër shkolla pa përgatitje të duhur pedagogjike. Prej vitit 1973/74 e më tej, lëndët mësimore i zhvillojnë kryesisht gjimnazistë, sidomos matematikën, fizikën, kiminë, artin muzikor, atë figurativ, edukatën fizike etj. Deri në vitin

<sup>1</sup> Motivimi i nxënësve përmes veprimit të bursave si dhe masave praktike, puna individuale me grupe të veçanta për shkak të përvetësimit të gjuhës maqedonase, sigurimi i konviktit, shtëpive si dhe disa lëndëve mësimore që të ligjerohen në gjuhën shqipe;

1975 situata në fshatrat e Shkupit: Rashçe, Studeniçan, Sveti Petkë, Paligrad, Grushinë; të Titov Velesit, Krushevës dhe Demir Hisarit, ishte e atillë saqë akoma punonin arsimtarë me arsimim jo të plotë edhe në mësimin klasor<sup>1</sup>.

## 5. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE

Masiviteti i arsimimit në RS të Maqedonisë, pas çlirimt, në etapa të ndryshme, ka pasur veçori të ndryshme. Në etapën e parë, të gjitha forcat e pushtetit popullor dhe organet arsimore u orientuan në mësimin e shkrim-leximit për popullin, hapjen e një numri sa më të madh të shkollave katervjeçare, përgatitjen e personelit arsimor, në mënyrën më të shpejtë të botimit të teksteve etj. Qëllimi kryesor i politikës arsimore në R. e Maqedonisë ishte që të hapen numër sa më i madh shkollash fillore, ku do të edukoheshin dhe arsimoheshin gjeneratat e reja në fryshtë e socializmit, vëllazërim-bashkimt dhe të realizohej plotësisht arsimimi fillor.

Për realizimin e shkollimit të obligueshëm, para së gjithash, shkolla duhet të jetë e karakterit shtetëror, fillet e së cilës u dukën pas luftës dhe janë sanksionuar me Kushtetutën e vitit 1946. Në etapat e ardhshme, shkolla shqipe dhe shkollat e kombësive tjera në R. e Maqedonisë, përjetojnë ndryshime sasiore dhe cilësore. Të dhënat statistikore na flasin për një rritje të përhershme dhe dinamike të arsimit fillor: mbi rritjen e numrit të shkollave fillore, numrin e nxënësve dhe shtimin e përfshirjes së gjeneratave të të moshuarve që vijonin shkollën fillore.

Në vitin shkollor 1944/45 numri i nxënësve në shkollën fillore ka qenë 3.975, dhe menjëherë në vitin e ardhshëm 1945/46, numri i nxënësve të kombësisë shqiptare është rritur për 4 herë (prej 3.975 në 15.454)<sup>2</sup>.

Në vitet e para të realizimit të shkollimit fillor kishte vështirësi të ndryshme. Një nga faktorët e rëndësishëm për realizimin e arsimimit obligues ishte kuadri mësimor dhe rrjeti shkollor dhe këto kanë qenë vështirësi të natyrës objektive. Në anën tjetër, në shkollën fillore shqipe paraqiteshin edhe faktorë subjektivë si: ndikimi i madh i reli-

<sup>1</sup> Informatë nga këshilltari i pavarur pedagogjik i Entit Republikan të Shkollimit në RSM, Feim Isai;

<sup>2</sup> Buletini vjetor i RSM-së, 1954, Shkup, f.280;

gjionit në mënyrën e të menduarit të disa prindërve, e me këtë paraqiteshin edhe vështirësi për pranimin e konцепционit të shkollës socialiste. Edhe faktorët objektivë edhe ata subjektivë shpeshherë shpienin nga ajo se ligji për shkollimin e obligueshëm nuk zbatohet plotësisht.

Problemi i përfshirjes së nxënësve të kombësisë shqiptare në shkollën fillore në këtë etapë, është në lidhje të drejtpërdrejtë edhe me diferençën e madhe ndërmjet obliguesve dhe të regjistruarve, të regjistruarve dhe kalimtarëve dhe atyre të cilët fare nuk e vazhdonin shkollimin ose nuk regjistroheshin. Pa marrë parasysh këtë, numri i nxënësve të kësaj kombësie nga viti në vit shënon rrëtje, e për këtë na flet edhe tabela vijuese:<sup>1</sup>

Viti shkollor	numri i të përfsh.	Indeksi
1944/45	3.975	100
1945/46	15.454	388
1946/47	15.980	103
1947/48	20.714	129
1948/49	25.399	122
1949/50	26.385	103
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>107.907</b>	

tabela nr.3 - Lëvizja e numrit të nxënësve dhe përfshirja e fëmijëve

Gjatë planit të parë pesëvjeçar të ndërtimit të socializmit (1947-1951), ku parashihej që arsimi fillor (katërvjeçar) të realizohet 100 për qind, kurse 60 për qind ai shtatëvjeçar, në disa komuna që në vitin 1947/48 u arrit përfshirja e fëmijëve prej 100 për qind. Në vitin shkollor 1949/50 nxënësit që kishin mbaruar katër klasë ishin përfshirë me vetëm 30 për qind në shtatëvjeçare. Në shtatëvjeçaret u regjistruan vetëm fëmijët meshkuj, ndërsa fëmijët femra mund të gjendeshin vetëm në qytete, dhe atë fëmijë femra, prindërit e të cilave ishin punëtorë arsimi ose luftëtarë.

Nga tabela vijuese<sup>2</sup> do të shohim se sa nxënës dhe nxënëse ishin përfshirë në shkollë.

<sup>1</sup> Ibid.f.280;

<sup>2</sup> AM - Shkup, FD, Vendim i Qeverisë së RPM-së për përfshirjen e fëmijëve që i nënshtrohen shkollimit të obligueshëm në shkollat fillore, kut.29,

Përfshirja e fëmijëve, rëndom varej edhe nga sigurimi i kuadrit mësimor. Në vitin 1949, për tërë Maqedoninë ishte paraparë që 168.350 fëmijë të regjistrohen në shkollën fillore, numër ky nga i cili 42.320 fëmijë nuk ishin përfshirë fare. Nga ata që vijonin shkollën fillore (126.030), të parregullt kanë qenë 14.253, që do të thotë se në RSM ka pasur edhe 56.573 analfabetë<sup>1</sup>.

Ministria e Arsimit dhe këshillat popullore angazhoheshin sin-qerisht për të fituar numrin definitiv të nxënësve në shkollimin e obliguar. Kështu, më 12 korrik 1950, Ministria e Arsimit e RPM-së mbajti mbledhje me këshilltarët arsimorë dhe kulturore të rrtheve, përkatësisht me këshillat e qyteteve. Këtë mbledhje personalisht e kryesoi ministri i atëhershëm i Arsimit, Dimçe Mire, u miratuan edhe konkluzat, ndërsa në mesin e më të rëndësishmeve ishte edhe përfshirja e nxënësve qind për qind në vitin e ardhshëm shkollor. Komisariati i atëhershëm i Arsimit ishte i ngarkuar të zhvillojë fushatë përpërfshirjen e fëmijëve që i nënshtroheshin shkollimit të obliguar, dhe deri më 25 shtator 1950 të njoftohej Ministria<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Sekretariati Republikan i Arsimit: Zhvillimi i deritashëm i mësimit të obliguar tetëvjeçar, Pjesa I, Shkup, 1964, f.10;

<sup>2</sup> Ibid.f.10;

LISTA

KOMUNA	Nxënës të paraparë			Të përfshirë			Shk.	Kl.	Ars.	%
	m.	f.	gj.	m.	f.	gj.				
Manastir	212	143	355	212	143	355	1	7	5	100
Kumanovë	213	148	361	189	99	388	1	6	5	80
Ohër	76	53	129	76	53	129	1	3	2	100
Shkup	575	218	793	524	194	718	1	16	11	91
Tetovë	842	708	1550	747	411	1158	1	20	21	101
R.Manast.	268	219	487	249	184	433	8	12	9	89
R.Gostiv.	3314	2273	5587	2711	1227	3938	27	76	54	70
Gj.Petrov	1479	1024	2503	889	133	1022	20	24	21	41
Dibër	402	329	731	381	279	660	6	13	13	90
Demir H.	107	83	190	91	57	148	2	3	2	78
Kërçovë	1507	839	1896	794	457	1251	18	28	26	66
R.Kumano.	1607	1020	2627	1265	472	1737	18	32	13	66
Krushevë	254	164	418	254	164	418	4	8	4	100
R.Ohrit	27	13	40	27	8	35	1	1	2	88
Prilep	209	149	358	168	60	228	3	5	4	64
Resnje	265	252	518	243	244	487	6	12	8	94
Strugë	1042	696	1738	819	553	1372	15	27	20	79
K.Shkupit	-	-	993	443	1436	17	22	20	-	-
T.Veles	261	217	478	101	-	101	4	1	2	21
K.Tetovës	3475	2562	6037	2771	1160	3931	33	74	50	65

Tabela është bëre në fillim të viti shkollor 1947/48

Në vitin shkollor 1950/51 përfshirjen e fëmijëve në shkollimin e obliguar u bë mjaft, kështu që numri i nxënësve rritej ngase u përfshinë edhe një numër i madh nxënësish prej 8, 9, 10 vjet të cilët nuk kishin pasur mundësi që të vijonin më herët shkollimin ose që vetë prindërit nuk i kishin paraqitur. Numri i nxënësve të kombësisë shqiptare, gjatë këtij viti kryesisht sillet në suaza të natalitetit natyror (shih tabelën në shtojcë).

Përfshirja e nxënësve ishte problem edhe në klasët e larta, prej klasës së pestë deri në të shtatën, përkatësisht klasën e tetë. Deri në vitin 1956/57, kjo përfshirje rrjedh ngadalë në krahasim me përfshirjen e nxënësve në shkollimin katërvjeçar. Për këtë na flet edhe tabela vijuese:

Viti shkollor	I-IV	V-VII-VIII	Gjithsej
1951/52	23253	1318	24571
1952/53	21233	2153	24573
1953/54	19761	2815	23576
1954/55	22361	3212	22573
1955/56	22512	2785	25279
1956/57	24746	6994	31740
1957/58	25078	6981	31459
1958/59	23255	6494	29749
1959/60	23195	6276	29469

tabela nr.4 - Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollën fillore shqipe 1951/52 - 1959/60

Sic shihet nga tabela, numri i nxënësve në shkollën tetëvjeçare është në rritje e sipër.

Numri i nxënësve të përfshirë në vitin shkollor 1945/46 shënon indeksin 100, në vitin 1958/59 është 181,8 te kombësia shqiptare, kurse te maqedonasit është 107, te turqit 180,32, që do të thotë se edhe shkolla maqedonase, shqipe e turke janë në pozitë të barabartë.

Prej çlirimt deri në vitin shkollor 1958/59, numri i nxënësve të përfshirë në shkollat katërvjeçare fillore është rritur për 6 herë, indeksi 630,8%, kurse numri i nxënësve në klasa të larta për 11 herë, indeksi 1.802,5%.


Pas reformës, shkolla fillore shqipe në RS të Maqedonisë zhvillohet me një temp mjaft të shpejtuar. Sekretariati i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, gjatë vitit shkollor 1963/64 organizoi këshillim me tru-

pat arsimorë republikanë të rrtheve dhe komunave, në të cilin diskutohej përfshirjen e nxënësve prej klasës së pestë deri në të tetën. Po ashtu në këtë këshillim u dha analiza dhe u paraqitën rezultatet: deri në vitin 1961/62 në shkollat fillore katervjeçare në tërë RSM-në ishin përfshirë 94,07% nga gjenerata që i nënshtrohej shkollimit të obligueshëm. Rezultatet kanë qenë relativisht të mira në krahasim me republikat tjera, përfshirë shembull në RSK - 100%, RSS - 98,6%, në RS BeH 92,07%, në RSMZ - 91,07%. Mesatarja jugosllave ka qenë 94,2%<sup>1</sup>.

Në klasat e larta në RS të Maqedonisë përfshirja e nxënësve ishte 73,77%, kurse mesatarja jugosllave 72,3%<sup>2</sup>.

Prej viti 1960 në klasat e ulëta të shkollës filllore stabilizohet numri i nxënësve, kurse në klasat e larta numri i tyre shtohet. Në vitin shkollor 1962/63, në klasën e pestë ishin të regjistruar 81,0% të atyre që kishin kryer klasën e katërt. Në klasat e mëtejshme kjo përqindje zvogëlohet dukshëm, e sidomos te fëmijët femra. Për të pasur një pasqyrë të qartë se si është zhvilluar ky proces, do ta paraqes në grafikon:

Bashkëraporti ndërmjet fëmijëve meshkuj dhe femra



Në grafikon mund të shihet se çfarë është rapporti ndërmjet fëmijëve meshkuj dhe femra. Ky raport është mjaft brengosës, edhe pse ka ekzistuar tendencia që të barazohet.

Me realizimin e parimit territorial u krijuat shtimi i dukshëm i numrit të nxënësve në klasa të larta. Me shtimin e numrit të shkollave territoriale prej 103 në vitin shkollor 1962/63, në 147 në vitin shkollor 1964/65, po ashtu disa shkolla fillore katervjeçare kalonin në pesëvjeçare, gjashtëvjeçare, shtatëvjeçare, tetëvjeçare dhe kështu u

<sup>1</sup> Ibid, fq.10

<sup>2</sup> Ibid, fq.10

mundësua që në klasat e larta të përfshihet një numër i madh nxënësish.

Procesi i përfshirjes së fëmijëve të kombësisë shqiptare është në rritje, për arsyen se ishte siguruar kuadër e po ashtu ishte zhvilluar edhe rrjeti shkollor, kështu që në klasa të larta çdo vit e vazhdojnë shkollimin nga 1000 nxënës:

Viti shkollor	I-IV	V-VIII	Gjithsej
1965/65	25263	11566	36829
1965/6	26228	12507	38735
1966/67	27956	13470	41426
1967/68	29456	14279	23735

Tabela nr.5 - Pasqyrë krahasuese e nxënësve të klasave të ulëta dhe të larta të shkollës fillore

Nga tabela shihet qartë se në shkollën fillore katërvjeçare ndryshimet tanimë kishin filluar. Natyrisht, edhe vetë koha kërkonte njerëz të dijshëm, jo vetëm në industri por edhe në bujqësi.

Prej vitit 1970 deri në vitin 1975 numri i nxënësve të përfshirë të nacionalitetit maqedonas dhe të kombësisë turke stagnon, kurse i kombësisë shqipe është duke u rritur shpejt. Në vitet e fundit, kombësia shqiptare në RS të Maqedonisë është në rritje prej 13,0% në 17,0%, kurse rënie shënon numri i turqve prej 9,4% në 6,6%. Po ashtu rënie shënon edhe numri i maqedonasve për 2%<sup>1</sup>.

Nëse për vitin shkollor 1968/69 merret indeksi 100%, tempi i rritjes do të ishte si vijon: për vitin shkollor 1970/71 për maqedonasit e të tjerët 97,13, për shqiptarët 121,43, për turqit 97,77, për vitin shkollor 1971/72, për maqedonasit 97,76, për shqiptarët 125,30, për turqit 96,87 etj. Edhe përkundër këtyre proceseve të shpejtuara, përfshirja e fëmijëve të kombësisë shqiptare në shkollimin e obliguar nuk është realizuar qind për qind. Në mesataren republikane janë përfshirë vetëm 90% të fëmijëve të moshës 7-15 vjeçare. Deri në vitin 1975/76, në shkollën fillore ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, janë përfshirë 67.817 nxënës në 2.201 paralele<sup>2</sup>. Vetëm për 5 vitet e fundit numri i nxënësve është në rritje për 14.783. Rritje më e madhe e numrit të nxënësve vërehet në komunat: Shkup, Dibër, Tetovë, Gostivar dhe Kërçovë.

<sup>1</sup> Buletini statistikor i RSM-së, 1975.

<sup>2</sup> Enti republikan për përparrimin e shkollave në RS të Maqedonisë.

## 5.1. SHKAPËRDERDHJA E NXËNËSVE

Që të realizohej shkollimi i obligueshëm fillor i kombësisë shqiptare, nuk është në pyetje vetëm numri i nxënësve të përfshirë, por edhe numri i cili tregon se sa nxënës e kryejnë shkollimin fillor. Përfshirja dhe kryerja e shkollës fillore janë dy anë të një problemi që trajtohet. Pas çlirimit e deri në vitin 1950, pra në periudhën e parë të zhvillimit të shkollimit fillor, nuk kemi të dhëna të sakta se sa nxënës janë përfshirë në shkollë dhe sa prej tyre e përfundojnë atë, ngase në periudhën e vjeshtës dhe pranverës shumë nxënës nuk e vijojnë mësimin për shkak të punëve bujqësore, ndaj shpeshherë nxënësit imbeteshin të panotuar. Nga viti në vit, me organizim të plotë të organeve arsimore, së bashku me këshillat popullore dhe arsimtarët, janë arritur rezultate relativisht të mira.

Të dhënat statistikore janë paraqitur në tabelën që vijon, nga fillimi i vitit shkollor 1947/48 për të gjitha shkollat në gjuhën shqipe në RS të Maqedonisë. Është paraqitur edhe shkapërderdhja e nxënësve sipas klasëve<sup>1</sup>.

Klasa	Meshkuj	Femra	Gjithsej
I	5609	5515	11124
II	4104	1766	5870
III	3230	639	3869
IV	1416	302	1718
Gjithsej	14360	8221	22581

Tabela nr.6 - Shkapërderdhja e nxënësve për vitin shkollor 1947/48

Në bazë të tabelës mund të konkludohet qartë se në klasën e tretë dhe të katërt bëhet shkapërderdhja e nxënësve edhe atë te femrat, në klasën e katërt numri zvogëlohet për 18,26, kurse numri i fëmijëve meshkuj për 3,96.

Problem më të vështirë paraqiste shkollimi i fëmijëve femra. Ky problem rëndom varej nga tradita, ndjenjat fetare dhe botëkuptimet e prindërve se vajzat nuk duhet ta vijojnë shkollën, kështu që deri në vitin 1947/48, në asnjë komunë fëmijët femra nuk vijojnë mësimin në mënyrë të kënaqshme. Në fillim arsimtarët më të vjetër ndërmerrnin

<sup>1</sup> AM, FD. Të dhënat statistikore të lëvizjeve të nxënësve në fund të vitit shkollor 1944 dhe në fillim të vitit shkollor 1948 kut. 74.

disa masa, zhvillonin biseda, i bindnin nxënësit dhe prindërit, kurse në fund u rrekeshin edhe dënameve<sup>1</sup>.

Në klasat e larta të shtatëvjeçareve, numri i nxënësve meshkuj ka qenë tejet i vogël, ndërsa vajza pothuaj nuk ka pasur fare. Në klasat e larta vazhdonin shkollimin vetëm ata nxënës të cilët nga aspekti ekonomik ishin të siguruar. Në shumë fshatra nuk kishte shtatëvjeçare kështu që nxënësit detyroheshin të ecin nga disa kilometra deri në fshatin e afërm ku ekzistonë shtatëvjeçarja. Numri i shtatëvjeçareve ka qenë i vogël, kështu në çdo komunë ekzistonin një ose dy shkolla shtatëvjeçare (shih shtojcën nr.4). Përveç shtatëvjeçareve, në fshatra dhe në qytete ekzistonin edhe konviktet, por prindërit e kishin mjaft vështirë të vendosnin për t'i dërguar fëmijët e tyre në shkollim, ngase atëherë do t'u mungonte fuqia e punës në bujqësi ose në blektori, ndërkaq, shkollimi i mëtejshëm i fëmijëve femra nuk vinte parasysh.

Kur u aplikua shkollimi i obliguar tetëvjeçar, në pjesën dërrmuese të fshatrave filloj i ndërtimi i shkollave të reja dhe kështu një numri të madh të nxënësve iu mundësua vazhdimi i shkollimit. Kështu, organet arsimore filluan të zhvillojnë fushatë për këtë kombësi, në mënyrë që sa më shumë prej tyre t'i kryejnë klasat e larta të shkollës filllore. Të dhënët flasin se edhe më tutje, te kombësia shqiptare realizimi i shkollimit të obliguar nuk e kishte plotësuar atë që pritej. Sa për ilustrim do ta përmend vitin shkollor 1952/53: në shkollën filllore në fshatin Zajaz afér Kérçovës, kur gjatë atij viti u hap klasa e pestë, nga të gjithë nxënësit e regjistruar (dy klasa të katërtë) në fund klasën e pestë e kryen vetëm 17 nxënës, pa asnjë vajzë<sup>2</sup>.

Me miratimin e Ligjit për arsimimin e obliguar tetëvjeçar, prej 7-15 vjet, të gjithë nxënësit që kishin kryer shkollat katërvjeçare nuk e vijuan shkollimin në klasat e larta ngase në klasa të larta u shkaktua një shkapërderdhje që sillej prej 80-90%.

Për të pasur një pasqyrë të qartë, do t'ua prezentoj të dhënët tabellare për vitin shkollor 1951/52.

<sup>1</sup> Informatë e mr. Abedin Zenkut, ish-mësues dhe inspektor i shkollave të rrëthit të Kérçovës i cili çdo të shtunë e të dielë ka organizuar biseda me prindërit nëpër fshatra për shkak të dërgimit të vajzave në shkollë;

<sup>2</sup> Arkivi i shkollës tetëvjeçare qendrore "Rexhë Rushit Zajazi", fshati Zajaz-Kérçovë, Raport për vitin shkollor 1952/53 (Materiali nuk është rregulluar)

KOMUNA	Shkolla V-VII	Meshkuj	Femra
Tetovë	3	287	55
Gostivar	2		
Dibër	1	92	25
Kërçovë	1	33	
Kumanovë	1		
Ohër	2	140	28
Prilep	1 (V)		18
Resnjë	1		26
Strugë	2		
Krushevë	1		

Tabela nr.7 - Shkapérderdhja e nxënësve në klasët e larta të shkollës fillore

Gjendja më kritike ka qenë prej klasës IV-VIII, e sidomos përfëmijët femra. Shkollimi i fëmijëve femra nëpër fshatra ka qenë nën mesataren normale, për arsy se “prindërit shkollimin e femrës e kon sideronin si të panevojshëm. Deri në klasën IV shkollimi zhvillohej normalisht, kurse në klasat e larta fëmijët femra mbeteshin pas, e nëse ndonjëra prej tyre vazhdonte mësimin, gjithsesi kjo do të thotë se prindërit u frikoheshin dënameve<sup>1</sup>.

Vazhdimi i shkollimit të mëtejshëm të fëmijëve shqiptarë më së shumti varej nga vetë prindërit. Kështu, disa prindër gjenin forma të ndryshme se si ta pengonin shkollimin e fëmijëve të tyre. Për shembull, femrat të cilat deri në klasën III tregonin sukses të shkëlqyeshëm, në klasën IV tregonin sukses të dobët, për arsy se prindërit e tyre sistematikisht i pengonin të mësojnë, që si e si të tregojnë sukses të dobët në mënyrë që pastaj të mos e vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm<sup>2</sup>.

Edhe përkundër asaj se disa prindër paguanin dëname në para ose vuanin dënimet me burg, disa prej tyre fëmijët e tyre i deklaronin si të “retarduar”<sup>3</sup>.

Në disa arkiva shkollorë, për shembull në Shkollën Fillore Qendrore të f.Zajaz - Kërçovë, prej vitit 1960-1970, mund të gjenden rreth

<sup>1</sup> Bllaga Petrovska, Format e familjes në rrëthin e Tetovës (temë doktorature e mbrojtur në Fakultetin Filozofik në Shkup 1965), f.160;

<sup>2</sup> Ibid.f.161;

<sup>3</sup> Ibid. f.162;

35 vërtetime mjekësore të lëshuara me kërkesën e prindërve, të cilat i lëshonin mjekët, te të cilët etika e mjekut ishte e fjetur. Në bazë të këtyre vërtetimeve mjekësore, disa vajza çregjistroheshin nga shkollimi i rregullt dhe shpalleshin si “të sëmura mentalisht”<sup>1</sup>. Po ashtu ka edhe raste të tilla që disa prindër vajzat e veta prej klasës III deri në atë të IV “i fejonin” kështu që nuk kishin mundësi për ta vazhduar shkollimin në klasat e larta, ngase prindërit u ofronin “martesë të dhunshme”.

Kur u miratua Ligji për shkollimin e obliguar tëtëvjeçar prej 7-15 vjet, gjykatat për kundërvajtje në të gjitha komunat kishin shumë punë. Vetëm në rajonin e Pollogut janë dënuar:

Viti	1953	1963	1964
të dënuar	268	880	553

Dënimet ishin simbolike, ndaj numri i të dënuarve nga viti në vit rritej, gjë që më shumë vërehet në komunën e Krushevës, Kërçovës dhe Titov Velesit.

Shkapërderdhja e nxënësve deri në klasën IV, prej vitit 1955 deri më 1960 ka qenë 20% për një gjeneratë, kurse kalimi prej klasës IV-V është mbi mesataren republikane, siç shihet nga tabela:

Gjeneratat	Përq.e nx.të regjis.në kl.4		Përq.e nx.të regjis.në kl.5		Përq.e nx.të Regjis.në kl.8	
	repub.	shqipt.	repub.	shqipt.	repub.	shqipt.
1955/56						
1962/63	75	80	59	41,42	39	18,55
1956/57						
1963/64	77,95	69,87	66,34	44,32	47,78	20,58
1957/58						
1964/65	83,83	73,76	72,54	49,24	43,47	21,29
1958/59						
1965/66	87,24	74,76	83,81	56,00	44,83	23,84
1959/60						
1966/67	89,09	84,34	76,04	60,73	45,71	29,26

Tabela nr.8 - Vëllimi i shkapërderdhjes së gjeneratës, repub.I për fëmijët shqiptarë

<sup>1</sup> Arkivi i Shkollës Qendrore “Rexhë Rushit Zajazi”, f.Zajaz, Kërçovë, Libri kryesor dhe raportet (materiali nuk është rregulluar) për vitin 1967, 1968, 1970, 1974;

Nga kjo tabelë mund të konkludohet se në klasat e larta shkapérderdhja ka qenë më e madhe nga ajo normale. Kësaj shkapérderdhjeje më shumë i kontribuon numri i zvogëluar i fëmijëve femra (shembull gjenerata 1958/59 - 1965/66 shkapérderdhja ka qenë 18,50%).

Enti Republikan për Përparimin e Shkollimit i RS të Maqedonisë merrej me problemin e shkapérderdhjes së nxënësve në shkollën fillore. U bë edhe shkapérderdhja në 20 shkolla fillore (nga aspekti nacional-të përziera dhe homogjene). Nëpër shkolla u zbatuan anketa. Sipas të dhënave, situata ka qenë ashtu siç është paraqitur në tabelën vijuese:

Viti shollor	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1957/58			
1964/65	45,60	23,31	33,91
1958/59			
1965/66	40,98	18,22	30,46

Tabela nr.9 - Vëllimi i shkapérderdhjes ndërmjet gjinive (paraqitja në përqindje)

Siç shihet, realizimi i arsimimit tetëvjeçar është nën mesataren republikane, sidomos te fëmijët femra.

Në shkapérderdhjen e nxënësve, përveç faktorëve subjektivë, veprojnë edhe faktorët objektivë, siç janë: rrjeti i pamjaftueshëm shkollor, kapaciteti i pamjaftueshëm në shkollat fillore qendrore, në të cilat sipas hulumtimeve, vetëm për shkak të këtij faktori shkapérderdhja është 2,22%<sup>1</sup>, që kishte të bëjë me defektet fizike, vdekjet, sëmundjet, ngecjet në zhvillimin mendor, me lëvizjet migruese, me mossuksesin dhe kushtet e punës në shkollë.

Edhe përkundër shkaqeve objektive, në shkollën fillore shqipe vepronin më shumë shkaktarë subjektivë dhe përveç atyre simbolike, dënimet janë (prej 20-30 e më së shumti 100 dinarë të rinj), askush tjetër nuk është thirrur në përgjegjësi dhe situata deri në vitin 1970 ka qenë brengosëse (shih shtojcën nr.5).

Viteve të fundit situata ka filluar të ndryshojë, shkapérderdhja e nxënësve është me intensitet të zvogëluar, e për këtë flasin edhe të

<sup>1</sup> Modernizimi i arsimit fillor, Enti jugosllav për studimin e çështjeve shkollore dhe arsimore, Beograd, 1970, f.60;

dhënat për gjeneratat e shkëpérderdhura nga klasa I deri në përfundim të klasës VIII, në të gjitha komunat ku jeton kombësia shqiptare (shih shtojcën nr.6). Me Rezolutën e zhvillimit të edukimit dhe arsimimit mbi baza vetëqeverisëse (1970) dhe me përmirësimin e punësimit, shkapérderdhja e nxënësve te kjo kombësi u zvogëlua për tri herë, madje edhe te fëmijët femra shënojmë sukses, ngase tani nxënëset pas përfundimit të arsimit tetëvjeçar regjistrohen në degë zanatesh dhe jepin provime private për rrobaqepëse, floktare, thurëse etj.

Ky problem mbetet edhe më tutje një nga problemet aktuale rreth të cilët duhet të angazhohen të gjitha forcat subjektive, në mënyrë që të tejkalohej dhe që arsimimi tetëvjeçar te kjo kombësi të realizohet 100%. Prej vitit 1970-75, problemi i shkapérderdhjes së nxënësve nuk paraqet faktor objektiv por subjektiv, ashtu siç ka qenë edhe në tri etapat e para të zhvillimit të shkollës filllore shqipe.

Sipas të dhënave statistikore shihet qartë se nuk janë përfshirë të gjitha gjeneratat. Shkapérderdhja është më e vogël në klasat e para, kurse më e madhe në klasën V, VI dhe VII. Kjo paraqitet gjatë vitit shkollor edhe me ndërprerje. Si shembull përmendim se numri i nxënësve të regjistruar në klasën I në vitin shkollor 1971/72 ka qenë 39.301, kurse në klasën II ky numër (automatikisht) bie në 37.135 nxënës (duke ia shtuar këtij numri edhe përsëritësit), në të tretën në 36.351 nxënës (po ashtu përsëritësit janë të shumtë) kurse në klasën VIII regjistrohen vetëm 30.130 nxënës<sup>1</sup>.

Nëse e krahasojmë vitin shkollor 1965/66, shohim se shkapérderdhja ka qenë 30,46, në vitin shkollor 1871/72 kjo shënon rënie në 28,37%. Rreth 7.000 nxënës shkapérderdhen çdo vit shkollor. Në viset kodrinore-malore shkapérderdhja në përqindje është 30-40%.

<sup>1</sup> Enti republikan për përparimin e shkollimit në RSM, Shkup me informata plotësuese, Feim Isai, Përfshirja dhe shkapérderdhja e nxënësve;



### III

---

## 1. PROCESI I HAPJES DHE I PLANIFIKIMIT TË SHKOLLËS FILLORE SHQIPE

Para luftës shqiptarët në R. Maqedonisë janë edukuar dhe arsimuar në 105 shkolla fillore serbe dhe në 219 shkolla fetare. Lufta nëpër vendin tonë kaloi si një shtrëngatë e tmerrshme, duke lënë pas gërmadha dhe shkretërim. Pas çlirimit, parashtronhet si imperativ që të gjithë së bashku të bëjmë përpjekje të mëdha që të kompensohet ose përtëritet ajo që ishte shkatërruar gjatë luftës.

Gjendja numerike e shkollave për tërë territorin e Maqedonisë ka qenë si vijon:<sup>1</sup>

Të dëmtuara	Pjesë. të dëm.	Jo të dëmtuara	Gjithsej
191	373	272	836

Tabela nr.10 - Pasqyra e gjendjes numerike në shkollat fillore të RPM në fillim të vitit 1945

Pas çlirimit, fillimi i punës së shkollave paraqiste një nga problemet më serioze. Pushteti arsimor, menjëherë pas çlirimit, kujdes të veçantë i kushton arsimimit dhe kulturës në përgjithësi. Në vitin shkollor 1944/45 punojnë vetëm 50 shkolla fillore në gjuhën shqipe, edhe atë në ato vende ku shkolla kishte ekzistuar edhe më herët dhe nuk ishte dëmtuar. Në vitin e ardhshëm, pushteti popullor me angazhimin e plotë të këshillave popullore në të gjitha komunat, iu qas aftësimit ose adaptimit edhe të disa objekteve shkollore. Në vitin e njëjtë, pra 1946, Ministria e Arsimit e Maqedonisë formoi komision të

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Pasqyra statistikore për shkollimin gjatë Luftës së Dytë Botërore, dok.nr.7865, kut.119;

veçantë për të bërë shikimin e objekteve shkollore. Komisioni vlerësoi se 80% të shkollave që kishin filluar të punojnë nuk i plotësonin as kushtet minimale për punë<sup>1</sup>.

Popullata shqiptare në R. e Maqedonisë jeton nëpër fshatra dhe nuk ka pasur mundësi që në të gjitha fshatrat të ndërtohen ose adaptohen objekte shkollore. Në fshatrat në të cilat ekzistonte shkolla fillore ka qenë kryesisht larg, ndaj kështu fëmijët doemos duhej të udhëtonin edhe nga 10 kilometra. Atëherë, Ministria lejoi që të themelohen shkolla në këto fshatra ku kishte më shumë nxënës, kurse si shkolla të përdoren mektebet e xhamive, e atje ku nuk kishte mektebe u lejua që mësimi të zhvillohet në shtëpitë private<sup>2</sup>.

Hapja e shkollave në objektet shtetërore dhe mektebet e xhamive ose nëpër shtëpitë private, ndihmoi mjaft që shkolla fillore shqipe të ecë para.




Foto 1. - Medreseja si shkollë në fshatin Paniçar të Shkupit

Pas vendimit të përkohshëm, Ministria e Arsimit e RPM-së, varësisht nga mundësitetë financiare i qaset ndërtimit të objekteve të reja shkollore. Shkolla ndërtohen vetëm në vendet ku fare nuk kishin ekzistuar. Në periudhën 1946-1949 për kombësinë shqiptare u ndër-

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Raport vjetor i KKP dhe MPP për punën e shkollave fillore, 1945, 1946, 1947, 1948, kut.124;

<sup>2</sup> Në shtëpitë private vetëm në vitin shkollor 1946/47 mësimi është zhvilluar në 269 vende. AM-Shkup, FD, kut.2;

tuan 49 shkolla të reja dhe 24 për kombësinë turke<sup>1</sup>. Me këtë procesi i hapjes së shkollave po zhvillohet, ndërsa më tutje planifikohet edhe hapja e shkollave të reja. Me planin pesëvjeçar (1947-1951) ishte paraparë që të ndërtohen edhe 663 shkolla fillore dhe progjimnaze për territorin e Maqedonisë<sup>2</sup>, ndërsa nga shkollat e ndërtuara 20% janë destinuar për kombësinë shqiptare.

Në vitet e para, hapja dhe planifikimi i shkollave të reja zhvillohej posaçërisht për çdo nacionalitet dhe kishin drejtori të veçanta. Por, për shkak të vështirësive materiale erdhën në përfundim që në vendet me popullatë të përzier të ndërtohen shkolla të përziera, kështu që prej vitit 1946-1949 janë ndërtuar 35 shkolla të përziera<sup>3</sup>. Me planin pesëvjeçar ishte paraparë që shkolla të këtilla të ndërtohen dhe hapen në vendet e banuara me popullatë të përzier. Prej vitit 1945-1950, kryesisht të gjitha komunat kanë mundësi për t'i përfshirë të gjithë nxënësit e paraparë në shkollat fillore katërvjeçare. Problemi paraqitet te shtatëvjeçaret. Ishte planifikuar të hapen shtatëvjeçare vetëm në ato vende ku ka kuadër arsimor dhe ku ekzistonin objekte përkatëse shkolllore. Që në vitin 1947/48, në fshatin Serbicë të Kërçovës lind shtatëvjeçarja e parë në Maqedoni, në të cilën mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, e cila është edhe e para që u shndërrua në shkollë tetëvjeçare. Nëpër komuna ka pasur vetëm nga një shtatëvjeçare, e kur u paraqit nevoja që të hapen sa më shumë shkolla tetëvjeçare, zhvillohej një politikë që ato të planifikoheshin dhe të ndërtoheshin në ato vende në të cilat do të gravitonin nxënës nga fshatrat fqinje pas përfundimit të shkollimit katërvjeçar.

Çdo vjet numri i nxënësve është në rritje të përhershme, ndërkaq, edhe çdo fshat dëshironte që së paku fëmijëve të tyre t'u sigurojë arsimim katërvjeçar në vend, e nuk lihej pas edhe angazhimi i madh i vetë qytetarëve që me kontributin e tyre të ndihmojnë dhe të ndërtojnë shkolla të reja. Nëse e shfletojmë gazeten shqipe "Flaka e vëllazërimit", do të bindemi se çdo muaj publikoheshin mjaft shkrime për aksionet e grumbullimit të materialit për shkollat e reja.

Përpjekje e madhe është bërë në prag të reformës. Në këtë periudhë përgatitore të gjitha forcat ishin mobilizuar që të hapeshin numër sa më i madh i shkollave tetëvjeçare dhe të njëjtat të pajiseshin sa më

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Ndërtimi i shkollave të pakicave, kut.8;

<sup>2</sup> AM - Shkup, FD, Ligji për planin pesëvjeçar për zhvillimin e ekonomisë popullore në RPM në periudhën 1947-1951 (paragrafi III, Pjesa III);

<sup>3</sup> AM - Shkup, FD, Ndërtimi i shkollave të pakicave, Kut.8;

mirë. Ministria e Arsimit - Komisioni i Planit, planifikon që të hapen sa më shumë shkolla qendrore tetëvjeçare, e shumë të tjera edhe të meremetohen, sidomos në vendet ku nuk kishte mundësi që pranë shkollave qendrore të ndërtohen konvikte ose të sigurohen mjete transporti.

Pas reformës shkollore, shkollimi fillor në Maqedoni nuk ishte i tillë siç ishte paraparë me reformë, për arsy se numri i nxënësve shqiptarë e maqedonas rrjeti për 3-4 herë, ndaj ky lokal shkollor nuk mund t'i plotësonë të gjitha nevojat pedagogjike. Sipas regjistrimit të lokalit shkollor të vitit 1958, shkollimi fillor në RPM, përkatësisht RSM ka disponuar me 1.457 ndërtesa me sipërfaqe të përgjithshme prej  $428.810\text{ m}^2$ , ose mesatarisht  $2,02\text{ m}^2$  për një nxënës, kurse me reformë ishin paraparë për çdo nxënës nga  $4\text{ m}^2$ .

Deri në vitin 1954/55, kushtet për punë normale nuk ekzistojnë në shumë komuna. Në komunën e Resnjës, në fshatin Kranj, vetëm në një ndërtesë, përveç vendasve, vinin edhe nxënës nga fshatrat fqinje - Nakoleci, Sopotska. Në komunën e Tetovës mësimi zhvillohej në 53 paralele në 134 ndërtesa shkollore, edhe atë në 109 shtetërore me  $5.405\text{ m}^2$ . Nga këto objekte shkollore,  $1.882\text{ m}^2$  nuk u përgjigjeshin kushteve, kurse në tri fshatra mësimi zhvillohej në shtëpi private. Gjendja më kritike ka qenë në komunën e Kumanovës ku mësimi në 20 shkolla zhvillohej në shtëpi private, kurse situatë e ngjashme ka qenë edhe në Titov Veles, Krushevë dhe Kërçovë<sup>1</sup>.

Këto vështirësi, te shumë punëtorë pedagogjikë lindën dyshimin se zbatimi i reformës mund të realizohet plotësisht, ndaj në raportet e tyre vjetore, si problem numër një theksonin lokalet shkollore.

Në planin perspektiv për vitin 1957-1961, parashihej që për shkollimin fillor të ndërtohet hapësirë e re shkollore prej  $138,270\text{ m}^2$  me investime prej afro  $3.457.000.000$  dinarë. Por, gjatë kësaj periudhe të paraparë u ndërtuan vetëm 79 ndërtesa shkollore me gjithsej  $91,379\text{ m}^2$ , që do të thotë se ajo që ishte planifikuar u realizua vetëm për  $66,08\%$ <sup>2</sup>.

Në vitin 1961, shkollimi fillor në RS të Maqedonisë dispononte me  $466.296\text{ m}^2$  të lokalit shkollor, gjë që në krahasim me vitin 1958

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Raport për revizionin në shkollat fillore (I-VIII) nga ana e inspektorëve të Ministrisë së Arsimit, kut.50;

<sup>2</sup> Sekretariati Republikan i Shkencës dhe Arsimit në RSM, Shkup, Zhvillimi i deritashëm i arsimimit të obliguar tetëvjeçar, Shkup, 1963, f.30;

do të thotë zgjerim prej 428.810 m<sup>2</sup>, kurse sipërfaqja mesatare për një nxënës është zvogëluar dhe ka qenë 1,85 m<sup>2</sup><sup>1</sup>. Ekspansioni i nxënësve në shkollën filllore ka qenë i madh. Edhe përkundër mjeteve të investuara për ndërtimin e shkollave të reja, hapësira mesatare për një nxënës është zvogëluar për 0,02 m<sup>2</sup><sup>2</sup>.

Fondi republikan për shkollim, në periudhën 1961-1963 më shumë angazhohej për atë që të ndërtohen shkolla qendrore tetëvjeçare, sidomos në ato vende ku si shkolla ende shfrytëzoheshin shtëpitë private ose medresetë e xhamive. Tërmeti katastrofal i Shkupit (1963) dhe i Dibrës (1967) e penguan planifikimin e ndërtimit të shkollave, ngase të gjitha mjetet iu dërguan Shkupit dhe Dibrës për ndërtimin dhe adaptimin e shkollave të rrënuara. Në disa komuna nga vetëkontributi i qytetarëve ndërtohen shkolla të reja.



Foto 2 - Shkolla moderne

Kur Fondi republikan i mjeteve kaloi në kompetencë të komunave, në komunat e pazhvilluara ndërtimi i shkollave të reja bëhej shumë ngadalë. Shembull për këtë është fshati Greshnicë i Kërçovës, ku që në vitin 1968 është kërkuar të ndërtohet shkolla tetëvjeçare dhe kjo çështje nuk është zgjidhur as sot e kësaj dite. Kështu nxënësit që i vijojnë klasat e larta të shkollës filllore udhëtojnë më se 7 kilometra, e të mos flasim për fshatrat tjera siç janë Leshnica, Reçani, Dllapindolli,

<sup>1</sup> Ibid.f.30;

<sup>2</sup> Ibid.f.31;

Kollari dhe fshatra të tjera, ku shkolla fillore qendrore është larg nga fshatrat e përmendura më se 10-15 kilometra.

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 1971, në 375 vendbanime nuk kanë ekzistuar as shkollat fillore katërvjeçare, kurse numri i banorëve sillej prej 300-2.500. Në mesin e vendbanimeve shqiptare në të cilat nuk kishte shkolla, numërohen: Arangeli me 500 banorë, Jagolli - 336 - komuna e Kërçovës; Vaksinca - 1950 banorë, Opaja - 1.086, Orizari - 1.283, komuna e Kumanovës; Reçica e Vogël - 1.996, Preshovca - 1.642, Sllatina - 2.710, Xhepçishti - 2.540 - komuna e Tetovës. Edhe pse këto vendbanime nuk janë shumë larg nga vendet që kishin shkolla dhe kjo largësi nuk i kalon normativat pedagogjike, në disa prej tyre me numër aq të madh të popullatës, prej vitit 1971 është planifikuar themelimi i shkollave të reja, në mënyrë që të shkarkohej shkolla qendrore tetëvjeçare.

Bashkësia jonë vazhdimisht mban llogari për hapjen e klasave të reja në ato vende ku ka nevojë. Sipas informatës së punëtorëve arsimorë, në të gjitha komunat është zhvilluar betejë për hapjen e klasave të reja. Në komunën e Tetovës, në Shkollën fillore "Vëllazërim-Bashkim" në një të ardhme të afërt parashihet hapja edhe e dy klasave në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në fshatin Trebosh në Shkollën fillore "Liria" do të duhej hapur edhe klasë speciale, në fshatin Dobrosh 2-3 klasa, në fshatin Nerasht - klasa I<sup>1</sup>.

Në komunën e Shkupit, në disa fshatra më të vogla, për shkak të numrit të vogël të nxënësve dhe largësisë së madhe nga shkollat qendrore, deri në vitin 1974/75 ishte hapur mundësia që të vazhdohet shkollimi fillor prej kl.V-VIII në këto fshatra: Alldincë, Vértekicë, Cërvena Vodë, Paligrad, Ramni Gaber, Cërni Vërth, Jabollcë, Mallçishtë dhe Patishka Rekë<sup>2</sup>. Për shkak të migracionit fshat-qytet, në vitet e fundit vihet deri te ajo që në shkollat fillore të qytetit të themelohen klasa në gjuhën shqipe, e po ashtu edhe në shkollat fillore maqedonase janë hapur klasa të tilla, për shembull në shkollat fillore në rajonin e Shkupit: "Rajko Zhinzifov", "Tefejuz", "Jane Sandanski", "Cvetan Dimov", "Vasill Gllavinov", "Petar Zdravkovski-Penko", "Zhivko Brajkovski", "26 Juli", "Dositej Obradoviq". Në qytetin e Gostivarit: "Bratstvo-Edinstvo", "Çedo Filipovski", "Goce Dellçev",

<sup>1</sup> Bashkësia komunale e arsimit në Tetovë, Numri i paraleleve në vitin shkollor 1973/74, 1974/75, i përcjellë me efektet financiare, Tetovë, 1976, f.2-3;

<sup>2</sup> Enti ndërkomunal për përparimin e arsimimit dhe edukimit parashkollor dhe fillor të qytetit të Shkupit, pozita e arsimit fillor në rajonin e Shkupit, Shkup, 1975, f.6;

“Marshall Tito” etj. Në qytetin e Kërçovës: “Sande Shterjoski”, situata është e ngjashme edhe në komuna të tjera. Për shkak të numrit të madh të nxënësve shqiptarë, edhe në shkollat qendrore dhe të plota tetëvjeçare, një e treta e shkollave punojnë në dy ose tre ndërrime.

Enti i shkollimit në RS të Maqedonisë, sistematikisht bën kontrollimin e të gjitha shkollave të ngarkuara, në mënyrë që të përmirësohen kushtet, hapen klasa në ato shkolla që nuk janë shumë të ngarkuara, ose parashihet që të rriten investimet materiale.

## *1.2. REFORMAT SHKOLLORE DHE SHKOLLA FILLORE SHQIPE GJATË TYRE*

Gjatë Luftës së Dytë Botërore shkollimi gjendej në kushte jashtëzakonisht të vështira, kurse pas çlirimit, pushteti popullor sipas mundësive dhe rrethanave filloi t'i zgjidhë disa çështje lidhur me shkollën e re. Për këtë kujdej sektori i Këshillit Ekzekutiv të AVNOJ-it<sup>1</sup>.

Pas çlirimit, autoritetet arsimore bënë një hap revolucionar, duke tentuar ta ndërrojnë fizionominë e sistemit “të vjetër” të arsimimit dhe edukimit. Që në vitin 1945, u miratua Ligji i parë për shkollimin e obliguar pa pagesë për të gjithë fëmijët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë<sup>2</sup>.

Ky është vit vendimtar, ngase autoritetet arsimore me këshillat popullore u angazhuan që sa më urgjentisht të krijojnë bazë për demokratizimin e sistemit shkollor, pra çdo qytetar i bashkësisë sonë pa marrë parasysh nacionalitetin, përkatësinë fetare dhe gjininë, të përfshihet në shkollën fillore. Kështu, me mobilizimin e forcave, që në vitin 1944/45 iu qasën sigurimit të mjeteve më të domosdoshme për hapjen e shkollave të reja në gjuhën shqipe, madje edhe në vendet më të largëta.

Nga viti në vit, në të gjitha sferat e jetës vëreheshin ndryshime të mëdha. Zhvillimi i shpejtë ekonomik, shoqëror, politik dhe kulturor, kërkon që të precizohet dhe të përcaktohet së afërmë puna e shkollave tashmë të hapura, kështu që ato të përfshijnë jo vetëm një pjesë të punës shkollore, por edhe të përmirësohet edhe organizimi i tyre i

<sup>1</sup> Shih gjërisht dr.M.Ogrizoviq, Op.cit.;

<sup>2</sup> Kushtetuta e JFD, 1945;

jashtëm dhe i brendshëm. Nëse e përcjellim sipas viteve zhvillimin e shkollës sonë, pothuaj nuk është e mundur të vërehen të gjitha ndryshimet që janë bërë.

Me miratimin e arsimimit shtatëvjeçar të fëmijëve të moshës 7-14 vjeç, në vitet e para të vendit tonë u tejkalua edhe sistemi i vjetër shkollor, i cili kishte mbetur pas zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të Jugosllavisë, dhe i cili ishte bërë pengesë për zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe shoqëror<sup>1</sup>.

Edhe përkundër sukseseve relative në arsimim dhe shkollim, nga njëra anë, kishte përherë pengesa që e frenonin shkollimin dhe këto probleme u shqyrtuan në Plenumin III të KQ të LKJ-së, në dhjetor të vitit 1949, kur edhe u bënë ndryshime në planprogramet mësimore, me të cilat insistohet që të evitohej mësimi tradicional dhe insistohet në përhapjen dhe ngritjen e arsimimit të obliguar dhe orientimit ideologjik.

Në vitin 1950 te ne u aplikua vetëqeverisja punëtore, e cila ndër të tjera ka qenë edhe faktor i rëndësishëm për transformimin e sistemit edukues-arsimor. Vetëqeverisja punëtore nxiti edhe demokratizimin e shkollës, në mënyrë që me shkollën duhet të udhëheqë Këshilli për arsim, në vend të Ministrisë së atëhershme. Kompetencat e ministrisë kalojnë në këshillat popullore, formohen shumë këshilla shkollore, si organe administrative, në punën e të cilëve marrin pjesë arsimtarë, drejtorë, përfaqësues të bashkësive lokale, prindër, nxënës etj. Me vetëqeverisjen e shkollës hyhet në një etapë të re - nga ato shtetërore, ato bëhen organizata vetëqeverisëse. Vitet 1951, 1952, 1953 janë të rëndësishme ngase bëhen disa ndryshime të vogla në planin arsimor, por akoma theksohet ajo se shkolla është e ndarë nga jeta shoqërore. Të gjitha kritikat dhe vërejtjet drejtuar shkollës sonë, ishin të njoitura edhe për opinionin.

Në vitin 1954, në mënyrë vendimtare bëhen përgatitje në mënyrë që rrënjosht të ndryshojë sistemi shkollor ekzistues. Formohen trupa përkatës për reformën e shkollës. U formua Komisioni federal pranë Kuvendit Popullor (1955-56), UNESCO-ja dërgon ekspertë në Jugosllavi, ekspertët tanë i vizitojnë shtetet e jashtme për të këmbyer përvoja.

Komisioni për reformë i paraqiti edhe qëndrimet e tij në këto dokumente: "Problemet e reformës shkollore, Pjesa I", "Organizimi i

<sup>1</sup> Dr. P. Shimlesha, Në rrugën deri te shkolla e reformuar, Zagreb, 1957, f.5;

shkollës tetëvjeçare”, “Përgatitja e arsimtarëve të shkollës tetëvjeçare, Pjesa II”, Beograd 1956.

Në këtë periudhë u publikuan edhe një numër i madh shkrimesh dhe artikujsh në revistat dhe gazetat tona pedagogjike, në të cilat diskutohet përmundësitë e mëtejme të zhvillimit dhe perspektivës së sistemit shkollor. Intervistohen punëtorë arsimorë pedagogjikë.

Këshilli për arsim, shkencë dhe kulturë i Qeverisë së RPM-së - Shkup, të gjitha shkollave u dërgoi elaboratin për diskutim, në të cilin përveç arsimtarëve do të marrin pjesë edhe prindërit dhe vetë nxënësit.

Reforma e shkollimit te kombësia shqiptare përfshinte katër klasat e para<sup>1</sup>. Nga raportet mund të nxjerrim disa konkluza dhe propozime. Ka pasur mendime që shkollat e fshatit të mbeten edhe më tutje katërvjeçare, kurse të qytetit të kalojnë në tetëvjeçare (gjimnaze jo të plota dhe gjimnaze me klasa të larta prej klasës V-VIII). Disa prindëri pranuan këto propozime për arsyen se shkollimi më i gjatë i fëmijëve, ndër të tjera u sillte edhe numër të madh të triskave për ushqim<sup>2</sup>. Këshilli për shkolla i RPM-së, Këshilli i Entit për përparimin dhe studimin e shkollimit në RPM dhe përfaqësuesit e organizatave të ndryshme punuese dhe politike, prej 25 tetor 1957 zhvilluan diskutimet përfundimtare për reformën e shkollës sipas Propozimit të sistemit të edukimit dhe arsimimit, të cilin e batoi Komisioni për reformën e shkollimit (1957). Në këtë konferencë, diskutuesit nuk dhanë ndonjë alternativë, por përkrahën koncepcionet e përcaktuara qartë të Propozimit, të cilat plotësisht u përgjigjen nevojave të shoqërisë sonë vetëqeverisëse socialiste dhe të cilat do të shkojnë në hap me shkencën dhe teknikën. Kuvendi Federativ Popullor, në vitin 1958 e miratoi Propozimin e sistemit të edukimit dhe arsimimit në RFPJ dhe Ligjin e përgjithshëm për shkollimin, me të cilat u përcaktuan qëllimet, karakteri dhe organizimi i arsimit. Në bazë të këtyre dokumenteve të rëndësishme u definua sistemi ynë edukues-arsimor, i cili i jepte shanse të mëdha shkollës sonë, në mënyrë që ajo ta zinte vendin e saj adekuat në shoqërinë tonë.

Vitet e reformës janë vite të hovit të shkollës shqipe në insistimet që të zgjerohet rrjeti shkollor dhe të përmirësohen kushtet për arritjen e rezultateve më të mira. Arsimimi i përgjithshëm, përkatësisht arsimimi fillor i obligueshëm për fëmijët e moshës 7-15 vjeçare, është unik dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët e të dy gjinive. Sipas karak-

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Raport i KKP per Tetovë, nr.11709, kut.53;

<sup>2</sup> Ibid.;

terit dhe funksionit, shkolla ka pasur detyrë dhe qëllim të zhvillojë personalitetin e gjithanshëm në shoqërinë socialiste.

Shkolla e obligueshme tetëveçantë për kombësinë shqiptare ka pasur rol të veçantë, sidomos për faktin se ajo si institucion shoqëror-edukues-arsimor-kulturor, ka kontribuar për eliminimin e marrëdhënive jo të shëndosha<sup>1</sup>.

Me reformën sigurohet karakteri kombëtar dhe shtetëror, u vunë bazat për një sistem të ri të arsimimit dhe edukimit, i cili u harmonizua me nevojat e bashkësisë sonë.

Me reformën e parë realizohet dhe unifikohet planprogrami mësimor. Insistohet në njojjen e thellë dhe të gjithanshme të natyrës dhe shoqërisë. Nga plani mësimor munguan disa lëndë, kurse kujdes më i madh iu kushtua gjuhës amtare shqipe, matematikës, fizikës, kimisë, BAT-it etj. Në planet mësimore më tepër erdhën në shprehje përbajtjet bashkëkohore, lidhja me jetën, format e reja të punës edukuese-arsimore, mbahej llogari për interesin e nxënësve dhe pjesëmarrjen e tyre në punën e dobishme shoqërore<sup>2</sup>. Po ashtu në programet arsimore për kombësinë shqiptare në RS të Maqedonisë përfshihet edhe mësimi nga lëmi i kulturës kombëtare shqiptare<sup>3</sup>, respektivisht, krijohet planprogrami mësimor plotësues për shkollat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare.

Enti për Përparimin e Shkollimit Fillor në RS të Maqedonisë kujdesej posaçërisht për zbatimin e qëndrimeve themelore të reformave, për strukturën organizative dhe pedagogjike të shkollës filllore. Shkolla shqipe i shprehu kërkesat shoqërore-ekonomike, siguroi kushte shumë më të mira për arsimin fillor, shqyrtoi problemet aktuale

<sup>1</sup> Propozimi i sistemit të arsimit dhe edukimit në RFPJ, Beograd, 1957, f.27;

<sup>2</sup> Dr. A. Vukasoviq, Edukimi punues dhe teknik, Zagreb, 1972, f.4;

<sup>3</sup> Në bazë të nenit 30 dhe 38 të Ligjit të përgjithshëm për shkollën “Gazeta zyrtare e RFPJ”, 28/5 u miratua dokumenti, bazat parimore të planprogrameve mësimore plotësuese për shkollat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare - Prosvetni savet, Beograd, prill 1961, “Gazeta zyrtare” e RPM, 24/61;

në zbatimin e reformave dhe i vërente dobësitë dhe vështirësitë që e pengonin realizimin e saj të mëtejshëm dhe të plotë.

Rezultatet që u arritën në zhvillimin e edukimit dhe arsimimit fillor të kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë, verifikohen edhe me këto krahasime<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Te dhënat janë marrë nga Enti statistikor i RSM-së, Shkup;

viti shk.	SHQIP			MAQEDONISHT			TURQISHT			TË TJERË		
	shk.	nx.	ars.	shk.	nx.	ars.	shk.	nx.	ars.	shk.	nx.	ars.
1955/56	260	23893	615	1252	138719	4088	199	11406	346	26	3033	91
1965/66	254	38735	1223	1212	207172	7484	46	5824	171	30	4945	213

Tabela nr.11 - Shkollat, nxenësit dhe arsimtaret sipas përkatesisë nationale

Nëse e marrim vitin shkollor 1945/46, indeksi 100 sipas viti të paraqitur, rezultati do të jetë si vijon:

v.sh.	SHQIP			MAQEDONISHT			TURQISHT		
	shk.	nx.	ars.	shk.	nx.	ars.	shk.	nx.	ars.
1955/56	183,10	167,5	233	150,8	161,6	267,7	216,4	170,2	276,0
1965/66	178,9	250,6	463,3	140,4	241,3	490,1	83,6	86,9	136,9

Nga tabela shihet dhe konkludohet qartë se me reformën e shkollimit janë arritur rezultate mjaft të mëdha në rritjen e numrit të nxënësve, zgjerimin e rrjetit shkollor, shtimin e kuadrit arsimor, përmirësimin e strukturës kualifikuese të arsimtarëve etj.

Prej vitit 1965 e deri në vitin 1970, në rrjetin e shkollave ekziston jnë disa variacione, kurse numri i nxënësve dhe arsimtarëve rritet edhe më tej. Gjatë viteve 1970-1974, janë bërë edhe një sërë reformash “të vogla” që kanë krijuar bazën edhe për një reformë rrënjosore e cila në RS të Maqedonisë filloi të përgatitet në vitin 1975.

## 2. ORGANIZIMI I SHKOLLËS FILLORE PËR PAKICAT

Që më 26.X.1945 u nxor ligji i parë për arsimimin e obliguar fillor shtatëvjeçar për të gjithë fëmijët e dy gjinive të moshës prej 7-13 vjeç. Më 31.I.1946 u miratua Kushtetuta e RFPJ-së, në të cilën ndër të tjera, thuhet: “Me qëllim të ngritisjes së kulturës së përgjithshme të popullit, shteti siguron që shkollat dhe entet tjera arsimore-kulturore të jenë të kapshme për të gjitha shtresat e popullit. Shteti, kujdes të veçantë i kushton rinisë dhe e mbron edukimin e saj. Shkollat janë shtetërore, vetëm me ligj mund të lejohet themelimi i shkollave private, kurse puna e tyre është nën kontrollin e shtetit. Mësimi fillor është i obligueshëm dhe pa pagesë”<sup>1</sup>.

Për punën dhe organizimin e shkollës për pakicat kombëtare, më 10.VIII.1945 u miratuan orientimet nga ana e Këshillit të përkohshëm arsimor të Ministrisë së Arsimit. Teksti i tyre është si vijon:

1. “Për të gjitha pakicat kombëtare hapen shkolla të pakicave, nëse së paku ka 20 nxënës, e nëse nuk ka shkolla të tjera në vend. Nëse në vend ekziston shkolla fillore, pranë kësaj hapet paralelja për pakica nëse ka 30 nxënës. Fëmijët, prindërit e të cilëve janë shtetas të huaj, nuk hyjnë në këtë numër. Sipas këtyre normave hapen edhe paralele për fëmijët e popujve tanë në vendet ku pakicat popullore janë me shumicë. Regjistrimi në shkollat e pakicave bëhet sipas dëshirës së prindërvve”.

<sup>1</sup> Kushtetuta e FDJ, Beograd, 1945;

2. Parimisht, fëmijët e pakicave kombëtare shkojnë në shkollat e pakicës përkatëse. Shmangien nga këto parime e lejojnë autoritetet arsimore të republikave popullore.

3. Çdo republikë popullore kujdeset për hapjen e shkollave të pakicave, të shkollave të mesme e të tjera për pakicat në territorin e saj. Kujdesi për shkollat e pakicave bie në barrë të çdo republike popullore, e cila gjithashtu i paguan edhe arsimtarët.

4. Mësimi në shkollat e pakicave dhe në paralelet përkatëse zhvillohet në gjuhën amtare të pakicës amë. Prej klasës III të shkollës filllore e më tutje mësohet nga 3 orë në javë gjuha e njësisë federale amë. Në programin për shkollat e pakicave shtohet gjuha amtare, historia dhe gjeografia e popullit tonë.

5. Arsimtarët në shkollat e pakicave janë shtetas të Jugosllavisë Federative Demokratike dhe pjesëtarë të pakicës përkatëse. Sipas kualifikimit nuk mund të jenë më të ulët se sa është përcaktuar kjo për shkollat përkatëse në shtetin tonë. Duke marrë parasysh faktin se akoma nuk ka numër të mjaftueshëm të kuadrit të arsimtarëve për disa pakica, deri në vitin 1951 mund të pranohen edhe arsimtarë - shtetas të huaj, që kanë kualifikime të nevojshme, kurse përcaktimi i tyre politik është në pajtim me parimet demokratike të vendit tonë.

6. Mbikëqyrjen mbi shkollat e pakicave e bën pushteti popullor sipas dispozitave të ligjit që vlejnë në territorin e disa njësive federale, kurse detyrën e arsimtarit instruktor e bëjnë instruktorët arsimtarë, pjesëtarë të pakicave përkatëse.

7. Administrata në shkollat e pakicave zhvillohet në gjuhën e pakicës përkatëse brenda vetë shkollës. Në regjistrimin zyrtar administrata zhvillohet në gjuhën zyrtare të njësisë federale, kurse të gjithë formularët dhe dokumentet zyrtare lëshohen në të dy gjuhët, pra të njësisë federale dhe të pakicës përkatëse.

8. Tekstet shkollore për këto shkolla të pakicave në radhë të parë botohen në atdheun tonë. Ato tekste që nuk mund të botohen tek ne do të importohen me leje të autoriteteve arsimore të botës së jashtme<sup>1</sup>.

Mbi këto baza të gjitha republikat hapnin shkolla për pakicat kombëtare, kështu që edhe në RP të Maqedonisë iu qasën hapjes së shkollave filllore për kombësinë shqiptare e turke.

Çështjen e shkollimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare e trajton edhe Projektligji mbi shkollimin, në pjesën e parë të "Parimeve

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Problemet e shkollës së pakicave kombëtare dhe reforma e shkollës - Novi Sad, 1957, kut.166;

themelore” në nenin 12 dhe në pjesën nën III të shkollës fillore në nenet 40, 41, 42 dhe 43, kurse të gjitha dispozitat tjera janë të përbashkëta për tërë bashkësinë tonë.

Rëndesi të posaçme ka neni 43 ku rregullohet dispozita e veçantë për pakicat kombëtare sipas republikave.

Kombësia shqiptare në RSM ka të drejtë të themelojë shkolla fillore ose paralele në gjuhën shqipe, nëse ka numrin e nevojshëm të nxënësve<sup>1</sup>.

Në ato territore ku populli maqedonas dhe kombësia shqiptare e turke jetojnë së bashku, zbatohen parimet territoriale; themelohen shkolla të përbashkëta me klasa të veçanta, në të cilat mësimi zhvillohet sipas numrit të pjesëtarëve të popujve, përkatësisht kombësive.

Në ato rajone të RP të Maqedonisë ku jetojnë më shumë pakica kombëtare dhe popullatë e popujve jugosllavë, themelohen edhe shkolla me mësim dygjuhësor<sup>2</sup>, por që për hapjen e shkollave të tillë, përkatësisht paraleleve, vendosin vetë prindërit me këshillat shkollore dhe vendimin definitiv e marrin këshillat popullore komunale.

Të gjitha shkollat fillore i themelojnë këshillat komunale me leje të veçantë të Këshillit për arsim të RSM-së. Shkolla mund të hapen nëse kanë numër të paraparë të nxënësve, kushte pedagogjike, higjienike, kadrorike, materiale dhe kushte të tjera të rregulluara me ligj për shkollën fillore.

Administrata zhvillohet në gjuhën e kombësive. Dëftesat lëshohen në gjuhën maqedone dhe shqipe.

Shkollat për kombësinë shqiptare i bartin emrat e revolucionarëve të dalluar, shkrimitarëve, si dhe emrat e përgjithshëm: “Liria”, “Dituria”, “Drita” etj. Shkollat e përziera i bartin edhe emrat e revolucionarëve dhe shkrimitarëve maqedonas dhe jugosllavë.

Shkolla mund të shuhet me propozimin e këshillit shkollor, nëse nuk i plotëson kushtet për punë dhe dispozitat tjera ligjore. Vendimin për shuarjen e shkollës e merr Këshilli Ekzekutiv Republikan i RSM-së.

Realizimi i arsimit fillor varet shumë edhe nga zhvillimi i rrjetit shkollor. Në RS të Maqedonisë, struktura e rrjetit shkollor, përkatësisht e arsimimit fillor, realizohet përmes shkollës katervjeçare,

<sup>1</sup> Nëse ka 20 nxënës mund të hapet klasa ose shkolla, kurse për pak se 20 nxënës organizohet mësimi plotësues, “Gazeta zyrtare e RFPJ” nr.24, 1961, f.380 (neni 5-6);

<sup>2</sup> Ligji i përgjithshëm mbi shkollën, “Gazeta zyrtare” e RFPJ, Beograd, 1958, f.68, nen 76; “Gazeta zyrtare” e RPM, nr.24, f.381, nen 15;

pesëvjeçare, gjashtëvjeçare, shtatëvjeçare dhe tetëvjeçare. Deri në vitin shkollor 1972/73, për tërë territorin e RS të Maqedonisë nga numri i përgjithshëm i 1.388 shkollave fillore, kemi:

- katërvjeçare.....	995
- pesëvjeçare.....	27
- gjashtëvjeçare .....	10
- tetëvjeçare	
	I-VIII...406
	<u>V-VIII.....2</u>
Gjithsej:....	1.388

*Nga këto, të pavarura dhe qendrore janë:*

- katërvjeçare.....	1
- pesëvjeçare.....	nuk ka
- gjashtëvjeçare ...	nuk ka
- tetëvjeçare	
	I-VIII...349
	<u>V-VIII.....1</u>

*Rajonale:*

- katërvjeçare.....	944
- pesëvjeçare.....	27
- gjashtëvjeçare .....	10
- tetëvjeçare	
	I-VIII....55
	<u>V-VIII.....1</u>

Gjithsej:... 1.0371

## 2.1. RRJETI I SHKOLLAVE FILLORE

Rrjeti shkollor është një nga faktorët qenësorë në zhvillimin e shkollës. Nga ky faktor dalin shumë të tjerë, si faktorët arsimorë-ekzistativë dhe organizativë, me të cilët shkolla fillore shqipe është ballafaquar vazhdimisht në periudhën pas luftës.

Para Luftës II Botërore në tërë territorin e Maqedonisë rrjeti shkollor nuk ka qenë i zhvilluar sa duhet dhe institacione tjera kultu-

<sup>1</sup> Enti republikan i statistikës për fillimin e vitit shkollor 1972/73 - Shkup, 1973;

rore ka pasur pak. Numri i shkollave fillore katërvjeçare, në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën serbokroate, për kombësinë shqiptare ka qenë 105<sup>1</sup>, kurse të dhënat për tërë Maqedoninë do t'i shohim nga tabela vijuese:

OBJEKTET	NUMRI I SHKOLLAVE	TË RRËNUARA	TË DJEGURA	PJESËR TË RRËNUARA
Objekte shkollore	836	272	191	373
Mjetë mësimore	746	213	236	297
Biblioteka	378	36	277	65
Arkiva shkollore	707	129	124	464
Gjithsej:	2869	660	878	1320

Tabela nr.12 - Gjendja numerike e shkollave dhe enteve kulturore

Sipas tabelës mund të konstatohet se regjimi jopopullor nuk mbante llogari mbi zhvillimin e arsimit dhe shkollimit në këto vise.

Gjatë luftës, një pjesë e shkollave u rrënuan, kurse një pjesë tjeter duhej adaptuar. Në RP të Maqedonisë, edhe përkundër vështirësive ekonomike, pushteti popullor organizoi fonde të posaçme pë aftësimin e atyre ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja shkolllore.

Në vitet e para pas çlirimt, aksioni i Ministrisë së Arsimit ishte orientuar në hapjen e sa më shumë shkollave fillore, shkollave katërvjeçare dhe në sigurimin e kuadrit arsimor.

Shkollat e para fillore në gjuhën mësimore shqipe u hapën në objektet ekzistuese, ku më parë organizohej mësimi në gjuhën serbokroate. Në vendbanimet e zhvilluara, përkatesisht në vendet qendrore, po ashtu u fillua me ndërtimin e shkollave të reja dhe me këtë u mundësua që në këto të gravitojnë edhe shkollat fqinje. Në vitin e ardhshëm (1945/46) rrjeti i shkollave fillore u mit për 3 herë. Tani, pothuaj të gjitha vendbanimet, me përjashtim të fshatrave kodrinore-malore, kishin shkolla, kështu që gjatë këtij viti rritja e përgjithshme e nxënësve në shkollën fillore ishte më e madhe se sa në vitet e mëparshme kur ky numër ishte 25% për një vit. Aksioni për hapjen e shkollave të reja nuk pushon, kështu që në vitin shkollor 1946/47 për kombësinë shqiptare u ndërtuan edhe 30 shkolla të reja<sup>2</sup>. Me hapjen

<sup>1</sup> Dr. Masar Kodra, Pozita ekonomike-shoqërore dhe politike e kombësisë shqiptare në Maqedoni midis dy luftërave botërore, "Jehona", nr.5, Shkup, 1973, f.95 (II);

<sup>2</sup> AM - Shkup, FD, Ndërtimi i shkollave fillore të pakicave, kut.8;

intensive të shkollave të reja, ose me sanimin e tyre në disa komuna, u zgjidh pjesërisht problemi për numrin ekzistues të nxënësve, ngase shkollave që ekzistonin u shtoheshin edhe anekse të reja (shih shtojcën nr.7).

Me planin pesëvjeçar (1947-1951), Ministria e Arsimit e RPM-së parashihet detyra themelore që duhet të realizoheshin në vitet e ardhshme. Planifikohet që të ndërtohen edhe 663 ndërtesa për shkollat filllore dhe progjimnazet me 78.800 vende nxënësish.

Me planin pesëvjeçar (1947-1951) u hapen mundësi të gjera që arsimimi në shkollimin katervjeçar të realizohet madje me 100%, kurse në shtatëvjeçaret me 30%.

Prej vitit 1948, organet arsimore dhe këshillat popullore u mobilizuan për përfshirjen e sa më shumë fëmijëve nëpër shtatëvjeçare. Në shkollat katervjeçare ku ekzistonin kushte hapeshin edhe shtatëvjeçaret. Pas katër vitesh të miratimit të planit pesëvjeçar, pra deri në vitin 1951, gjendja e shkollave katervjeçare dhe shtatëvjeçare në gjuhën shqipe dukej ashtu siç është paraqitur në tabelë:

Viti shkollor	Shkollat katervjeçare	Shkollat shtatëvjeçare	Gjithsej
1944/45	50	-	50
1945/46	136	6	142
1946/47	143	5	148
1947/48	161	5	166
1948/49	172	7	179
1949/50	198	11	209

Tabela nr.13 - Shkolla filllore të kombësisë shqiptare në Maqedoni

Në nenin 6 të pjesës së parë të planit pesëvjeçar, qëndron në mënyrë strikte “Që të çrrënjoset analfabetizmi dhe të sigurohet arsimimi i masave të gjera popullore në fshat dhe në qytet. Fëmijëve u sigurohet zhvillim i shëndoshë dhe i drejtë... Me shkollimin shtatëvjeçar deri në vitin 1951 të përfshihen 30% të obliguesve shkollorë”.

Nga tabela shihet qartë se rrjeti i shkollave katervjeçare ka pasur rritje të plotë, kurse deri në fund të vitit 1949/50 pothuaj çdo komunë ka patur shtatëvjeçare, kurse në komunat më të mëdha punonin edhe nga dy shtatëvjeçare (shih shtojcën nr.4).

Prej vitit 1950 në vendin tonë u bënë ndryshime të mëdha në sferën shoqërore-politike dhe ekonomike. Këto ndryshime kërkonin edhe njeriun e ri të arsimuar. Shkollës, si institucion edukues, arsimor dhe shoqëror i takonte detyra që të arsimojë sa më shumë të rinj, e kjo kërkonte që edhe në vendet më të largëta malore të hapeshin shkolla filllore të obligueshme tetëvjeçare.

Deri në vitin 1955/56 në RS të Maqedonisë numri i shkollave katërvjeçare arriti në 230, kurse i tetëvjeçareve në 25, ose gjithsej 255, kështu që për këta fëmijë arsimimi ishte sigruar në shkollat filllore katërvjeçare.

Në vitet e ardhshme në shkollat filllore katërvjeçare bëhen disa ndryshime dhe laramani:

Viti shkollor	Shkolla katërvjeçare	Shkolla shtatë dhe tetëvjeçare	Gjithsej
1950/51	202	12	214
1951/52	238	17	255
1952/53	172	24	196
1953/54	200	24	224
1954/55	228	24	252
1955/56	230	22	252
1956/57	176	25	201
1957/58	172	23	195
1958/59	170	19	189
1959/60	168	15	183

Tabela nr.14 - Dinamika e rritjes dhe e ngritjes së shkollave filllore

Këto laramani krijohen ngase vihet deri te puna e kohëpaskohshme e disa shkollave për shkak të mungesës së kuadrit arsimor dhe për arsyen se në vitin shkollor 1957/58 filloi riorganizimi i rrjetit shkollor në vendbanimet e përziera nationale dhe formimi i shkollave filllore mbi parimin territorial<sup>1</sup>.

Deri në vitin 1959/60 të gjithë fëmijët e kombësisë shqiptare janë të përfshirë në arsimimin katërvjeçar. Nga ky vit, ose thënë më saktë pas reformës dhe miratimit të Ligjit të përgjithshëm për shkollimin, sipas të cilët fëmijët prej moshës 7-15 vjeçare janë të obliguar ta kryejnë shkollën tetëvjeçare, erdhi deri te ajo që në disa vendbanime

<sup>1</sup> RS për ONK, Realizimi i barazisë së kombësive përmes rrjetit të institacioneve arsimore, Shkup, 1969, f.3;

dhe në ato shkolla ku ekzistonin kushte filluan të themelohen edhe klasa të larta të shkollës filllore. Tani edhe shkollat tetëvjeçare filluan të rriten me dinamikë përkatëse. Kjo rritje është paraqitur në tabelën në shtojcën nr.8. Në vitin shkollor 1960/61 shkollat tetëvjeçare në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, kanë qenë 23, kurse deri në vitin 1969/70 numri i shkollave të tilla u rrit në 110, që do të thotë u shtuan për pesë herë.

Siqë është e njojur, nataliteti te kombësia shqiptare në Jugosllavi është në rritje të përhershme, gjë që shpie në numër të madh fëmijësh - të moshuar për regjistrim në shkollë filllore, kurse nga ana tjetër, politika e bashkësisë socialiste që askush të mos mbetet jashtë shkollës, imponoi një problem serioz - që të zgjerohet struktura e rrjetit shkollor dhe kështu të kënaqen nevojat edhe të nxënësve të arrirë për shkolimin e obligueshëm tetëvjeçar.

Arsimimi fillor në radhë të parë realizohej në shkollat filllore katërvjeçare, që janë të shumta, kurse më tej vazhdohej në shkollat qendrore tetëvjeçare. Shkolla katërvjeçare në gjuhën e kombësive në RS të Maqedonisë ka në të gjitha fshatrat dhe qytetet e banuara me këtë kombësi. Nxënësit të cilët nuk kryejnë shkollën e plotë filllore, janë të obligueshëm ta vazhdojnë arsimimin në ato shkolla që janë të plota, pra në shkollat qendrore tetëvjeçare.

Në RS të Maqedonisë ekzistojnë 60 vendbanime në të cilat nuk ka mundësi për kryerjen e arsimimit tetëvjeçar. Edhe përkundër asaj se me Ligjin për shkollat janë rregulluar kushtet që sigurojnë të drejtën e vendosjes në konvikte, ka edhe shkolla të atilla qendrore ku konfiguracioni i tokës nuk lejon përdorimin e ndonjë mjeti transportues. Viteve të fundit, pra në vitin 1970, u krijuan kushtet që shumë shkolla katërvjeçare, në mënyrë suksesive të shndërrohen në pesëvjeçare, përkatësisht gjashtëvjeçare ose të shndërrohen në shkolla të plota tetëvjeçare. Shkollat e këtilla shndërrohen prej vitit 1964 e deri në vitin 1975, të njëjtat u shndërruan në të gjitha komunat (shih shtojcën nr.9) dhe me këtë u mundësua përfshirja e një numri më të madh të nxënësve të obliguar me shkollimin tetëvjeçar.

Shkollat qendrore më shumë koncentroheshin nëpër fshatra, kështu që disa fshatra të afërtë gravitonin në këto shkolla. Në disa mjjedise, si për shembull në Kërçovë, Dibër, Titov Veles, nxënësit udhëtojnë nga 5-7 kilometra në një drejtim. Kushte të mira shkollat qendrore sigruan në komunën e Tetovës (transportin), të Gostivarit (konviktin), të Kumanovës dhe Strugës (transportin).

Sekretariati Republikan i Shkencës dhe Arsimit në RS të Maqedonisë, për realizimin e arsimimit të obligueshëm tetëvjeçar, duke shqyrtuar këtë problem akut, me Ligjin e vitit 1965, të formuluar definitivisht në vitin 1968, lejoi që shumë shkolla rajonale katervjeçare të shndërrohen në shkolla të plota tetëvjeçare<sup>1</sup>, rëndom në vendbanimet kodrinore-malore. Kështu, prej vitit 1960-1970 shkaktohet zvogëlimi i shkollave katervjeçare, ngase në këtë periudhë te kombësia shqiptare migrimi fshat-qytet kishte marrë hov të plotë. Vendosit që mbeteshin në fshat gjendeshin në rrëthana të vështira, ngase sipas ligjit duhej mbyllur disa shkolla në fshatra. Në vitin 1970, Sekretariati i Arsimit, me propozimin e kuvendeve komunale, me gjithatë, nuk lejoi që këto shkolla të mbyllen dhe mundësoi që të punohet edhe me më pak se 10 nxënës.

Me Rezolutën për zhvillimin e arsimit dhe edukimit mbi baza vetëqeverisëse, shkollat katervjeçare filluan të shndërrohen në shkolla të plota fillore, kështu që nëpër qytete ka më shumë shkolla tetëvjeçare, që do të thotë se shkollat tetëvjeçare janë në rritje e sipër, ashtu siç është paraqitur në tabelën që vijon:<sup>2</sup>

Viti shkollor	I-IV katervjeçare	V-VIII tetëvjeçare	Gjithsej
1970/71	156	110	266
1971/72	154	113	267
1972/73	171	107	278
1973/74	170	123	293
1974/75	172	107	279

Tabela nr.15 - Zhvillimi i shkollave tetëvjeçare

Zgjerimi i rrjetit shkollor, përkatesisht shndërrimi i shkollave katervjeçare në shkolla tetëvjeçare, u arrit edhe në shkollat e përziera. Prej vitit 1958/59 filluan të themelohen shkollat e përbashkëta fillore mbi parimin territorial.

Në rajonet me popullsi të përzier ku me shekuj populli maqedonas, kombësia shqiptare dhe turke jetojnë së bashku, qëndrimi

<sup>1</sup> "Gazeta zyrtare" e RPM, nr.14, Shkup, 1964, f.248, nen 92;

<sup>2</sup> Buletini statistikor i RSM-së, Shkup, 1979, f.253;

tjetërfare do të ishte në kundërshtim me politikën e LKJ-së, e cila angazhohej ta zhvillojë vëllazërim-bashkimin, si një nga parimet themelore revolucionare.

Zbatimi i parimit territorial dhe krijimi i shkollave të përziera ka disa veçori, siç janë funksionaliteti i gjuhës së Republikës, përfshirja e sa më shumë nxënësve, racionalizimi dhe ekonomizimi me mjetet mësimore, shfrytëzimi i përbashkët i kabinetave të pajisura, ndihma reciproke e arsimtarëve etj.

Procesi i integrimit të shkollave fillore në rajonet me popullsi të përzier është shprehur si strukturë e organizatave të zhvilluara shkollore, pra si formë demokratike e shkollimit. Ky proces në RS të Maqedonisë u bë në vitin shkollor 1955/56 dhe zhvillohej më tej<sup>1</sup>.

Që të shihet numri i shkollave territoriale dhe struktura e tyre, sipas numrit të nxënësve sipas kombësive, mund të na shërbejë kjo tabelë<sup>2</sup>

Viti shkoll.	Shkollat			Nxënësit				
	I-IV	V-VIII	Gjith.	Maqed.	Shqip.	Turq.	Tjerë	Gjith.
1958/59	70	52	122	31457	9777	4826	2758	48820
1959/60	67	49	116	16854	10773	4534	1115	33276
1960/61	55	53	108	28480	11746	3922	3979	48127
1961/62	39	64	103	14396	15999	5780	-	36145
1962/63	20	64	84	23796	17112	5505	1135	47548

Tabela nr.16 - Shkollat territoriale në RS të Maqedonisë

Siç shihet nga tabela e mësipërmë, lloji i këtillë i shkollave në RS të Maqedonisë është mjaft i madh, sidomos i tetëvjeçareve, ndërsa numri i shkollave katërvjeçare, për shkak të migrimit shënon rënien.

Deri në vitin 1967/68 e më tej rritet numri i shkollave, pa marrë parasysh se ato në fshatra shuhën, kurse nëpër qytete formohen. Pas këtij viti, numri i shkollave të këtilla shënon rritje drastike. Shumë shkolla kombëtare ndahen si të veçanta, për arsyen se shkollat e këtilla punojnë në tri ndërrime, por edhe për atë se disa prindër i marrin

<sup>1</sup> RS për ONK, Barazia...op.cit.f.8;

<sup>2</sup> Buletini statistikor i RSM-së, Shkup, 1979, f.253;

fëmijët nga shkollat e përziera dhe i dërgojnë në shkolla të pastra kombëtare.

Pas rezolutës, kemi rritje të re të shkollave të përziera, që illostrohet në tabelën vijuese<sup>1</sup>.

Viti shkollor	Katervjeçare	Tetëvjeçare	Gjithsej
1964/65	75	72	147
1966/67	58	79	137
1970/71	39	69	108
1971/72	40	67	107
1972/73	42	77	119
1973/74	43	79	132
1974/75	44	81	125

Tabela nr.17 - (Shkollat territoriale) të përziera

Deri në vitin 1974/75 në RS të Maqedonisë rrjeti shkollor ka qenë mjaft i përhapur dhe i degëzuar, kështu që kombësisë shqiptare i është mundësuar që shkollimin e obligueshëm tetëvjeçar ta realizojë 80-100%

Me rezultatet e arritura në zhvillimin e rrjetit shkollor në gjuhën shqipe nuk verifikohet barazia në realizimin e arsimimit, siç thuhet në shumë dokumente. Rrjeti i shkollave fillore në gjuhën shqipe në periudhën 1945-1975, zgjerohet nga 142 shkolla fillore në 479 shkolla (indeksi 196,5) dhe me këtë realizohet arsimimi fillor.

### 3. PLANPROGRAMET MËSIMORE

Përbajtjet edukative dhe arsimore janë përcaktuar me planprogramet mësimore, që janë bazë e procesit mësimor.

Gjatë kohës së zhvillimit të shkollimit dhe arsimimit për kombësinë shqiptare në RS të Maqedonisë, paralelisht me zhvillimin e shkollimit dhe arsimimit maqedonas, planprogramet mësimore në këtë

<sup>1</sup> Regjistrimi i nxënësve për vitin përkatës shkollor, Enti republikan i statistikës, Shkup, 1973;

republikë kushtëzoheshin me zhvillimin e rrethanave shoqërore, politike, ekonomike dhe historike.

Në periudhën (1945-1975), në RP të Maqedonisë gjegjësish në RS të Maqedonisë u miratuan disa planprograme mësimore, dhe të gjitha këto, ndër të tjera, shprehnin synimin për arsimimin e të riut, i cili me gjithanshmërinë e tij do t'i përgjigjet realitetit.

Planprogrami i parë mësimor<sup>1</sup> për shkollën filllore në Maqedoninë federale u miratua pas formimit të shtetit maqedonas (ASNOM-it), më 2 gusht 1944 dhe u zbatua në vitet 1944/45, 1945/46. Këtë dokument të rëndësishëm pedagogjik e miratoi Ministria e Arsimit<sup>2</sup>. Planprogrami mësimor përmban 10 lëndë dhe sipas këtij punonin edhe shkollat filllore shqipe në RS të Maqedonisë. Edhe pse kanë qenë të përkohshëm, me këto ishin përfshirë të gjitha lëndët dhe përbajtjet mësimore, të nevojshme për formimin e njeriut të ri socialist dhe për masivizimin e arsimit.

Planprogrami mësimor përfshinte këto lëndë: gjuhën amtare (shqipe), gjuhën federale (maqedonishten), historinë e Jugosllavisë me historinë e pakicave, gjeografinë me gjeografinë e popujve që i takon pakica, shkencat natyrore, matematikën, vizatimin, këndimin, gjimnastikën, bukurshkrimin dhe religionin<sup>3</sup>.

Sipas tabelës në shtojcën nr.10 mund të konstatohet fondi i përgjithshëm i orëve, siç vijon: klasa e parë (19), II (19), III (26), IV (28) orë në javë. Duke pasur parasysh planet tjera mësimore gjatë kësaj periudhe, nuk ka ndryshime qenësore në klasën I dhe II, pranumri i orëve është normal, kurse në klasën III dhe IV, numri i orëve është i tepëruar.

Në fund të programit është lënda nga religjioni, që është lëndë e obligueshme. Planin mësimor për religionin e përpilonin organet fetare.

Në programin mësimor, për çdo përbajtje përcaktohet qëllimi i edukimit dhe arsimimit. Sa për ilustrim citojmë disa lëndë:

1. Qëllimi i mësimit të gjuhës popullore është: a) "...përvetësimi i njohurive të para, leximi logjik, hartimi me shkrim, b) të punohet në

<sup>1</sup> Dokumenteve për të cilat flas, u mungon viti i lëshimit. Nga disa informata, përbajtje dhe karakteristika mund të konstatohet se janë lëshuar pas ASNOM-it, në shtator të vitit 1944;

<sup>2</sup> Titulli original është "Planprogrami mësimor i përkohshëm për shkollat filllore në Maqedoni";

<sup>3</sup> Planprogramet mësimore do të jepen në shtojcë;

mënyrë permanente në aftësimin e nxënësve që të shprehen me shkrim dhe me gojë, c) të zhvillohet dashuria dhe interesimi për librin”<sup>1</sup>.

Detyrat e njëjtë që ishin përcaktuar për gjuhën maqedonase vlenin edhe për gjuhën shqipe.

2. Qëllimi i mësimit të historisë është që “nxënësit të njoftohen me historinë e popujve të Jugosllavisë, të zhvillohet dashuria ndaj atdheut dhe popujve të tij, të forcohen dhe ruhen të gjitha fitoret e korrura në LNC<sup>2</sup>.

3. Qëllimi i mësimit të njoheri-natyrës është që nxënësit të mësojnë për natyrën, të formojnë pikëpamjen shkencore për natyrën dhe fenomenet e saj, t’i zbulojnë lidhjet natyrore, të njoftohen me njeriun i cili kishte përvetësuar dituritë natyrore<sup>3</sup>.

4. Qëllimi i mësimit të matematikës në shkollën filllore ka qenë “njoftimi me konceptet e shumta në natyrë dhe shoqëri, me formën dhe madhësinë e numrave. Që nxënësit ta përvetësojnë shpejt materien dhe t’i zgjidhin detyrat ngajeta”<sup>4</sup>.

Të gjitha qëllimet edukuese-arsimore kishin detyrë themelore që nxënësit si qytetarë aktivë të fitojnë dituri të vërtetë e cila do t’u shërbëjë në jetë dhe në ndërtimin e shoqërisë sonë. Të gjitha përbajtjet mësimore në program janë dhënë në mënyrë globale dhe tematike.

Ky planprogram mësimor ka qenë i shkurtër dhe ka pasur 56 faqe të formatit 11 x 26 cm. Edhe pse ka qenë i përkohshëm, dallohej me karakterin pozitiv shoqëror-pedagogjik dhe metodik, gjë që shihet nga shtojca vijuese (10-a).

1. Ky është dokumenti i parë pedagogjik sipas të cilit janë organizuar të gjitha shkollat popullore të të gjitha nacionaliteteve në RP të Maqedonisë.

2. Të gjitha përbajtjet janë orientuar në drejtim të edukimit të njeriut të ri socialist.

3. Të gjitha përbajtjet mësimore kanë për qëllim të formojnë pikëpamjet shkencore për botën.

4. Po ashtu, këtu kemi edhe shenjat e para që kisha të ndahet nga shkolla, ngase mësimi i religionit u bë i paobligueshëm.

5. Zhvillimi i vëllazërim-bashkimit dhe internacionalizmit si dhe urrejtja kundër të gjithë pushtuesve etj.

<sup>1</sup> Planprogrami i përkohshëm për shkollat filllore në Maqedoni, f.3;

<sup>2</sup> Ibid.f.14;

<sup>3</sup> Ibid.f.23;

<sup>4</sup> Ibid.f.34;

Ana e dobët e këtij dokumenti, më duket se është e kuptueshme. Sa për ilustrim mund t'i veçojmë këto:

- ndarja e lëndës së Historisë dhe Gjeografisë prej klasës III-IV
- numri i madh i orëve nga gjuha amtare, gjithsej 9 orë për klasën I dhe II,
- ndarja mekanike e bukurshkrimit (si lëndë mësimore) nga gjuha amtare,
- në klasën IV, foni i orëve është i madh, 29 gjatë javës.

Planprogramin e parë mësimor zyrtarisht e miratoi Ministria e Arsimit e RPM-së në vitin 1946.

Për kombësinë shqiptare, në këtë plan dhe program zyrtar mësimor janë paraparë këto përbajtje mësimore: gjuha popullore (shqipe), gjuha maqedonase, historia e Jugosllavisë, gjeografia e Jugosllavisë, njoħuri natyre, matematikë, vizatim, këndim, fizkulturë, bukurshkrim (fondi i orëve, shih tabelën në shtojcën nr.10a).

Përveç këtij planprogrami mësimor, në vitin shkollor 1944/45 nga ana e Ministrisë së Arsimit u miratua edhe një planprogram i shkurtuar, për ata nxënës që kishin humbur kohën për shkollim të rregullt, pra për ata nxënës që gjendeshin në moshën kur ishte dashur ta përfundojnë shkollën fillore, dhe për nxënësit me ndërprerje të cilët punonin dhe kalonin rregullisht në klasat më të larta<sup>1</sup>.

Po ashtu, në vitin e parë pas çlirimit u miratua edhe "Plani mësimor minimal" për punë në paralelet e kombinuara për ata arsimtarë që punonin në dy ndërrime. Sipas këtij plani mësimor, fondi i orëve për klasën e parë është shkurtuar në 15 orë, për klasën e dytë në 15 orë, kurse për klasën e tretë dhe të katërt në 18 orë në javë.

Për të pasur pasqyrë të qartë duhet veçuar dhe shikuar plotësimin e këtij plani mësimor, i cili ka qenë zyrtar.

- Mësimi i religionit në të nuk gjendet as si lëndë e posaçme, e as si lëndë fakultative.
- Fondi i përgjithshëm i orëve është në rritje për nga 1 orë në javë, përjashtim bën klasa e katërt me shtim prej 2 orësh.
- Është lejuar planprogrami i shkurtuar për paralele të kombinuara.
- Bukurshkrimi është lejuar si lëndë e posaçme në klasën e tretë dhe të katërt.

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Udhëzime për punë në shkollat fillore sipas programeve të shkurtuara mësimore për vitin shkollor 1944/45, kut.29;

Sa u përket përbajtjeve mësimore, këtë program mësimor e karakterizojnë këto ndryshime:

- Përbajtjet mësimore për gjuhën amtare janë zgjeruar në mënyrë sistematike dhe konkrete, kështu që përpunohen më mirë dhe më lehtë.

- Detyrat dhe qëllimet e gjeografisë janë paraqitur qartë.

- Në klasën e parë dhe të dytë vizatimi paraqitet edhe si lëndë e re.

- Në klasën e tretë dhe të katërt, përbajtjet mësimore për lëndën e edukatës fizike janë precizuar.

Ky dokument, sipas vëllimit dhe mënyrës sistematike të hartimit u përgjigjej kushteve të atëherershme. Por, në rrethana të ndryshuara në vitin 1948, Ministria e Arsimit e RP të Maqedonisë lejon “planprogramin e ri mësimor” për shkollat fillore. Ky dokument shkollor ishte shkruar në gjuhën maqedonase dhe më vonë është përkthyer në gjuhën shqipe. Ky planprogram mësimor përfshinte këto lëndë: (shih tabelën në shtojcën nr.11).

Duke krahasuar këtë plan me planprogramin mësimor të vitit 1946, shohim se dallimi ekziston vetëm sa i përket numrit të orëve, kështu që në klasën e tretë ka dy orë më pak (25) dhe një orë më shumë në klasën e dytë (21). Në këtë plan mësimor, si lëndë e posaçme paraqitet Puna e dorës, me nga një orë në javë në të gjitha klasat. Edhe ky plan mësimor ka variantin e veçantë të shkurtuar për punë në paralelet e kombinuara me këtë fond orësh në javë: klasa e parë dhe e dyta nga 18 orë, klasa e tretë 20, klasa e katërt 21 orë.

Orët e gjuhës shqipe u zvogëluan nga 10 në 5 orë, për arsyse se prej klasës së tretë mësohet edhe gjuha maqedonase me 2 orë në javë, ndërsa janë futur në plan edhe ato lëndë që nuk janë mësuar në klasën e parë dhe të dytë. Në këtë plan dhe program mësimor, kujdes më i madh i kushtohet gjuhës amtare. Përbajtjet mësimore janë të sistematizuara dhe logjike. Për të gjitha lëndët në program janë përpunuuar qëllimet dhe detyrat. Kujdes i veçantë i kushtohet aplikimit të lëndës së re - Punëdores. Qëllimi i kësaj lënde është që tek nxënësit t'i zhvillojë shprehitë për manipulim me veglat kryesore, ta zhvillojë dashurinë dhe respektin ndaj punës, precizitetin, rregullshmërinë, qëndrueshmërinë, këmbëngulësinë dhe synimin për t'u arritur punë cilësore<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Programi mësimor për shkollat fillore, Shtëpia botuese shtetërore e RPM-së, Shkup, 1948, f75;

Puna e dorës aplikohet në të gjitha klasat me nga 1 orë në javë. Përbajtjet mësimore-arsimore janë konkrete. Nëse bëjmë një analizë të thellë, atëherë do të shohim se ky plan dhe program mësimor parashihte shumë ndryshime pozitive, që do të thotë se është bërë një përparim i dukshëm për “tërë” ardhmerinë që vjen, e jo vetëm për periudhën kalimtare<sup>1</sup>. Për planprogramet mësimore për shkollat filllore në RP të Maqedonisë, në vitet 1949, 1950, 1951, 1952, 1953, 1957, janë bërë edhe ndryshime, por këto kanë qenë tejet të vogla në krahasim me planprogramet e mëparshme mësimore. Në kuadër të planprogramit federal, këto kishin të bëjnë me klasën III dhe IV, ku parashihej nga 1 orë më shumë gjuha maqedonase. Këto programe mësimore kanë qenë të njëjtë si ai i vitit 1948, me përjashtim se në këto më gjerësisht janë përfshirë përbajtje nga historia, e posaçërisht nga historia maqedonase<sup>2</sup>. Prej vitit 1947/48 filloi themelimi i shkollave të zgjatura filllore. Ministria e Arsimit e RP të Maqedonisë miratoi planprogramin mësimor për shkollat e mesme<sup>3</sup>. Gjithsej lëndë mësimore ishin 17 (shih tabelën në shtojcën nr.12) me fond të pamjaftueshëm të orëve: 29 në klasën e parë (në gjimnaz) ose në klasën e pestë të shkollës tetëvjeçare, deri më 32 orë në klasën e tetë të gjimnazit ose klasën e katërt të gjimnazit të plotë.

Fondi i orëve ishte zvogëluar, kurse te disa lëndë përbajtjet mësimore nuk i përcaktonin detyrat dhe qëllimin e punës edukuese-arsimore.

Dy vjet më vonë (1956) u bënë disa korrigjime të vogla, sidomos te gjuha amtare shqipe, ku fondi i orëve është zvogëluar nga 5 në 4. Përbajtja mësimore për lëndën gjuhë shqipe nuk ishte përfshirë; mendoj se deri në këtë periudhë janë përdorur planet mësimore të KSA të Kosovës.

Pas Rezolutës së Plenomit III të KQ të LKJ-së mbi detyrat në shkollim, në përdorim u aplikuan planet mësimore të vitit 1949, 1950, 1951, 1952, 1953 për shkollat filllore, për klasat e larta të shkollave tetëvjeçare, përkatësisht klasat e ulëta të gjimnazeve, te të cilat janë bërë disa ndryshime.

Prej vitit 1952, koncepcionin për hartimin e planprogramit mësimor, në vend të Ministrisë së Arsimit e jep Këshilli për Arsim, Shkencë dhe Kulturë i RS Të Maqedonisë. Gjatë kësaj periudhe u mi-

<sup>1</sup> K.Marks, F.Engels, Mbi edukimin dhe arsimimin, Beograd, 1948, f.92;

<sup>2</sup> Planprogrami mësimor, Shtëpia botuese shtetërore e RPM-së, Shkup, 1950;

<sup>3</sup> Planprogrami mësimor për shkollat e mesme dhe filllore, “Prosvetno dello”, Shkup, 1948;

ratuan disa planprograme mësimore për shkollat filllore, tetëvjeçare dhe të mesme.

Për historinë e shkollës shqipe në RS të Maqedonisë, rëndesi të posaçme pedagogjike-historike ka “PROGRAMA E GJUHËS SHQIPE PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TETËVJEÇARE, PËR GJIMNAZET DHE NORMALET” (1953). Ky program ishte i pari i cili u miratua në gjuhën shqipe, kurse e hartuan punëtorët më të dalluar arsimorë<sup>1</sup>.

Në këtë planprogram mësimor ka disa ndryshime të vogla në krahasim me programin e vitit 1948. Risia ka të bëjë vetëm me detyrat edukuese-arsimore dhe me burimet dhe përcaktimin e mësimit.

Në shtator të vitit 1957, për shkollat në RS të Maqedonisë u miratua “planprogrami mësimor për shkollat filllore dhe tetëvjeçare”. Ky planprogram mësimor është hartuar në fryshtë e reformës që anonte në llojin unik të shkollës filllore. Lëndët mësimore dhe fondi favor i orëve janë paraqitur në shtojcën e tabelës nr.13. Sa u përket lëndëve mësimore për klasat e ulëta nuk ka ndryshime të qenësishme, kurse në klasat e larta (V-VIII) është karakteristike se është shtuar numri i orëve në klasën VII, për 33 orë, kurse në klasën VIII për 36 orë.

Në përbajtjet mësimore të gjuhës shqipe nuk janë paraparë përbajtje të posaçme mësimore. Arsintarët e kësaj lënde i përbasheshin programit mësimor të vitit 1953<sup>2</sup>.

Me programin mësimor për klasat e larta janë paraparë përbajtje mësimore edhe nga gjuhët e huaja, edhe atë nga rusishtja, frëngjishtja, gjermanishtja dhe anglishtja. Te ky planprogram mësimor është mbajtur mjaft llogari për aftësitë psiko-fizike të nxënësit. Përbajtjet janë të sistematizuara dhe konkrete. Është karakteristike ndarja e teorisë nga praktika në lëndët siç janë BAT-i dhe Bujqësia, ngase në program është paraparë vetëm puna praktike.

Paralelisht me ndërmarrjet reformuese me të cilat shkolla filllore u bë themel i sistemit të përgjithshëm shkollor, Këshilli i Arsimit i Maqedonisë përgatit edhe dispozita nga Ligji i përgjithshëm për shkollimin dhe në vitin 1959 miraton planprogramin e ri mësimor për shkollën filllore prej klasës I-V, kurse në vitin 1960 u përgatit edhe pjesa e dytë prej klasës V-VIII, Këshilli i Arsimit i RS të Maqedonisë,

<sup>1</sup> Programin mësimor e lejoi Komisioni në përbërje: dr.Petro Janura (kryctar), Hristo Zografski, Qemal Musli, Olivera Jashar, Josif Todi, Stefan Zorba, Jusuf Selimi, Abdulla Ukshini, 30.XII.1953, “Prosvetno dello”, Shkup;

<sup>2</sup> Informatë e dr.Petro Janurës, profesor në Fakultetin Filologjik, Abedin Zenku, ish-mësues dhe inspektor, Xhemaludin Presheva, këshilltar pedagogjik për Shkupin;

më 29.IV.1959 mori vendim që ky planprogram mësimor të zbatohet edhe në vitin shkollor 1959/60.

Ky planprogram mësimor u hartua me shqyrtimin rrënjosor të planprogrameve të mëparshme mësimore që u aplikuan në RP të Maqedonisë dhe RFPJ dhe me propozimet themelore të këshillave racionale dhe të qyteteve, të arsimit dhe kulturës. Me rastin e përpilimit të këtij planprogrami mësimor nga ana e Komisionit, u morën parasysh aftësitë psiko-fizike të fëmijës dhe parimi i shkallshmërisë etj.

Lëndët mësimore dhe numri i orëve janë paraqitur edhe në shtojcën e tabelës nr.13. Në këtë plan mësimor ekzistojnë ndryshime sa i përket fondit të orëve: në klasën I - 21 orë, në klasën II - 21 orë, në klasën V - 26, në klasën VI - 28 dhe në klasën VII dhe VIII nga 30 orë. Struktura e planit mësimor në pesë klasat e para jep mundësi që mësimin ta zhvillojë arsimtari klasor, kurse prej klasës VI-VIII arsimtari lëndor. Po ashtu janë paraparë edhe aktivitete të lira për parimin e vetëqeverisjes së nxënësve. Është me interesim se lënda e Njohuri Natyrës dhe Shoqërisë që mësohej deri në klasën III, tani mësohet prej klasës IV dhe klasës V dhe ndahet në Njohuri Natyre që përfshin konceptet e përgjithshme për natyrën prej klasës IV-VI, kurse prej klasës VI-VIII mësohet vetëm si a) Fizikë, Kimi dhe Biologji. Po ashtu nga klasa e parë mësohet veçanërisht edhe Njohuri Shoqëria, por që konceptet e përgjithshme të mësimit prej klasës IV-V, për klasës VI diferencohen lëndë të posaçme: a) Gjeografija, b) Historia, c) Bazat e moralit socialist. Gjuha e huaj si lëndë edhe më tutje mbeti sipas zgjedhjes. Në vitin 1960 hyri në përdorim edhe pjesa e dytë e planprogramit mësimor, në të cilin ishin bërë disa korrigjime minimale. Posaçërisht duhet theksuar se në kuadër të programit tashmë kishin ardhur në shprehje përbajtjet bashkëkohore, para së gjithash ishte zgjuar interesimi i nxënësve dhe pjesëmarrja e tyre në punën shoqërore-prodhuese, ashtu që aplikohet lënda e re, BAT-i, me nga 2 orë në javë, prej klasës IV-VII.

Ky plan mësimor dallohej nga të mëparshmit edhe për nga ajo se ishte mjaft fleksibil dhe jepte mundësi të zbatohet nen 30 i Ligjit të përgjithshëm mbi shkollimin<sup>1</sup>.

Pas reformës, pothuaj 7 vjet, shkolla shqipe, e po ashtu edhe shkollat tjera në RS të Maqedonisë punonin pa korrigjime të planpro-

<sup>1</sup> Këshilli për Arsim i Këshillit Popullor Komunal mund të plotësojë planprogramin mësimor sipas nevojave të rrethit dhe kushteve të shkollës, por që këshilli është i obliguar që fillimisht ta sigurojë mendimin dhe propozimin e disa shkollave;

gramit mësimor. Si rezultat i kësaj u hartua edhe elaborati “Rezultatet dhe problemet në reformën e shkollës filllore”, ku u mblohdhën rezultatet dhe mangësitë në planprogramet mësimore në përgjithësi dhe veçanërisht të çdo lënde.

Në një konferencë të Kuvendit të RS të Maqedonisë të vitit 1964, u erdh në përfundim që në planprogramin mësimor të bëhen disa korrigeje që i kërkonte jeta bashkëkohore, e sidomos të sigurohet fondi i orëve nga disa lëndë, ngase në programet mësimore disa përbajtje në disa lëndë përsërisheshin<sup>1</sup>.

Në vitin 1966 u hartua planprogrami i ri mësimor për shkollat filllore në RS të Maqedonisë. Lëndët mësimore dhe numri i orëve janë paraqitur në tabelën nr.14 në shtojcë. Në këtë planprogram mësimor ka disa ndryshime. Njëren nga gjuhët e kombeve ose kombësive të Jugosllavisë, e në mesin e tyre edhe gjuhën shqipe, që është përfaqësuar prej klasës V-VIII, kanë të drejtë ta mësojnë edhe pjesëtarët e kombeve ose kombësive, kurse për nxënësit shqiptarë edhe më tutje gjuha maqedonase mbetet si e obligueshme, gjë që mendoj se është e arsyeshme. Lënda e bukurshkrimit (të shkruarit bukur) u hoq nga plani mësimor, kurse pjesërisht kjo lëndë përfshihet në gjuhën amtare në klasën I dhe II. Lënda Njohuri Natyre dhe Shoqërie mësohet në klasën I, 3 orë, në klasën II, 3 orë dhe në klasën III, 4 orë. Planprogrami mësimor i përmendur, përveç orëve të obligueshme parashevë edhe orë të tjera, eventualisht për lëndë dhe përbajtje të tjera, duke filluar nga klasa V me nga 1 orë në javë, kurse në klasën VII-VIII me nga dy orë.

Në kuadër të lëndës së Njohuri Natyrës dhe Shoqërisë, në programin mësimor është paraparë puna praktike, kurse në lëndën e BAT-it parashihen edhe përbajtje mësimore për punë prodhuese dhe të dobishme shoqërore brenda vetë shkollës dhe jashtë saj. Qëllimi dhe detyrat e kësaj lënde janë që “nxënësit të fitojnë njohuri themelore, shkathtësi dhe shprehi nga teknika dhe prodhimi<sup>2</sup>. Po ashtu është paraparë edhe mësimi plotësues nga kjo lëndë me nga një orë prej klasës I-IV e me nga 2 orë prej klasës VI-VIII.

Ky planprogram mësimor dallohet nga planprogrami i mëparshëm mësimor me ndryshime cilësore, është bërë konkretizimi i përbajtjeve mësimore dhe ato jepin mundësi më të mëdha për kreativitetin e arsimtarit, mandej janë përfshirë përbajtje bashkëko-

<sup>1</sup> Planprogrami mësimor për shkollat filllore në RSM, “Prosvetno dello”, Shkup, 1966;

<sup>2</sup> Planprogrami mësimor për shkollat filllore në RSM, “Prosvetno dello”, Shkup, 1966, f.117 (op.cit.f.117);

hore që i kërkon jeta bashkëkohore. Mësimi zhvillohet sipas parimit të shkallshmërisë, kurse arsimtarit i jepet mundësia që vetë ta planifikojë temën.

Këshilli i RS të Maqedonisë në bashkëpunim me Entin për përparimin e shkollës, më 29.IV.1972 miraton planprogramin e ri mësimor për shkollat fillore. Lëndët mësimore janë paraqitur në tabelën nr.15 në shtojcë.

Cdo lëndë mësimore në këtë planprogram mësimor realizohet si pas tabelës së paraqitur:<sup>1</sup>

Lloji i Mesim.	FONDI I ORËVE								Gjith. orë në vit
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	
Mës.në Natyrë	18	19	20	23	25	25	26	26	6370
Mës.në Kurse	-	-	-	-	-	30	73	62	165
Orë Ku-jdes	+	+	+	+	1	1	1	1	140
Gjith.	18	19	20	23	26	26	27	27	6675

Në këtë planprogram mësimor, si risi paraqiten plane të organizuara nëpër kurse për lëndët: Ndihma e parë dhe Mbrojtja, Amvisëria dhe Bujqësia. Lëndët tjera janë të njëjta si në planin e mëparshëm mësimor.

#### 4. TEKSTET SHKOLLORE

Me hapjen e shkollave të para fillore shqipe në RS të Maqedonisë, u paraqit nevojë e madhe edhe për tekste shkollore, si dhe për mjete të tjera shkollore dhe mësimore.

Në vitin e parë shkollor 1944/45 nuk ekzistonin kurrfarë librash, e madje nuk kishte as lapsa. Shumica e shkollave fillore planprogramin mësimor të paraparë nuk mund ta realizonin. Mësimi zhvillohej më shumë sipas aftësive dhe gjeturisë së mësuesve. Më shumë përpuno-heshin përrallat që përmbanin mësime morale, mësoheshin këngë

<sup>1</sup> Shkolla fillore, op.cit.f.10;

revolucionare, alfabeti dhe numërimi. Në shkollat me mësim në gjuhën shqipe disa mësues përdornin edhe "mini-tabelat" me lapsa argjili, në vend të abetareve përdoreshin ato abetare që kishin qenë në përdorim gjatë okupacionit italian, por me fletë të grisura të cilat nuk ishin të përshtatshme për edukimin dhe arsimimin e njeriut të ri në shoqërinë socialiste<sup>1</sup>.

Pas fitores, pushteti popullor u angazhua për botimin dhe distribuimin e teksteve shkollore në të gjitha shkollat e territorit të Maqedonisë. Më 31 mars 1945, Presidiumi i ASNOM-it mori vendim të formohet shtëpi botuese. Më 16 prill 1945, Qeveria e Maqedonisë, në bazë të propozimit të Ministrit të Arsimit Popullor, miratoi një dokument të rëndësishëm për formimin e shtypshkronjës shtetërore dhe një rregullore të posaçme, me të cilën rregullohet detyrat, burimet financiare dhe kompetencat e kësaj shtëpie botuese<sup>2</sup>.

Kjo shtëpi botuese punën e saj e filloi me botimin e abetares së parë maqedonase dhe drejtshkrimit maqedonas<sup>3</sup>. Për përgatitjen e këtyre dy dokumenteve të rëndësishme u angazhuan punëtorët më eminentë shkencorë të Maqedonisë. Me botimin e planprogramit të ri mësimor për shkollat fillore, u kushtëzua edhe përgatitja e teksteve. Ministria e RPM-së përmes një komisioni të veçantë filloi të batojë tekste shkollore. Komisioni botonte libra deri në vitin 1949, kurse botimi i mëtejshëm i të gjitha teksteve shkollore bëhej përmes konkursit<sup>4</sup>.

Botimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe në RPM, përkatësisht në RSM, filloi prej vitit 1946. Këtë vit, Ministria e Arsimit boton abetaren e parë në gjuhën shqipe, të cilën e përgatiti mësuesi nga Gostivari, A.Dogani. Prej vitit 1947, Shtëpia botuese me emrin "Prosvetno dello" në Shkup, për kombësinë shqiptare në Maqedoni fillon të batojë libra, duke filluar nga abetarja e deri te libri i leximit për klasën II, III dhe IV me tirazh prej 10.000 deri 13.000 ekzemplarë<sup>5</sup>. Por, për shkak të arsyeve objektive, kjo shtëpi nuk mund

<sup>1</sup> Kujtimet e nxënësve dhe arsimtarëve në vitet e para të paslufitës;

<sup>2</sup> Shtëpia botuese "Prosvetno dello" obligohet të shtype dhe distribuoje libra për të Maqedoninë (nëni 2);

<sup>3</sup> Drejtshkrimi i gjuhës maqedonase është miratuar me vendim të posaçëm të Ministrisë së Arsimit të RP të Maqedonisë më 7 qershor 1945;

<sup>4</sup> Çedomir Popoviq, Botimi i teksteve 1945-1960, "Prosvetno dello" 5-6, Shkup, 1961, f.347;

<sup>5</sup> Shtëpia botuese "Prosvetno dello" batoi librin në gjuhën shqipe prej I-IV, kurse për klasat e larta dhe shkollat e mesme i siguroi nga KSA e Kosovës;

të përgatiste dhe botonte të gjitha librat për shkollën filllore në gjuhën shqipe, ndaj librat tjera u morën nga KSA e Kosovës<sup>1</sup>.

Ky problem ka qenë mjaft aktual në vitet e para pas çlirimt dështë shqyrta edhe në Komitetin për Shkollë dhe Shkencë pranë Qeverisë së RFPJ-së. Për ta lehtësuar punën rreth furnizimit me tekste për të gjitha shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Jugosllavi, Komiteti për Shkolla i Qeverisë së RFPJ-së iu drejtua RP të Shqipërisë fqinje me kërkësë që të shtypë numër të caktuar tekstesh<sup>2</sup>.

Ministria e Arsimit e RPM-së me shkresë të veçantë iu drejtua Komitetit për Shkollim në Beograd me kërkësë se shkollës shqipe në territorin e Maqedonisë i nevojiten tekste për shtatëvjeçaret, me interesim të posaçëm për këto libra:

1. Gramatika dhe Sintaksa për klasën V, VI dhe VII - 800 ekzemplarë.
2. Fizika për klasën VI - 400 ekzemplarë.
3. Gjeometria për klasën VI - 400 ekzemplarë.
4. Fizika për klasën VII - 200 ekzemplarë.
5. Kimia për klasën VII - 200 ekzemplarë.
6. Algjebra për klasën VII - 200 ekzemplarë.
7. Aritmetika për klasën V-VI - 600 ekzemplarë.
8. Gjeometria për klasën VIII - 600 ekzemplarë.

Shtëpia botuese "Prosvetno dello", prej vitit 1947 i siguron të gjitha librat prej abetares së parë e deri te librat për klasën IV, përmes konkursit dhe përkthimeve nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe. Në këtë kohë ishin angazhuar eksperëtë përkthim, siç janë: Olivera Jashar-Nasteva, Sami Lamçe, Stefan Zorba, Dibran Bekiri, Malevska Paraskeva, Lutfi Rusi<sup>3</sup>. Po ashtu u botuan edhe tekste autorësh shqiptarë për shkollat filllore përmes konkursit, e sidomos libra leximi dhe abetare.

Me reformën shkollore duhej botuar tekste që do të dallohen nga të përparshmet, edhe sipas përgatitjes teknike edhe sipas konцепcionit pedagogjik.

<sup>1</sup> Me miratimin e planprogramit mësimor për vitin 1972, "Prosvetno dello" u obligua se do të batojë libra në gjuhën mësimore shqipe edhe për klasat e larta dhe të shkollave të mesme, me plotësimë dhe informata të kryeredaktorit dhe redaktorit përgjegjës për botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, Islam Karanfili;

<sup>2</sup> AM - Shkup, FD, Lista e librave (teksteve) të nevojshme për nxënësit e paraleleve shqipe të shkollave filllore dhe të mesme në RPM, dok.nr.1919, dt.29.II.1948;

<sup>3</sup> Bibliografia, 1945-1970, "Prosvetno dello", Shkup, 1975, f.245-165 (Registri i autorëve dhe i titujve të librave);

Prej vitit 1970 në hartimin dhe botimin e teksteve në gjuhën shqipe punonin punëtorë arsimorë që ishin lidhur drejtpësëdrejti me mësimin, ngase botimi i teksteve është punë mjaft e komplikuar dhe çdo libër kërkon njohje thelbësore të problematikës. Përpilues më të njohur të teksteve janë: Hamza Reka, Haxhi Fida, Rexhep Rexhepi, Xhevati Gega, Remzi Nesimi, Zihni Osmani, Kimete Agai, Ali Aliu etj. Pas vitit 1972 botohen edhe tekste për klasat e larta të shkollës fillore në Maqedoni. Tekstet shkollore nuk i shkruanin sipas modelit të teksteve nga RPS e Shqipërisë dhe të Kosovës, por sipas modelit të Republikës së Maqedonisë.

Nga fillimi i botimit të abetares së parë në gjuhën shqipe e deri në vitin 1974/75, kjo shtëpi botuese për nevojat e shkollës fillore batoi 211 botime me tirazh prej më se 922.660<sup>1</sup> copë.

Botimi i teksteve të reja passoi me ekspansionin e fuqishëm dhe transformimet e shpeshta që krijuar gjatë kësaj periudhe të zhvillimit të shkollimit fillor për kombësinë shqiptare.

#### 4.1. MJETET MËSIMORE

Pas Luftës së Dytë Botërore, rrëth organizimit dhe furnizimit të shkollave me mjete themelore mësimore u zhvillua një aktivitet i madh. Ky aktivitet filloi nga vetë prindërit, nga arsimtarët, nxënësit, por edhe nga vetë ndërmarrjet.

Viti i parë, pra 1944/45, filloi në atë mënyrë saqë të gjitha shkollat punonin në kushte të vështira. Në shumë shkolla në fshatra, nxënësit i sillnin nga shtëpitë e tyre karriget ose hasrat. Prindërit, vullnetarisht së bashku me arsimtarët ngallmonin dërrasa për të bërë banka shkollore. Edhe përkundër faktit se shumë ndërmarrje përpunimin e drurit ishin angazhuar për t'i furnizuar shkollat me mobilie shkollore, nuk mund të plotësoheshin nevojat e të gjitha shkollave ngase rrjeti shkollor zhvillohej me një temp të shpejtuar. Në vitet e ardhshme, shumica e shkollave u furnizuan me mobilie shkollore, të adaptuara sipas moshës psiko-fizike të nxënësve. Problem paraqiste mungesa e fletoreve dhe lapsave. Sipas kujtimeve të disa mësuesve, një laps ndahej në tri pjesë kurse një fletore u ndahej disa nxënësve.

<sup>1</sup> Ibid.;

Për realizimin e ilustrimeve dhe demonstrimeve në njësitë mësimore nuk kishte mjete mësimore. Mësimi në të shumtën e rasteve zhvillohej verbalisht, edhe pse nevoja ishte tejet e madhe, dhe kjo në shkollë e vështirësonte ndërtimin e pikëpamjeve shkencore ndaj botës, natyrës dhe shoqërisë. Mjete mësimore në shumicën e shkollave nuk kishte. Ky problem është shqyrtuar pranë Komitetit për Shkollim dhe pranë Qeverisë së RFPJ. Komiteti hartoi elaboratin për hartimin dhe distribuimin e mjeteve mësimore dhe edukuese<sup>1</sup>.

Lidhur me konkluzionet e konferencës për përpilimin dhe distribuimin e mjeteve mësimore dhe edukuese, këto u ndanë në dy grupe. Mjete mësimore që mund t'i bënin arsimtarët dhe nxënësit dhe punëtoritë për ndërtimin e mjeteve mësimore dhe edukuese. Arsimtarët dhe nxënësit, me ndihmën e organizatës së rinisë grumbulluan shumë mjete mësimore, sidomos nga biologjia dhe zoologjia. Nxënësit e klasave të ulëta në rrëthninë përkatëse grumbullonin mjete përkatëse, kurse nxënësit e klasave të larta edhe jashtë vendlindjes së tyre.

Sektori i planit i Ministrisë së arsimit të çdo republike ishte i obliguar të përpilojë listën e nevojave për të gjitha shkollat e rajonit të saj, me konsultimin e ekspertëve dhe metodicientëve të shkollave përkatëse dhe për këtë doemos duhej t'i drejtoheshin Komitetit për Shkollë dhe shkencë të Qeverisë së RFPJ, natyrisht nëse vetë republika nuk mund t'i siguronte<sup>2</sup>.

Çështja e mjeteve mësimore dhe edukuese ishte problem në të gjitha republikat. Që të kursehej, u aplikua parimi i solidaritetit ndërmjet republikave, të cilat u obliguan që çdonjëra sipas mundësive të saj të sigurojë ose punojë numër të caktuar mjetesh mësimore përlendë të caktuara dhe sipas republikave përkatëse<sup>3</sup>. (Shih shtojcën nr.18).

Çdo vit sasi të konsiderueshme mjetesh mësimore dhe edukuese u dërgoheshin të gjitha shkollave. Po ashtu mjetet mësimore i punonin nxënësit dhe arsimtarët.

Me zhvillimin e ekonomisë sonë ky problem u zgjidh dhe shumë shkolla u pajisën me mjete mësimore, kurse në shumë shkolla mësimi

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD, Udhëzim për hartimin dhe distribuimin e mjeteve mësimore dhe edukative, kut.75;

<sup>2</sup> Ibid.f.2;

<sup>3</sup> Lista e mjeteve më të nevojshme mësimore në kllapa do të thotë se të gjitha republikat populllore obligoheshin të batojnë mjete të caktuara mësimore;

zhvillohej në kabinete të furnizuara me teknikën më moderne dhe me mjete të ndryshme bashkëkohore.

## 5. AKTIVITETET E LIRA

Menjëherë pas hapjes së shkollës së parë në RP të Maqedonisë insistohet që shkolla të mos jetë vend ku vetëm mësohet, por që ajo me veprimtarinë e saj kulturore dhe publike të bëjë ndikim përkatës, kështu që tek prindërit apo nxënësit zgjon dëshirën dhe interesimin për shkollë dhe që shkolla të lidhet me ambientin shoqëror. Këto veprimtari kulturore-publike të shkollës ishin orientuar në punën me nxënësit, bashkëpunimin me prindërit, organizatat shoqërore, politike, sportive, kulturore etj.

Çdo shkollë, sipas mundësive të veta zhvillonte forma të shumta të punës lidhur me aktivitetet jashtëmësimore. Përgatiteshin shfaqje me rastin e festeve shtetërore, festave shkolllore dhe lokale, organizoheshin rivista të ndryshme, eksposita, takime ndërmjet shkollave etj. Po ashtu në vitin e parë pas çlirimt, para qytetarëve të mjediseve të ndryshme sociale dhe kombeve e kombësive të ndryshme qëndronte një punë e madhe që kishte të bënte me rindërtimin e vendit. Ekzistonin aksione punuese për rregullimin e ambientit shkollor, ose në kuptimin më të gjerë aksione siç janë: ndërtimi i rrugëve nëpër fshatra ku përfshiheshin edhe nxënësit, ndihma fshatarëve rrith vjeljes së misrit etj.

Të gjitha këto aksione mundësuan që te nxënësit të formohen shprehitë e punës dhe të ndërtohet vetëdija morale në bashkësinë shumëkombëshe.

Deri në vitet pesëdhjetë, të gjitha shkollat në RP të Maqedonisë zhvilluan aktivitet të madh në aksionet punuese, për çka edhe janë dekoruar. Shkollat tetëvjeçare zhvillonin edhe jetën kulturore-argëtuese që nga vetë themelimi. Sipas mundësive të tyre, shumica e shkollave gjatë festave shtetërore, festave të shkollës dhe festave të tjera, para prindërvë organizonin shfaqje të ndryshme folklorike me lojëra dhe këngë, recitime dhe ngjashëm. Në fillim nuk mbahej llogari se a ishin këto këngë dhe recitime të përshtatshme për moshën e nxënësve. Gradualisht nga viti në vit, aktivitetet jashtëshkolllore filluan të sistematizohen dhe t'u adaptohen kërkuesave pedagogjike, insistohet që sa më shumë të futeshin gjëra nga programi i përgjithshëm i punës së

vetë nxënësve, prindërve, Lidhjes së Pionierëve, Lidhjes së Rinisë Socialiste dhe organizatave të tjera të fëmijëve dhe të rinjve.

Në strukturën e punës edukuese-arsimore, aktivitetet e lira të nxënësve paraqiten si lëmë e posaçme në dokumentet e reformës së parë të sistemit shkollor. Aktiviteti jashtëshkollor trajtohej si pjesa e vetme e punës pedagogjike në realizimin e qëllimeve të edukimit dhe arsimimit në shoqërinë tonë socialiste<sup>1</sup>.

Në dokumentet e reformës shkollore kërkohej që shkolla të organizohej në atë mënyrë, që nxënësit në procesin mësimor të zhvilloheshin më lirë, por mësimi sipas esencës së tij është proces i atillë edukues i cili doemos duhet të kryhet nën udhëheqjen direkte ose indirekte të arsimtarit. Që t'u mundësohet nxënësve që në procesin e përvetësimit të diturive, shkathtësive dhe fitimit të shprehive të manifestonin dhe zhvillonin prirjen dhe kënaqësinë ndaj të interesuarve të posaçëm për ta përjetuar procesin edukativ, lirinë e plotë dhe pavarësinë, në shkollë, përveç mësimit sistematik organizohen edhe forma të llojlojshme jashtëmësimore të mësimit, të ashtuquajtura “aktivitete të lira të nxënësve”. Këto aktivitete duhej të lironin ato nevoja të lindura të çdo fëmije, në mënyrë që të punonin vetë pavarësisht, që vetë të provonin forcën e tyre në ndonjë lloj të veprimtarisë. Sipas kësaj, destinimi i aktiviteteve të lira të nxënësve kishte të bënte me atë që nxënësve t'u ofronte ato dituri, shkathtësi dhe shprehi të cilat shkolla sistematike nuk mund t'ua ofronte. Prandaj, aplikimi i aktiviteteve të lira në shkollë dhe zhvillimi i formave të ndryshme i ndihmonte mësimit që të përsoset, e edhe atëherë kur mësimi organizohej më mirë nuk do të pushonte nevoja për aktivitete të lira të nxënësve.

Përmes aktiviteteve të lira realizohen edhe shumë kërkesa të pedagogjisë socialiste dhe evitojen mangësitë në organizimin e shkollës, sidomos në organizimin e mësimit, si komponentë e tij më e rëndësishme arsimore-edukuese. Te këta vijnë në shprehje të plotë aktivitetet individuale dhe krijimtaria e nxënësve, interesimi dhe aftësitë e tyre. Aktivitetet e lira të nxënësve i kontribuojnë afirmimit të personalitetit të çdo fëmije në kolektivin klasor dhe shkollor. Ka nxënës që mbeten pas në mësim, por tregojnë disa aftësi në aktivitetet teknike, sportive ose artistike dhe këtu e përjetojnë kënaqësinë e suksesit personal dhe të afirmimit të personalitetit të tyre. Për këto arsy, aktivitetet e lira i kontribuojnë orientimit më të suksesshëm e njeko-

<sup>1</sup> Propozim i sistemit të arsimimit dhe edukimit në RFPJ, Beograd, 1957, f.76-88;

hësisht edhe orientimit profesional si dhe seleksionimit të nxënësve, i cili bëhej që në shkallën e parë të arsimimit.

Me miratimin e Ligjit të përgjithshëm për shkollimin (1958), edhe në planprogramet mësimore në vitin 1960 “u definua hapësira dhe përbajtja e atyre formave, të cilat ishin paramenduar që në vitin 1955: aktivitetet e lira nga klasa III e më tutje, nga 2-3 orë në javë<sup>1</sup>.

Shumë shkolla të kombësisë shqiptare në RP të Maqedonisë gjenden në vështirë në gjetjen e raportit të drejtë ndërmjet lëmisë strukturore dhe punës edukuese-arsimore në shkolla. Aktivitetet e lira filluan të konsiderohen si baza të intencës reformuese. Në vend që aktivitetet e lira t'i kontribuojnë gjallërimit të mësimit dhe lidhshmërisë së shkollës me ambientin shoqëror, ato filluan ta çrrregullojnë unitetin e punës edukative-arsimore<sup>2</sup>.

Në planprogramin mësimor të vitit 1966, erdhi deri te konstatimi që aktivitetet e lira të nxënësve të organizohen në pajtim me zhvillueshmërinë dhe mundësitë e shkollave<sup>3</sup>.

Po ashtu, shumë shkolla nuk ishin udhëzuar sa duhet se në ç'mënyrë t'i organizojnë aktivitetet e lira. Disa nxënës ishin përfshirë në më shumë aktivitete të lira dhe në jetën kulturore dhe sportive, e mandej edhe në lëmin e lëndëve mësimore. Ndaj, në planprogramet mësimore u precizua “se nxënësi mund të inkadrohet në aktivitetet e lira, më së shumti në dy forma”<sup>4</sup>.

Angazhimi kohor i nxënësve ishte i përcaktuar edhe atë: prej klasës I-IV me një orë në javë dhe prej klasës V-VIII me nga 2-3 orë në javë. Në strukturën programore të vitit 1960, shuma e përqindjes është 4,11% nga puna e përgjithshme edukuese-arsimore. Në planin mësimor të vitit 1972, për shkak të racionalizimit dhe efikasitetit shuma e përqindjes u zvogëlua në 4,29%.

Në strukturën programore të aktiviteteve të lira ishin paraparë: 1. Aktivitetet e lira për pionierët e rinj të moshës shkolllore, 2. Aktivitetet e lira për pionierët më të vjetër të moshës shkolllore. Aktivitetet e lira nga lëmi i lëndëve në shkollat e kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë filluan të aplikohen prej vitit shkollor 1960/61. Ekzis-

<sup>1</sup> Dr.M.Koletiq, Mbi rrugën zhvillimore të planprogrameve për shkollimin e obliguar (Tridhjetë vjet të pedagogjisë sonë), PKZ, Zagreb, 1976, f.73-74;

<sup>2</sup> Planprogrami mësimor për Shkollat filllore në RPM, “Prosvetno delo”, 1966, f.4;

<sup>3</sup> Po aty, f.18;

<sup>4</sup> Po aty, f.18;

tonin disa sektionet: biologjik-matematikor, historik-kimik, fizik-natyror etj.

Vlerë të posaçme në këtë plan kishin takimet ndërmjet shkollave dhe garat e ndryshme, garat ndërmjet sektioneve. Në këto gara merrnin pjesë nxënësit më të mirë, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare. Takime të këtilla mbaheshin edhe në qytete të ndryshme të RS të Maqedonisë<sup>1</sup>.

Sipas disa raporteve, aktivitetet e lira nga veprimtaritë kulturore-artistike realizoheshin në sektionet e muzikës, të recitimit, të dramës, të folklorit etj. Në shkollat e kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë, përveç sektionit folklorik, sezioni i dramës pranohej më me ëndje nga ana e nxënësve. Në shkollat qendrore dhe në shkollat e plota tetëvjeçare, nxënësit përgatitnën pjesë humoristike dhe drama të ndryshme. Me këto drama, nxënësit e shkollave të ndryshme vizitonin shkolla të tjera jashtë territorit të tyre. Kështu, në vitin 1947 nxënësit e Shkollës Shtatëvjeçare të qytetit të Strugës shfaqën dramën “Vllazni dhe interes” të K.Floqit në Shkollën Shtatëvjeçare “Liria” në fshatin Sërbicë të Kërçovës<sup>2</sup>.

Vizitat e këtilla ishin mjaft të dobishme, meqë nxënësit afroheshin kurse arsimtarët këmbenin përvoja.

Kështu edhe gazetat e shkollave dhe gazetat e mureve që i botonte sezioni letrar kontribuonin shumë që nxënësit t'i publikonin punimet e tyre. Disa shkolla qendrore tetëvjeçare kishin edhe gazetat e tyre me emërtime të ndryshme “Agimi”, “Rreze dielli”, “Shkolla jonë”, “Blerimi” e ngjashëm. Poezitë ose rrëfimet më të mira batoreshin në revistat e fëmijëve “Gëzimi”, “Fatosi” ose në “Shkollari”.

Aktivitetet e lira në lëmin e veprimitarive sportive formonin sektionet të ndryshme: të hendbollit, basketballit, futbollit, atletikës etj. Në aktivitetet sportive hynin edhe garat gjatë festave, Ditës së Rinisë, Ditëlindjes së Titos, kur organizoheshin rivista të ndryshme të kulturës fizike dhe aktivitete tjera.

Aktivitetet e lira nga lëmi i veprimitarisë punuese, prodhuese dhe teknike pranoheshin më me ëndje nga ana e nxënësve, edhe pse mundësítë në disa shkolla ishin minimale. Këto aktivitete i zhvillonin arsimtarët e BAT-it. Më së shumti me këto veprimitari arrinte sezioni i modelimit, ngase përveç shkollës, nxënësit kishin mundësi që të pu-

<sup>1</sup> Informata nga drejtori i Shkollës fillore “Vellazërimi” në Dibër, I.Çiça;

<sup>2</sup> Letër falënderuese me rastin e vizitës së shkollës nga qyteti i Strugës, Ark.i Shkollës fillore të fshatit Sërbicë;

nojnë në klubet e Teknikës Popullore, ku kushtet e punës ishin të shkëlqyeshme.

Sipas strukturës së përgjithshme programore për një shkollë të zhvilluar tetëvjeçare (I-VIII), (me nga 1 klasë), gjatë vitit duhej të realizoheshin gjithsej 648 orë, nga të cilat 432 orë punë në seksione dhe 216 orë të parapara për përgatitje<sup>1</sup>.

### *5.1. PUNA E DOBISHME SHOQËRORE NË SHKOLLË*

Puna e dobishme shoqërore në shkollën fillore është veprimitari edukuese. Me këtë veprimitari shkollat tona ballafaqohen që në vitet e para të çlirimt tē vendit tonë, përkatësisht me formimin e shkollës së parë në RP të Maqedonisë. Në vitet e para nxënësit e shkollave fillore zhvilluan aktivitet tē pasur në evitim e pasojave të luftës, jo vetëm në shkollë, por edhe jasht shkollës. Nxënësit vepronin përmes formave të llojlojshme tē punës, në mbajtjen e higjenës, disiplinës në klasë, kujdesit ndaj oborrit tē shkollës, ruajtjes së përmendoreve kulturore dhe historike, shënimt tē vendeve historike. Për punën e dobishme shoqërore nëpër shkolla ngarkoheshin arsimtarët e edukatës fizike dhe tē artit figurativ, edhe si iniciatorë, edhe si instruktorë.

Po ashtu janë organizuar edhe aksione tē ndryshme që kishin arsyetimin e tyre ekonomik dhe shoqëror. Aksione tē tillë janë:

- Grumbullimi i bimëve mjekuese,
- Grumbullimi i hedhurinave tē ndryshme (shisheve, letrave etj.),
- Pyllëzimi i pyjeve dhe maleve etj.
- Grumbullimi i librave tē vjetër që u ishin ndarë nxënësve materialisht tē rrezikuar.

Për realizimin e punës së dobishme shoqërore ishte paraparë që tē angazhohet shkolla për 1,54% tē kohës së përgjithshme<sup>2</sup>.

Shkollat fillore shqipe në RS të Maqedonisë, varësisht nga mundësítë e shkollës, duhet theksuar se kanë zhvilluar aktivitet tē madh në planin e punës së dobishme shoqërore: në pyllëzimin e ambientit dhe rregullimin e oborreve shkollore.

<sup>1</sup> Informatë për përfaqësimin dhe realizimin e aktiviteteve tē lira tē nxënësve në shkollat fillore në rajonin e komunës së Gostivarit;

<sup>2</sup> Shkolla fillore, struktura e përgjithshme programore, plani dhe programi mësimor "E.Veli", £415;

## 5.2. KOOPERATIVAT E NXËNËSVE

Menjëherë pas luftës, te ne filluan të themelohen kooperativat punëtore fshatare, e sipas modelit të tyre edhe ato shkolllore. Në vitin shkollor 1948/49 këto organizata si të pavarura pushuan të punojnë. Më vonë shoqatat e natyralistëve të rinj zhvilluan aktivitete në kulativimin e kulturave lavërtare dhe kopshtare. Disa vjet pas kësaj, sërisht u themeluan kooperativat e nxënësve, të cilat kryesisht merreshin e nëse jo edhe ekskluzivisht, me punët e furnizimit të nxënësve me tekste dhe mjete shkolllore. Procesi i reformës shkolllore imponoi diskutimin për nevojën e pjesëmarrjes së organizuar të nxënësve në punën prodhuese, ndaj disa mësues u kujtuan se është i nevojshëm formimi i sërishtë i kooperativave shkolllore, i kooperativave të atilla të cilat në radhë të parë do të merren me organizimin e punës së dobishme prodhuese dhe shoqërore të nxënësve. Në vitin shkollor 1955/56 u themeluan kooperativa të tillë shkolllore, së pari në RP të Kroacisë, e mandej edhe në RP të Maqedonisë. Në periudhën e themelimit të tyre fshehej droja që ky aktivitet tejet interesant të mos i ndajë nxënësit nga libri dhe të njëjtët t'i vë nën hije. Vetë zhvillimi i mëtejshëm i kooperativës e kundërshtoi këtë dyshim, edhe pse kooperativat vetë duhej të kërkonin dhe trasonin rrugën. Në pjesën "Puna prodhuese dhe kooperativizmi i nxënësve në shkollën fillore", Ivan Leko thotë se kooperativat e nxënësve u zhvilluan shpejt duke iu falënderuar asaj se në dokumentet e reformës shkolllore u vlerësua pozitivisht zhvillimi i tyre i deriatëhershëm dhe roli edukues arsimor.

Reforma e shkollës në tërësi nxiti pjesën më të madhe të arsimtarëve për krijimtari më të madhe, kurse nxënësit me dëshirë punonin nëpër kooperativa, ngase në shkollë, përveç mësimit mund të krijonin edhe më shumë rezultate të punës së tyre. Të dhënat e para për numrin e kooperativave shkollore te ne datojnë që nga viti 1957. Në këtë vit janë regjistruar 1.360 kooperativa, me afërsisht 192.000 nxënës, në vitin 1958 - 2.856 kooperativa, kurse në vitin 1959 - 3.645 kooperativa shkollore. Gjatë mbajtjes së rivistave, 1959/60, u vërejt numri më i madh i kooperativave (4.828), të cilat u organizuan në 27,59% të shkollave fillore, kur u arrit kulmi në zhvillimin e deriatëhershëm të të njëjtave. Numri më i madh i nxënësve - kooperativistë u vërejt në vitin shkollor 1960/61 dhe ky numër përfshinte 601.247 nxënës, përkatësisht 18,18% nga numri i përgjithshëm i nxënësve (shih shtojcën nr.17).

Pas vitit 1960 shkaktohet rënia e shpejtë e numrit të kooperativave shkollore dhe dobësimi i kësaj lëvizjeje të rëndësishme të nxënësve. Vetëm për 4 vjet (1960-1964) kooperativat i braktisën 186.320 nxënës, ose 40%<sup>1</sup>. Kjo u shkaktua për arsyen ndryshme, të cilat pak a shumë sollën stagnimin e këtillë të kooperativave. Në mesin e faktorëve më të rëndësishëm ishin këta: nuk u mor qëndrim i qartë dhe vendimtar për domosdoshmérinë e aplikimit të edukimit të obligueshëm dhe konkret punues në moshën e caktuar të nxënësve në shkollën fillore, ekonomia në shumë rajone nuk zhvillohej intensivisht, në mënyrë që të mund t'i drejtohej shkollës dhe vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në formimin e prodhuesve të saj të ardhshëm, dhe lëvizja e fuqishme për reformën e shkollës fillore filloi të bie shpejt, që shprehej me mungesën e arsimtarëve të kualifikuar, shërbimi arsimor-pedagogjik nuk ishte i zhvilluar, nuk kishte kurrfarë shfrytëzimi të mjeteve teknike.

Në RP të Maqedonisë, në tekstin e mëtejshëm (RSM), sipas nomenklaturës së Entit të Statistikës, kanë ekzistuar këto lloje të kooperativave: bujqësore, ku nxënësit merreshin me punë prodhuese nga lëmi i lavërtarisë, kopshtarisë, pemëtarisë etj.; kooperativa të llojit zetar-industrial (disa shkolla posedonin edhe punëtori shkollore, ndaj në këto punëtori zhvillohej edhe puna prodhuese); kooperativa të llojit furnizues-shitës (të llojit të përzier) në të shumtën e rasteve këto ishin sektione; klube, grupe prodhuese që numëronin rrëth 100-200 nxënës<sup>2</sup>.

Roli i kooperativës shkollore në sistemin tonë edukativ të shkollave fillore, pa dyshim është i madh. Me ndihmën e tyre, në radhë të parë, punohej në realizimin e detyrave edukative-arsimore në lëmin e edukimit shoqëror dhe moral, ekonomik dhe punues.

### 5.3. ORGANIZATAT E NXËNËSVE

Organizatat e nxënësve e lidhin shkollën me mjedisin shoqëror. Në këto organizata bëjnë pjesë Lidhja e Pionierëve dhe Lidhja e Rinisë Socialiste, që tubonin pionierët dhe të rinjtë e të gjitha shkollave.

<sup>1</sup> Puna prodhuese dhe kooperativizmi i nxënësve në shkollën fillore, Beograd, 1968;

<sup>2</sup> Libri i analeve "Liria", Shkup, 1944/45 - 1969/70;

Këto organizata, para së gjithash, kishin rol të rëndësishëm që të bashkonin punën e organizatave të specializuara të nxënësve, siç ishin: Lidhja e vëzhguesve, Rinia e Kryqit të Kuq, Malorët e rinj, Teknika popullore, Lidhja feriale etj., dhe punën e seksioneve të aktiviteteve të lira të cilat në shumë shkolla bashkoheshin në shoqata kulturore-artistike, klube etj.<sup>1</sup>.

Lidhja e Pionierëve - si organizatë edukative e fëmijëve e mbështete punën e saj në fitoret e Luftës Antifashiste. Ajo, në tërë punën e saj edukonte anëtarët e saj që mbi të gjitha ta duan atdheun. Lidhja e Pionierëve si organizatë e parë shoqërore tubonte të rinjtë e moshës 7-15 vjeç. Çdo fëmijë pas hyrjes në klasë të parë bëhej anëtar i Lidhjes së Pionierëve. Dita e pranimit të pionierëve në Organizatën e Pionierëve, përherë ka qenë ditë solemne. Më 29 nëntor, Ditën e Republikës, çdo nxënës fitonte simbolet e tij, siç ishin: shamia e pionierit, libreza e anëtarësisë, uniforma e pionierit dhe emblema.

Lidhja e Pionierëve i bashkonte nxënësit në Aradhën e pionierëve, në Bashkësinë klasore të pionierëve dhe në Kolektivin e pionierëve, ku shumë nxënës kishin funksione vetëqeverisëse<sup>2</sup>.

Pionierët i lidh puna e përbashkët dhe interesimi për arritjen e sukseseve sa më të mira në mësim, në aksionet punuese dhe në aksionet e solidaritetit. Pionierët e Maqedonisë manifestuan solidaritet në aksione të ndryshme, si: "10.000 çanta të nxënësve për shokët tanë vietnamezë", solidaritet për nxënësit e pësuar gjatë tërmetit në Shkup (1963) dhe në Dibër (1967), shokëve të Banjallukës (1969). Po ashtu, Organizata e Pionierëve përherë ka qenë e gatshme t'u ndihmojë shokëve të pësuar me rastin e fatkeqësive të komunikacionit me emërtimin "Dinar për shokun tënd" etj. Pionierët, në mënyrë kolektive kanë marrë pjesë edhe në punën prodhuese, në kooperativat e shkollave, në grumbullimin e rrobave, xhamave, letrës. Lidhja e Pionierëve, përvèç organizimit kishte edhe një sërë takimesh nëpër shkolla, në bashkësitë lokale ose në republikë. Po ashtu organizonte edhe shumë takime me qëllim të zgjerimit të diturive për realizimin e barazisë nacionale të kombeve dhe kombësive. Pionierët organizonin takime tradicionale me emërtime të ndryshme si: "Takimet e vëllazërim-bashkimit", "Vendi im dje, sot dhe nesër" etj. Çdo vit në kampin e pionierëve

<sup>1</sup> Shkolla fillore, Struktura e përgjithshme programore me planin mësimor dhe programet, "Flaka e vëllazërimit", Shkup, f.404;

<sup>2</sup> Tufek, Fikret, Lidhja e Rinise Socialiste si faktor për formimin e personalitetit me zhvillim të gjithanshëm, Teoria pedagogjike në realizimin e detyrave të Kongresit të Lidhjes së Komunistëve, Sarajevo, 1977, f.47;

“Sutjeska” marrin pjesë nga 10 nxënës të kombeve e kombësive të ndryshme nga çdo republikë dhe krahinë.

Detyrat programore të pionierëve realizohen me ndihmën e Lidhjes së organizatave për edukim dhe kujdes socialist për fëmijët e RS të Maqedonisë.

LIDHJA E VËZHGUVE - është organizatë shoqërore-ekonome e cila me programin e saj ndikon në zhvillimin e gjithanshëm të anëtarëve të saj. Lidhja e Vëzhguesve tubon fëmijët e moshës 10-15 vjeç, e cila me aradhat e saj realizon programin në rrëthin ku jeton. Po ashtu edhe fëmijët e moshës 6-10 vjeçare mund të jenë anëtarë të Lidhjes së Vëzhguesve me emrin “Malorët”. Lidhja e Vëzhguesve ka simbolin e saj, flamurin dhe uniformën.

Në shkollën fillore, Lidhja e Vëzhguesve kultivon dhe zhvillon traditën popullore çlirimtare dhe të revolucionit socialist. Zhvillon vëllazërim-bashkimin ndërmjet kombeve e kombësive, zhvillon veçoritë pozitive si dashurinë, vendosmërinë, trimërinë, gjeturinë etj.<sup>1</sup>.

Pas pranimit në Lidhjen e Vëzhguesve, nxënësit japid betimin se si malorë punën e tyre do ta kryejnë me ndërgjegje, sipas statutit të Lidhjes së Vëzhguesve të Maqedonisë.

#### 5.4. BASHKËSIA SHKOLLORE DHE KLASORE E NXËNËSVE

Ideja e vetëqeverisjes së nxënësve në shkollat tona gjeti vendin adekuat në Ligjin e përgjithshëm për shkollimin. Me këtë ligj, pozita e nxënësve në shkolla ndryshoi dukshëm. Në nenin 127 të Ligjit të përgjithshëm për shkollimin, ndër të tjera thuhet: “Në qeverisjen me shkollat marrin pjesë edhe nxënësit e moshës përkatëse përmes përfaqësuesve të tyre”. Me këtë, për herë të parë u përligj ideja që gjatë vendosjes për jetën dhe punën në shkollë, të marrin pjesë edhe nxënësit.

Bashkësitë shkollore formoheshin në kuadër të shkollës, kurse ato klasore në kuadër të disa klasave. Në shkollën fillore formohen bashkësi të nxënësve të klasave VII dhe VIII.

Përbajtja e punës së tyre, në mënyrë të përgjithësuar është parashtruar në Ligjin e përgjithshëm për shkollimin në nenin 101, ku thuhet: “Me qëllim të zhvillimit të iniciativës, pavarësisë, disiplinës së

<sup>1</sup> Po aty, f.410;

ndërgjegjshme dhe përgjegjësisë së nxënësve për punën dhe suksesin e tyre në shkollë, si dhe për ndihmën aktive arsimtarëve në realizimin e edukimit dhe mësimit, nxënësit e viteve të fundit të shkollës filllore, si dhe nxënësit e shkollave profesionale dhe gjimnazeve, formojnë bashkësitë e nxënësve të klasës, përkatësisht të shkollës”.

Bashkësitë e nxënësve tashmë kishin kaluar fazën e organizimit dhe sot për to mund të thuhet se në shumë shkolla janë bërë faktor i rëndësishëm në ofrimin e ndihmës organeve të qeverisjes shoqërore. Me fitimin gjithnjë e më të madh të përvojave, bashkësia e nxënësve do të bëhet faktor edhe më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në zgjidhjen e çështjeve nga lëmi i qeverisjes me shkollën.

## 5.5. MBLEDHJET PRINDËRORE

Prindërit e nxënësve marrin pjesë në qeverisjen me shkollën përmes përfaqësuesve të tyre në këshillat shkollore, në këshillat e arsimit etj. Edhe përkundër kësaj, bashkëpunimi i shkollës me prindërit përmes mbledhjeve prindërore, ka qenë i domosdoshëm. Faktorët që qeverisin me shkollën do të mund t'i kryejnë me sukses detyrat e tyre vetëm në ato raste nëse për realizimin e tyre mobilizohen një rreth i gjerë njerëzish, në radhë të parë prindërit e nxënësve. Tendencat e zhvillimit të vetëqeverisjes shoqërore janë të orientuara në tërheqjen e një rrethi të gjerë të njerëzve, të interesuar drejtpërdrejt për qeverisjen me një lëmë të caktuar të veprimtarisë.

Një numër i madh çështjesh, që ndodhen në fushëveprimin e punës së këshillit shkollor, këshillit të arsimtarëve, këshillit të klasës, si dhe të organeve tjera shkollore, nuk mund të zgjidhen me sukses pa ndihmën e prindërve të nxënësve. Realizimi i detyrave edukative-arsimore nuk mund të zbatohet plotësisht pa bashkëpunimin e ngushtë të shkollës me prindërit. Problemet materiale janë zgjidhur dhe në të ardhmen do të mund të zgjidhen me ndihmën dhe bashkëpunimin sistematik të shkollës dhe prindërve. Shumë prindër kanë qenë çdoherë të gatshëm që të angazhohen dhe të marrin pjesë në ndihmë shkollës. Praktika ka treguar se nga ana e prindërve shpesh mund të dëgjohen ide mjaft të mira për zbatimin dhe realizimin e detyrave të përditshme nga fushëveprimi i punës së organeve qeverisëse me shkollën. Për këtë arsy, organet e qeverisjes së drejtpërdrejtë me shkollën, doemos

duhet të jenë në kontakt të përherershëm me prindërit e nxënësve dhe me mjedisin shoqëror në përgjithësi.

## 5.6. ROLI I SINDIKATËS NË PUNËN E SHKOLLËS

Qeverisja punëtore me ndërmarrjet ekonomike, si dhe vetëqeverisja shoqërore në lëmenjtë tjerë, kanë shkaktuar atë që pozita e njerëzve në prodhim dhe në marrëdhëni punuese të ndryshojë rrënjësisht. Punëtorët qeverisnin me mjetet për prodhim dhe me prodhimin e çdo pune. Me këtë, ka ndryshuar prej themeli edhe roli i sindikatave tona. Detyra e tyre, në esencë, dallohet nga detyrat e sindikatave në shoqërinë klasore, ku në prodhim dominojnë raportet e mbështetura në punën me mëditje dhe ku mjetet për prodhim dhe teprica e punës janë në duart e punëdhënësve. Në shoqërinë socialiste, detyrat që qëndrojnë para organizatave sindikale janë krejtësisht të tjera. Kjo po ashtu ka të bëjë edhe me rolin dhe rëndësinë e sindikatave të punëtorëve arsimorë. Sindikata e punëtorëve arsimorë nuk është organ që qeveris dhe vendos, por organizatë që orienton, ndikon, ndihmon dhe që lufton për ligjshmërinë socialiste në lëmin e punës dhe në qeverisjen me shkollën.

Në mesin e detyrave të tjera, Sindikata e punëtorëve arsimorë i ka edhe këto:

- punon në ngritjen ideologjike-politike, pedagogjike dhe profesionale të anëtarëve të saj;
- orienton punën e organeve të qeverisjes shoqërore me shkollën;
- nxit iniciativën dhe u ndihmon arsimtarëve në zgjidhjen e disa detyrave;
- ndihmon zhvillimin e mëtejshëm dhe përsosjen e qeverisjes shoqërore në shkolla;
- shqyrton punën dhe nxjerr në dritë lëshimet e këtyre organeve;
- lufton për shpërblimin e drejtë të anëtarëve të saj - për shpërblimin sipas punës;
- kujdeset për marrëdhënie të drejta ndërmjet anëtarëve të kolektivave arsimore;
- insiston që dispozitat ligjore të zbatohen me konsekuençë;
- mbron interesat shoqërore si dhe të drejtën e individëve;

- kujdeset që të ruhet liria e çdo punëtori të shkollës (liria personale) dhe e drejta e tij për kritikë të arsyeshme dhe konstruktive kundër dukurive negative në shkollë;

- lufton kundër të gjitha tendecave burokratike të cilat akoma manifestohen në lëmin e qeverisjes në shkollë;

- shqyrton të gjitha çështjet tjera ngajeta dhe puna e shkollës.

Këto, si dhe shumë detyra të tjera që qëndrojnë para organizatave sindikale të punëtorëve arsimorë, flasin për gjerësinë e domethënies së fushëveprimit të tyre të punës në kushtet e reja të qeverisjes me shkollën. Sindikata ka mbetur edhe më tutje faktor i rëndësishëm në luftën për realizimin e ligjshmërive socialiste dhe raporteve socialiste në shkollë. Roli dhe rëndësia e saj kanë fituar dimensione të reja.

Dukuritë e nënçmimeve, lënies pasdore dhe degradimit të rëndësisë së shkollës nga ana e individëve si dhe disa organeve shtetërore, bartësit e të cilave janë të ngarkuar me botëkuptime burokratike e të ngjashme, nuk guxojnë të nënçmohen. Sindikata është këtu edhe për arsyen që me këto tendenza të ballafaqohet publikisht dhe ashpër. Është fakt se në lëmin e shkollimit, financimit të tij, vlerësimit të rëndësisë dhe peshës së tij, shpërbllimit të punëtorëve arsimorë etj., ka pasur, e ka edhe sot, shumë sish konservative, gjë që në asnjë rast nuk janë pa pasoja negative në zhvillimin e shkollës. Me aplikimin e mënyrës së re të financimit të shkollës, para Sindikatës së punëtorëve arsimorë janë parashtruar detyra të reja. Judikatura jonë shkollore dhe shumë paragrafe në të, shpeshherë janë vënë mbi baza alternative. Si shembull mund të shërbejnë: çështja e orëve me honorar, çështja e mënyrës së ndarjes së mjeteve finanziare, numri i nxënësve në klasë, dhënia e kompensimit punëtorëve arsimorë në naturë etj. Pothuaj është dukuri e rregullt që nëpër komuna (për arsyen objektive, e shpesh edhe subjektive) paragrafet alternative në judikaturën shkollore interpretohen në dëm të punëtorëve arsimorë. Sindikatat e punëtorëve arsimorë, në radhë të parë duhet të angazhohen që rregullat që kanë të bëjnë me shkollimin të jenë më precise, e mandej të njëjtat të zbatohen me konsekuençë.

Por, nuk guxohet të kuptohet se detyra e sindikatës është vetëm lufta kundër dukurive të huaja për socializmin. Kjo është vetëm një, gjithsesi, lëmë mjaft e rëndësishme e punës së tyre, por as prej së largu nuk është e vetme. Organet e qeverisjes së drejtpërdrejtë shoqërore me shkollën, nuk mund të veprojnë me sukses nëse nuk mobilizohen dhe nëse nuk i bashkojnë forcat shoqërore të interesuara për

problemet e shkollës. Në gjithë këtë, Sindikata e punëtorëve arsimorë ka rëndësi të posaçme.



# IV

---

## 1. KUADRI ARSIMOR

Sigurimi i kuadrit arsimor, pas çlirimit të vendit tonë, ishte një nga problemet parësore të pushtetit tonë popullor. Kuadri arsimor-ekdukues në fillim paraqiste “çelës” për hapjen dhe perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të shkollës shqipe në RS të Maqedonisë. Për t'u zgjidhur çështja e kuadrit arsimor ishte vështirë, ngase për 20 vjet të ekzistimit të Jugosllavisë së vjetër nuk ka qenë në gjendje ta sigurojë kuadrin as për shkollat filllore, e të mos flasim për shkollat tjera. Për shkak të kuadrit arsimor, shumë shkolla, edhe pse ishin paraparë të punojnë, mbeteshin të mbyllura.

Prej 31.791 mësuesve, sa ishin në Jugosllavinë e vjetër, prej vitit 1940/41 deri në vitin 1945/46 mbetën vetëm 23.567<sup>1</sup>.

Në RS të Maqedonisë pas luftës filluan punën 330 mësues në gjuhën maqedonase, 70 në gjuhën shqipe dhe 30 në gjuhën turke<sup>2</sup>. Nga 70 mësues shqiptarë, 7 sish kishin të kryer kursin njëvjeçar në Prishtinë, 15 shkollën normale, po ashtu të kryer në Prishtinë, 15 me shkollë të kryer normale në Shqipëri, kurse 33 me shkolla tjera të ndryshme, e më së shumti kishte mësues me medrese të kryer<sup>3</sup>.

Nevojat e mëdha për kuadër arsimor kërkonin edhe përpjekje të mëdha, ndaj Ministria e Arsimit, edhe me kapacitetet ekzistuese gjente zgjidhje për punë në shkollën filllore, të cilët mbase kanë qenë të pakualifikuar, por kjo ka qenë gjëja e vetme e mundshme. Në shkollat e fshatit me nga dy klasë, ku numri i nxënësve nuk kalonte numrin 100,

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD., Arsimiti i kuadrit arsimor për shkollat filllore, kut.8;

<sup>2</sup> Shtatëdhjetë mësues në gjuhën shqipe nuk kishin të kryer shkollën normale. Në këtë numër hynin edhe të tjere që kryenin këtë profesion, e madje edhe ata që dinin të lexojnë dhe shkruan;

<sup>3</sup> Libri i analeve “25 vjet veprimtarie e Gjimnazit ‘Zef Lush Marku’”, Shkup, 1975, f.10;

emërohej vetëm një mësues. Në vendbanimet më të mëdha të qytetit dhe fshatrave shkollat fillore punonin në dy ndërrime, por që numri i orëve i paraparë me planprogramet mësimore, zvogëlohej.

Në vitin e ardhshëm shkollor 1945/46, numri i kuadrit arsimor arriti në 264. Ministria e Arsimit, përmes këshillave popullore i angazhonte të gjithë ata që dinin të lexojnë dhe shkruajnë. Ndodhte që në këtë vit shkollor një numër njerëzish i caktuar të merrnin nga Ministria dekretin, me të cilin papritmas emëroheshin mësues<sup>1</sup>. Çdo vjet, nga të gjitha anët e Maqedonisë arrinin kërkesa që t'u dërgohen mësues. Ministria bënte ndarjen e kuadrit ekzistues, duke i dërguar në vendet ku kërkonin më shumë mësues, e sidomos në ato vende ku nxënësit ishin të shumtë. Këto ishin vendet qendrore në të cilat gravitonin fshatrat fqinje. Ndarja e këtillë e arsimtarëve solli edhe vështirësi të caktuara, ngase shumë mësues që ishin caktuar në fshatra të ndryshme, hiqnin dorë nga vendet e punës dhe kërkonin punë tjera administrative<sup>2</sup>.

Mungesa e mësuesve me vite të tëra paraqiste pengesë për hapjen e shkollave të reja, sidomos nëpër fshatra edhe pse Ministria e Arsimit e RPM-së, të gjithë mësuesve dhe anëtarëve të familjeve të tyre u jepte privilegje sa i përket furnizimit me artikuj ushqimorë dhe me nevojat tjera në amvisëri, duke filluar nga kripa e deri te shkrepësat dhe po ashtu edhe deri te karta industriale për nevoja të jashtëzakonshme (Karta VI)<sup>3</sup>.

Pas përfundimit të shtatëvjeçares dhe dhënies së provimit të “maturës së vogël”, angazhoheshin për punë nëpër shkolla shumë nxënës nga kjo gjeneratë e parë. Prej vitit 1952, për shkak të pozitës gjithnjë e më të mirë materiale të mësuesve, për këtë thirrje paraqitet numër i madh kandidatësh, ndaj kështu u bë edhe seleksionimi i kandidatëve. Përparësi kishin ata kandidatë që kishin vesh për muzikë dhe këndim.

<sup>1</sup> Në këtë mënyrë, për mësues u emëruan Qenan Doko me shkresë nr.74 të dt.27.X.1945, Bajram Bajrami, Daut Ballazhi etj.;

<sup>2</sup> Meqë ndarja e arsimtarëve është bërë sipas mënyrës centraliste nga Ministria e Arsimit, shumë mësues hoqën dorë nga vendet e tyre të punës dhe u punësuan në administratë;

<sup>3</sup> AM - Shkup, FD., Vendim për mënyrën e sigurimit të mësuesve dhe arsimtarëve të shkollave fillore në fshatra (Gazeta zyrtare e RFPJ, nr.22, 1949);

## *1.1. BURIMET E KUADRIT ARSIMOR*

Që të kënaqeshin nevojat e shkollimit fillor shqiptar me kuadër arsimor, Këshilli i Arsimit i RP të Maqedonisë aplikonte kryesisht sistemin e kurseve. Kjo ishte mënyrë që shumë individë të aftësohen për profesionin e mësuesit. Në fillim të vitit 1945 filluan të hapen kurset 15-ditëshe për ata që nuk kishin kryer ndonjë shkollë të mesme. Pas kryerjes së kurseve të këtilla, kandidatët dërgoheshin në vende ku nuk kishte mësues. Në fund të çdo viti shkollor këta kandidatë shkonin për t'u aftësuar edhe më tej nëpër kurse tremujore. Procesi arsimor në këto kurse zhvillohej sipas një planprogrami të posaçëm, që realizohej gjatë kësaj periudhe tremujore.

Kurset pedagogjike për aftësimin e personelit arsimor për shkollën fillore shqipe, filluan të mbahen në verën e vitit 1945 dhe vazhduan deri në vitin 1953. Që atëherë kurset e këtilla filluan të organizohen në formë tjeter. Në këto kurse pedagogjike vinin nga vise të ndryshme të Maqedonisë, edhe atë frekuentues të moshave të ndryshme (të vjetër e të rinj) që kishin interesim për emancipimin e kombësisë shqiptare në Maqedoni. Kandidatët që kryenin këto kurse në fund i jepnin edhe provimet përfundimtare dhe merrnin diplomën përmësues.

Ministria e Arsimit e RPM-së, me Vendimin nr.5804 të datës 4.XI.1946, organizoi kursin njëvjeçar pedagogjik. Në këtë kurs njëvjeçar kandidatët kishin të kryer klasën V, VI ose VIII, dhe pas përfundimit të kursit merrnin kualifikimin përmësues të rregullt, kurse këtë kurs njëvjeçar e vijonin edhe dëgjuesit me klasë të kryer të IV ose V të shkollës fillore dhe ishin të obliguar të vijojnë edhe dy kurse tremujore në vitet e ardhshme, në mënyrë që kështu të fitonin kualifikimin përmësues<sup>1</sup>.

Nga radhët e kombësisë shqiptare nuk kishte numër të mjaftueshëm kandidatësh që e kishin kryer klasën IV-VIII në këto kurse, ndaj pranoheshin edhe kandidatë që kishin kryer vetëm katër klasë, për çka kombet dhe kombësitë tjera në Maqedoni nuk kishin të drejtë. Në vitin e ardhshëm 1947 nuk u organizua kurs i tillë për arsy se kishin numër të madh të kandidatëve që kishin të kryer vetëm katër klasë. Ky kurs u hap sërisht atëherë kur këta kandidatë kryen kursin

<sup>1</sup> Meqë nuk kishte kandidatë të mjaftueshëm me arsimim të nevojshëm në shkollat fillore shqipe, përparrësi kishin ata kandidatë të cilët për shkak të luftës nuk kishin pasur mundësi për shkollim të mëtejshëm;

tremujor. Kursi njëvjeçar filloi prej 10.XI.1946 deri më 10.VII.1947. Mësimi dëgjohej sipas planprogramit të caktuar mësimor.

Ky kurs njëvjeçar u organizua pranë Shkollës Normale "Nikolla Karev" në Shkup. Në këtë kurs u paraqitën 36 kandidatë, nga të cilët diplomuan 28 veta.

Duke iu falënderuar masave të shpejta për aftësimin e kuadrit arsimor, në shkollat fillore shqipe filloi të rritet numri i nxënësve, kështu që deri në vitin 1947 numri i nxënësve u rrit për katër herë. Deri në vitin e përmendur shkollor, në kurset pedagogjike që mbaheshin gjatë pushimeve verore, u aftësuan 80 mësues të rinj.

Përveç mësuesve të aftësuar përmes kurseve, nga Shqipëria fqinje erdhën 30 mësues, si ndihmë kadrorike, dhe ata u caktuan nëpër shkollat fillore shqipe<sup>1</sup>.

Prej vitit 1953 nga kurset pedagogjike kalohet në seminare pedagogjike. Seminaret pedagogjike punonin pranë Shkollës Normale të Shkupit. Seminaret pedagogjike përfunduan punën në vitin 1961 dhe mund të thuhet lirisht se për etapën e dytë të zhvillimit të shkollës filllore shqipe, punonin me sukses ngase ishin aftësuar kandidatë sipas planprogrameve arsimore për shkollat normale.

Numri i kandidatëve në kurset dhe seminaret pedagogjike sipas viteve është si vijon:

---

<sup>1</sup> Shkollat e reja të pakicave kombëtare në Maqedoni - "Pedago{ki rad", 7, Zagreb, 1947, f.439;

Viti shk.	Shkëlpq.	Shumë mirë	Mirë	Gjithsej
1944/45	1	4	7	12
1945/46	6	16	25	47
1946/47	-	12	16	28
1949/50	-	9	27	36
1950/51	1	14	14	29
1951/52	4	8	10	22
1952/53	2	5	7	14
1953/54	3	16	48	67
1954/55	5	38	27	70
1955/56	7	35	33	75
1956/57	-	6	9	15
1958/59	5	12	38	5
1959/60	1	13	6	20
1960/61	-	4	18	22
1961/62	-	1	8	9
Gjithsej	35,7%	193,37%	295,56%	523

Tabela nr.18 - Numri i kandidatëve në kurset dhe seminaret pedagogjike

Numri 523 flet se në këto kurse dhe seminare pedagogjike u aftësuan shumë arsimtarë, të cilët u punësuan në vise të ndryshme të Maqedonisë.

## 1.2. HAPJA E SHKOLLËS SË PARË NORMALE SHQIPE

Me transformimin e marrëdhënieve shoqërore në vendin tonë, filluan të ndryshojnë edhe kushtet e punës në shkollë dhe arsim.

Me Kushtetutën e RPM-së të vitit 1946, kombësisë shqiptare iu garantua e drejta për fitimin e arsimimit dhe përgatitjes profesionale në gjuhën e vet amtare.

Në fillim kurset dhe seminaret pedagogjike vareshin me të madhe nga koha e cila kërkonte që sa më shpejtë të plotësohen nevojat për kuadër arsimor. Bashkësia jonë kërkonte që ky kuadër të arsimohet sa më mirë dhe të fitojë përgatitje sa më solide, e cila do t'i përgjigjet dinamikës së kohës. Edhe pse gjendja numerike e kuadrit arsimor ka qenë deri diku e kënaqshme, nevojat e mëdha për këtë ndiheshin akoma në shkollat fillore në gjuhën shqipe, ngase çdo vit në këto shkolla përfshiheshin edhe një numër i madh i të rriturve.

Duke i kushtuar rëndësi arsimimit dhe edukimit të njeriut të ri në vendin tonë, Ministria e Arsimit e RP të Maqedonisë kujdesej

vazhdimesht që për kuadrin arsimor të aftësohen mësues me përgatitje solide pedagogjike, të cilët nesër do të jenë bartës të emancipimit dhe progresit në përgjithësi.

Në vitin shkollor 1947/48, pranë Shkollës Normale maqedonase "Nikolla Karev" në Shkup, u formua paralelja e parë e kësaj shkolle me mësim në gjuhën shqipe, dhe kjo më vonë shërbeu si nukleus për hapjen e shkollave të para normale në gjuhën shqipe.



Foto 3 - Gjenerata e parë e mësuesve

Në vitin e parë të hapjes së paraleles së parë në gjuhën shqipe u paraqitën shumë nxënës nga vise të ndryshme të Maqedonisë, por disa pas një javë e braktisnin shkollimin dhe mbetën vetëm 20 nxënës, nga të cilët diplomuan 18, edhe pse Ministria kujdesej që të gjithë nxënësit të vendoseshin në konvikte dhe të kishin kushte të mira për punë. Vitin e ardhshëm, 1948/49, pranë kësaj shkolle hapet edhe paralelja e dytë, kurse në vitin 1949/50 edhe klasa e tretë. Pas tre vjet shkollimi doli gjenerata e parë prej 64 mësuesish, nga të cilët 4 ishin femra.

Në këto klasë, mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, përveç disa lëndëve për të cilat nuk kishte mundësi të sigurohet arsimtari i kom-bësisë shqiptare, si për shembull, për: gjuhë ruse, gjuhë maqedonase, edukatë fizike, edukatë arti etj.<sup>1</sup>.

Arsimtarët që jepnин mësim në gjuhën shqipe, përveç lëndëve të tyre profesionale, ligjëronin edhe lëndë të tjera<sup>2</sup>. Libra dhe literaturë

<sup>1</sup> Libri i analave "25 vjet..." op.cit.f.14;

<sup>2</sup> Profesori i njojur, dr.Petro Janura, përveç gjuhës shqipe jepte edhe biologji, zoologji dhe botanikë, Josif Todi, Të gjitha lëndët pedagogjike dhe psikologjike;

tjetër nuk kishte, e duke iu falënderuar profesorëve që dinin gjuhë të huaja, përgatiteshin ligjérata të cilat u diktoheshin nxënësve.

Ndryshimet e mëtejshme në të gjitha veprimtaritë shoqërore kërkonin që në shkollat tetëvjeçare të përfshiheshin numër sa më i madh nxënësish. Çdo vit ky numër i nxënësve rritej e me këtë edhe nevoja për numër më të madh të kuadrit arsimor, ndaj Ministria e Arsimit e RP të Maqedonisë (me vendimin nr.4433 të datës 18.II.1950) vendosi që të hapet Shkolla Normale Shqipe në qytetin e Tetovës<sup>1</sup>.

Mësimi në këtë (shkollë të mesme) normale shqipe filloi më 2.X.1950 me 3 klasë: klasa I me 50 nxënës, klasa II me 20 nxënës dhe klasa III me 15 nxënës<sup>2</sup>, e më vonë edhe klasa IV me gjithsej 103 nxënës, nga të cilët 7 (shtatë) ishin nxënëse. Kuadrin arsimor e përbën 6 arsimtarë që ligjëronin nga 2-3 lëndë<sup>3</sup>.

Hapja e shkollës së parë normale shqipe për kombësinë shqiptare në RS të Maqedonisë paraqiste një epokë të re në jetën e shqiptarëve jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjërë.

Më 26.III.1952, për shkaqe objektive kjo shkollë normale u transferua nga Tetova në kryeqytetin e Maqedonisë, në Shkup. Në vitin 1960 kjo shkollë u pagëzua me emrin "Zef Lush Marku"<sup>4</sup>.

Kjo shkollë normale vazhdoi aktivitetin e saj deri në vitin 1971/72, kur me ligj u shuan të gjitha shkollat normale në Maqedoni.

Kjo qendër e rëndësishme edukative-arsimore për përgatitjen e kuadrit arsimor, i mbulonte të gjitha shkollat fillore shqipe në territorin e Maqedonisë. Nga kjo dolën gjenerata e gjenerata nxënësish. Dhe jo vetëm që kjo shkollë siguroi kuadër arsimor, por aftësoi edhe profile të tjera, si punëtorë administrativë, gazetarë, shitës dhe punëtorë shoqërorë-politikë.

Edhe përkundër faktit që dilnin gjenerata nga shkolla normale si dhe seminaristë (deri në vitin 1962), numri i nxënësve është akoma i madh. Në shkollat me mësim në gjuhën shqipe - një arsimtar punon me 50-60 nxënës në klasë.

Rrjeti i shkollave fillore zgjerohej gjithnjë e më tepër. Shumë shkolla fillore katervjeçare shndërrroheshin në shkolla të plota

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD., Shkresë drejtuar komunave të Ohrit, Gostivarit, Manastirit, për agitim për regjistrim në Shkollën normale të Tetovës, kut. 77;

<sup>2</sup> Libri i analave "25 vjet..." op.cit.f.12;

<sup>3</sup> Drejtor i parë ishte Rexhep Bajrami dhe mësuesit: Petar Kavaja, Sami Lamçe, Shazio Hoxha, Rahman Besimi, Josif Todi dhe Sadudin Gjura;

<sup>4</sup> KR për arsim, kulturë dhe shkencë, Shkup, Realizimi i barazisë së kombësive përmes rrjetit të arsimimit - institucionet arsimore, Shkup, 1969, f.24;

tetëvjeçare, kurse mësuesit që kishin kryer shkollën normale jepnin mësim edhe në klasat e larta, prej klasës V-VIII. Numri i mësuesve që ishte në disponim, ata që kishin kryer mësimin klasor ose lëndor, nuk ishte i mjaftueshëm t'i plotësojë të gjitha nevojat për kuadër arsimor. Sekretariati Republikan i Arsimit bëri përpjekje që pranë gjimnazeve të hapen edhe paralele të veçanta për përgatitjen e kuadrit të mësuesisë.

Për këtë qëllim, në vitin shkollor 1958/59 pranë Gjimnazit të Tetovës formohet paralele e veçantë, më 1961/62 në Kumanovë dhe po të njëtin vit në Gostivar<sup>1</sup>.

Që të stimuloheshin nxënësit e kombësisë shqiptare, bashkësia jonë u jepte bursa atyre që dëshironin të arsimohen. Çdo komunë (më herët Fondi Republikan për Bursa), përvèç stipendimit të studentëve, në shkollat e larta dhe sipërore, stipendon edhe nxënës në shkollat normale. Në vitin shkollor 1959/60, 311 shqiptarë fituan këtë bursë, më 1961/62 - 483, më 1962/63 - 391 bursistë<sup>2</sup>. Një gjë e tillë në përgjithësi solli rezultate pozitive, e veçanërisht edhe për atë se disa vajza u përcaktuan për vazhdimin e arsimimit në shkollat normale. Se vajzat shqiptare nga viti në vit shprehnin dëshirë për t'u bërë mësuese, na dëshmon edhe tabela vijuese:

Lloji i shk.	1959/60		1960/61		1961/62		1962/63	
	Gjiths.	Femra	Gjiths.	Femra	Gjiths.	Femra	Gjiths.	Femra
Shk.për kuad.ars.	143	56	533	67	610	83	667	106
Gjimnaze	106	15	249	17	406	48	605	82

Tabela nr. 19 - Interesimi i vajzave për shkollim

Nga pasqyra e mëlartme mund të konkludojmë se më shumë nxënës të kombësisë shqiptare orientohen në profesionin e mësuesit se sa nëpër gjimnaze. Nxënësit që e përfundonin shkollën normale gjenin punë menjëherë, ndërsa ata të gjimnazit jo.

Me hapjen e paraleleve për mësues pranë gjimnazeve dhe vetë Shkolla normale në Shkup, u mundësua që çdo shkollë fillore shqipe, thënë më saktë, çdo klasë të ketë mësuesin e vet, pa grumbullimin e nxënësve nëpër klasa.

<sup>1</sup> KR për arsim, kulturë dhe shkencë, Zhvillimi i arsimimit, edukimit dhe veprimtarive kulturore në rajonet ku jetojnë kombësítë dhe grupet etnike, Shkup, dhjetor 1973, f.7;

<sup>2</sup> Ibid.f.25;

Shkolla Normale "Zef Lush Marku" në Shkup dhe paralelet përmësues pranë gjimnazeve, dhanë rezultate të konsiderueshme në përgatitjen e kuadrit arsimor. Që nga fillimi i themelimit e deri në vitin 1967/68 shkollën e mbaruan 1341 nxënës, kurse në kurse dhe seminare arritën të mbarojnë 506, ose gjithsej 1.926 kandidate<sup>1</sup>.

Nga numri i përgjithshëm i kuadrit arsimor të kombësisë shqiptare, deri në vitin shkollor 1972/73 në marrëdhënie pune kanë qenë 79,7% arsimtarë me arsimim të plotë, kurse deri në vitin 1974/75 numri i arsimtarëve me arsimim të plotë zvogëlohet, meqë disa shkojnë në pension ose në punë të tjera, kurse interesimi për këtë profesion zbehet.

### **1.3. AKADEMIA PEDAGOGJIKE DHE KATEDRA E GJUHËS SHOIPE**

Paralelisht me zhvillimin e shkollave fillore dhe të mesme filluan të zhvillohen edhe shkollat e larta dhe fakultetet në RS të Maqedonisë. Roli i shkollës normale dhe i paraleleve për mësues pranë gjimnazeve, në formimin e kuadrit arsimor në shkollën fillore dhe për mësimin klasor, ka qenë tejet i madh. Organet arsimore që në vitin 1946 kishin paraparë se në shtatëvjeçaret dhe tetëvjeçaret përgatitet kuadri arsimor për shkollat e larta dhe fakultetet. Në vitin e përmendur, në Shkup u organizua kursi njëvjeçar për arsimimin e arsimtarëve për klasat e larta të shkollës fillore. Ky kurs nuk mund të siguronte tërë përgatitjen pedagogjike të nevojshme, edhe pse nxënësit që vijonin kursin kishin arsimim të mesëm. Në vitin shkollor, më 17 shtator 1947, pushteti popullor i Maqedonisë miraton Rregulloren për themelimin e Akademisë Pedagogjike “Kliment Ohridski” në Shkup për përgatitjen e kuadrore për “klasa të ulëta dhe të larta të shkollave fillore”<sup>2</sup>.

Në periudhën 1947-1953 në katër grupet e para mësimore, në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën maqedonase, kishte edhe studentë të kombësisë shqiptare. Në nëntor të vitit 1953, pranë kësaj shkolle të lartë hapet edhe grupei mësimor në gjuhën shqipe. Në vitin e parë ligjëratat i dëgjonin 11 studentë të rregullt dhe 10 me korrespondencë. Më vonë, në këtë grup studionin studentë nga vise të ndryshme të

<sup>1</sup> Ibid. f.29;

<sup>2</sup> Akademja Pedagogjike "Kliment Ohridski", Shkup, 1947-1972;

Maqedonisë, Kosovës dhe Serbisë Jugore. Studentë të diplomuar në këtë grup mësimor deri në vitin 1959 kishte relativisht pak dhe numri i të diplomuarve sillej kështu:

VITI	NUMRI I NXËNËSVE		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1955	13	2	15
1956	4	-	4
1957	15	2	17
1958	13	-	13
1959	16	4	20

Tabela nr. 20 - Studentë të diplomuar në Akademinë Pedagogjike

Me formimin e grupit të parë pranë Akademisë Pedagogjike u hapet rruga edhe grupeve tjera mësimore. Kështu, në vitin shkollor 1965/66 u hapën grupet e Historisë-Gjeografisë, Biologji-Kimisë, Matematikës-Fizikës. Në vitin shkollor 1969/70 u formua grupi për mësim klasor<sup>1</sup>. Në Akademinë Pedagogjike të Shkupit vetëm në vitet shkollore 1969/70, 1970/71 dhe 1971/72 në të gjitha grupet diplomuan 213 studentë<sup>2</sup>. Në kuadër të 30-vjetorit të ekzistimit të Akademisë Pedagogjike, strukturën nationale e përbëjnë: 51% maqedonas, 33% shqiptarë, 11% serbë dhe 2% turq<sup>3</sup>. Në të gjitha profilet nga radhët e kombësisë shqiptare diplomuan 583 studentë<sup>4</sup>.

Akademia Pedagogjike është institucioni kryesor që ndihmoi që struktura arsimore për nevojat e shkollës fillore shqipe të përmirësohet kualitativisht. Situata deri në vitin shkollor 1974/75, sipas përqindjes duket kështu: 6% prej klasës I-IV me arsimim të lartë, përkatësisht me grupin e kryer të mësimit klasor, 90% me shkollë normale, 3% me shkollë të mesme dhe 1% pa arsimim të mesëm.

Në klasët e larta, prej klasës V-VIII, situata ka qenë: 50% me arsimim të lartë, 1% me arsimim sipëror, 70% me arsimim të mesëm

<sup>1</sup> Të dhënat janë nxjerrë nga libri - 25 vjet të Akademisë Pedagogjike "Kliment Ohridski", Shkup, 1972;

<sup>2</sup> Disa karakteristika të zhvillimit të pasluftës në RS të Maqedonisë, Shkup, 1974, f.46;

<sup>3</sup> Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e saj, Shkup, 1977, f.43;

<sup>4</sup> Ibid.f.43-44;

profesional, 4% me arsimim të mesëm dhe 0,20% pa arsimim të mesëm<sup>1</sup>.

Kur u kremtua përvjetori i parë i shpalljes së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, më 29.IX.1946, me vendimin e Qeverisë së RP të Maqedonisë u themelua Universiteti "Kirili e Metodij" në Shkup. Në kuadër të universitetit filloi punën Fakulteti Filozofik dhe të gjitha institucionet tjera të arsimit sipëror në Maqedoni. Në të gjitha institucionet e arsimit sipëror, thënë më mirë në të gjitha grupet studimore, studionin edhe studentë të kombësisë shqiptare. Mënyra e studimit në këto grupe mësimore-shkencore mundësonë që disa studentë të punojnë edhe si arsimtarë nëpër shkollat fillore.

Në kuadër të Fakultetit Filologjik, në vitin shkollor 1971/72 u formua Grupi për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe<sup>2</sup>. Në këtë grup studionin studentë të rregullt dhe me korrespondencë. Në vitin shkollor 1974/75 diplomoi gjenerata e parë e studentëve prej 10 studentësh të rregullt dhe 2 me korrespondencë. Disa nga këta studentë gjatë studimeve punonin edhe në shkollat fillore.

Studentët e kombësisë shqiptare, që kishin të kryer cilindro grup studimor në universitetet e Jugosllavisë, punësoheshin edhe në shkollat fillore. Kështu, në vitin shkollor 1972/73 në klasat e larta të shkollës fillore punonin 11 profesorë, edhe atë: në Kumanovë 3, Shkup 4, Gostivar 1, Kërçovë 1, Ohër 1 dhe në Resnjë 1<sup>3</sup>. Në kuadër të arsimit sipëror më shumë ishin përfaqësuar lëndët: gjuha shqipe, historia, gjeografia, biologjia. Numri i arsimtarëve me arsimim sipëror rritet vazhdimesht. Në vitin shkollor 1974/75 në shkollat fillore punojnë 19 profesorë. Më shumë ka pasur në komunën e Tetovës dhe të Dibrës<sup>4</sup>.

Me zhvillimin e arsimit fillor, me përmirësimin e bazës materiale, me përfshirjen më të madhe të obliguesve shkollorë, zgjerohet edhe rrjeti shkollor, përgatitej edhe kuadri arsimor. Duke filluar prej kurseve pedagogjike përmes seminareve, shkollave normale dhe Akademisë Pedagogjike e fakulteteve, prej çlirimt deri në vitin 1974/75, në shkollat me mësim në gjuhën shqipe, mësimin e zhvillonin 2.470 ar-

<sup>1</sup> Struktura kualifikuese e kuadrit mësimor në shkollat me mësim në gjuhën shqipe për vitin shkollor 1974/75 me informatën e këshilltarit pedagogjik Feim Isai;

<sup>2</sup> Përkujtimorja Tridhjet vjet të Fakultetit Filologjik 1946-1976, Shkup, 1976, f.26;

<sup>3</sup> Struktura kualifikuese, po aty.;

<sup>4</sup> Informata me gojë e këshilltarit pedagogjik, Feim Isai;

simtarë, ose me përqindje, nëse indeksi për vitin shkollor 1945/46 është 100, përqindja është 935,6%<sup>1</sup>.

## 2. NGRITJA PERMANENTE PROFESSIONALE-PEDAGOGJIKE E KUADRIT ARSIMOR

Puna edukative dhe arsimore në shkolla i takoi mësuesit, përkatësisht arsimtarit. Me punën e tij mësuesi nxënësve u ndihmonte në mënyrë të gjithanshme dhe u mundësonte zhvillim të mëtejshëm.

Sic theksova, kuadri arsimor në shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe u shkollua në shkolla të llojeve të ndryshme, e shpeshherë edhe në shkolla ku fitohej arsimimi fetar, mandej nëpër seminare, e po ashtu edhe në lloje tjera të shkollave. Në shkollën e re kuadri arsimor kishte detyrë të vështirë. Nga ai nuk kërkohej vetëm ta mbajë rendin dhe qetësinë në klasë, por edhe të posedojë njohuri të shumta shkencore e posaçërisht në mënyrë të drejtë dhe shoqërore-politike t'i edukojë gjeneratat e reja.

Një pjesë e kuadrit arsimor, që kishte kualifikime, angazhohej edhe në funksione tjera shoqërore-politike. Ministria e Arsimit, me vetëdije angazhonte njerëz të ndryshëm të profesioneve të ndryshme që nuk kishin arsimim të përgjithshëm, e as njohuri nga lëndë të caktuara mësimore.

Prej çlirimit deri në vitin 1975, përsosjes profesionale të arsimtarëve i është kushtuar kujdes i madh, por më së shumti punohej me kuadrin arsimor pa arsimim të mjaftueshëm dhe jopërkatës, edhe pse në kurse merrnin pjesë edhe dëgjues me parapërgatitje të caktuara.

Përsosja profesionale-pedagogjike e kuadrit arsimor bëhej përmes kurseve dhe këshillimeve. Qëllimi i kurseve ishte që kuadri arsimor të ngrihet ideopolitikisht. Ligjëratat, kurset dhe seminaret kryesisht ishin të natyrës informative. Pas Plenumit III të LKJ-së, ngritja ideopolitike, përvëç në rrethe, filloi të organizohet edhe nëpër komuna<sup>2</sup>.

Në këtë aspekt u miratuan edhe disa konkluzione:

1. Luftën për edukimin e rinisë duhet zhvilluar në front sa më të gjerë përmes punës shkolllore dhe jashtëshkolllore dhe veprimit, duke shfrytëzuar sa më mirë dhe në mënyrë sa më të plotë të gjitha format,

<sup>1</sup> Buletini statistikor i RSM-së, 1975;

<sup>2</sup> Buletini i Entitit përparrimin e shkollës në RPM, nr.2/1957, f.6;

organizimet dhe mundësitë për veprim të këtillë edukativ si dhe duke e zgjeruar kujdesin dhe angazhimin shoqëror në këtë punë.

Lidhur me këtë, ndër të tjera, Këshilli republikan do ta shpejtojë punën në hartimin e programeve për edukimin etik në shkolla;

Arsimtarët që punojnë aktivisht kundër bazave ideore dhe edukative dhe qëllimeve të shkollës do të largohen nga shkolla me rrugë administrative, por mbështetës kryesorë për zhvillimin dhe kuptimin e funksionit të arsimtarit si punëtor dhe luftëtar aktiv për edukim, duhet të jenë vetë kolektivat arsimore dhe shoqatat e tyre profesionale.

Do të kihet kujdes gjatë zgjedhjes së nxënësve në shkollat normale, por edhe gjatë shkollimit do të largohen ata që dëshmojnë se qëndrojnë në bazat ideore dhe u nënshtrohen paragjykimeve të cilat janë në kundërshtim me rolin dhe detyrën e edukuesit të fëmijëve. Shkollave normale do t'u kushtohet sidomos një rëndësi në zgjedhjen e kuadrit arsimor, drejtoreve dhe në aspektin e pajisjes materiale;

Këshillat republikane do të organizojnë kontrollimin e teksteve me kujdes të veçantë në vendosjen jo të rregullt politike dhe edukative të materies mbi BRSS-në (dhe në përgjithësi të atyre që qëndrojnë në pozicione informbyroiste), në vulgarizimin e botëkuptimit materialist dhe interpretimin e dukurive në botë etj. Nga bibliotekat e shkollave duhet evitar librat që janë shkruar nga pozicione të këtilla, e po ashtu të njëjtët të ndahan edhe nga bibliotekat tjera;

Tërhiqet vërejtja në dukuritë e raporteve të ftohta të arsimtarëve dhe të shkollës në përgjithësi ndaj nxënësve, në marrëdhëni që sillen vetëm në kuadër të dispozitave, rregullave disiplinore, planprogramit mësimor etj., duke mos përfshirë elementet e gjera njerëzore, ndaj shkolla e këtillë për nxënësit bëhet jotërheqëse dhe e huaj;

Lidhur me vendimin e mëparshëm që adventistëve t'u merret parasysh se e kretnojnë të shtunën, u konkludua që as adventistët nuk mund të ndahan nga nxënësit tjerë dhe se doemos duhej të barazoheshin sipas dispozitave të përgjithshme shkollore<sup>1</sup>.

Përveç ngritjes ideopolitike, me kohë u paraqiten edhe seminare përlendë të posaçme mësimore<sup>2</sup>.

Inspektorët arsimorë të rretheve dhe qyteteve mbanin llogari për jetën dhe punën në shkollë dhe jepnin udhëzime konkrete për punë (në shkolla) në mënyrë që të evitoheshin mangësitë dhe mësimi të ishte në

<sup>1</sup> AM - Shkup, FD., Konkluzionet e mbledhjes së tetë të Këshillit për shkencë dhe kulturë të Qeverisë së RFPJ-së, 9-10 qershor 1952, kut.88;

<sup>2</sup> Udhëzime për kontrollimin e punës në shkollat fillore, "Svetlost", Sarajevë, 1951, f.4;

nivel sa më të lartë. Nëse në shkollë kishte më se 10 paralele, këtë funksion e kryente drejtori i shkollës<sup>1</sup>.

Prej vitit 1945 deri në vitin 1949, shërbimi inspektues vepronë më shumë si shërbim instruktiv, gjë që ishte kushtëzuar me përhapjen e shpejtë të rrjetit shkollor dhe të kuadrit arsimor profesionalisht të formuar. E tërë puna e shërbimit inspektues orientohej në organizimin e shkollave të reja, vlerësimin e kuadrit arsimor dhe në dhënien e udhëzimeve metodike-didaktike arsimtarëve. Kur u konstatua se ekziston numër i caktuar i kuadrit arsimor me arsimim të formuar, shërbimet inspektuese u orientuan të kontrollojnë realizimin e detyrave. Dhe atëherë në RS të Maqedonisë u formuan numër i madh inspektoresh. Në vitin 1951, për shkak të vrazhdësisë në punën e tyre, erdhën te mendimi se shërbimi inspektues e frenon zhvillimin e shkollës ngase nuk ia kishte dalur që të vlerësojë objektivisht punën e disa arsimtarëve, dhe në vend të elanit në punë, paraqitej shpirtngushtësia dhe papuna. Inspektorët, po ashtu në mënyrë të pandërgjegjshme dhe pa analiza pozitive i transferonin mësuesit nga një shkollë në tjetrën, edhe pse detyra ishte se nëse konstatojnë te ndonjë mësues sukses të dobët në punë, të njëjtin ta transferojnë në ato shkolla ku kishte punuar arsimtari me përvojë<sup>2</sup>.

Në periudhën e riorganizimit të rretheve dhe formimit të inspektimeve komunale, ky shërbim e fitoi sërisht rëndësinë e vet.

Shkollës fillore shqipe në RS të Maqedonisë ky shërbim i kandihmuar mjaft në organizimin e rrjetit shkollor, aftësimin e kuadrit arsimor, përfshirjen e nxënësve dhe në zgjidhjen e problemeve të tjera që lidheshin me shkollën dhe arsimin.

Shërbimet inspektuese në të cilat ishin angazhuar njerëz profesionalë me praktikë pedagogjike, gjatë kryerjes së kontrollimit në shkollat fillore, kryesisht ndaleshin në këto probleme: në përparimin e mësimit dhe përsosjen profesionale të kuadrit arsimor, në aktivitetet e lira si dhe në problemin e arsimimit popullor.

Përsosja e kuadrit arsimor u arrit në atë mënyrë që inspektorët i kontrollonin orët, jepnin këshilla individuale, organizonin ligjërata praktike të cilat i mbanin mësuesit me përvojë, përkatesisht arsimtarët dhe që merrnin pjesë në mbledhjet e kolegjumeve arsimore, në konferenca etj.

<sup>1</sup> Buletini...op.cit.nr.4, Shkup, 1957, f.71;

<sup>2</sup> "Flaka e vllaznimit" e dr.17.VIII.1954, nr.5;

Roli i inspektorëve nuk qëndronte vetëm në atë që të jepin gjykim për punën, por edhe të “studionin problemet dhe t'u ndihmonin arsimtarëve të merrnin qëndrim të drejtë dhe me sukses të realizojnë veprimtarinë shoqërore”<sup>1</sup>.

Puna e inspektorëve nuk duhet nënçmuar ngase inspektorët u ndihmuat shumë mësuesve të rinj dhe atyre me arsimim jo të plotë, t'u shmanget anëve të këqija në punë dhe që të fitojnë shprehi për t'u përgatitur rregullisht për mësim. Mësuesit shqiptarë të gjitha kritikat nga ana e inspektorëve i pranonin pozitivisht. Sa për ilustrim do të përmend një pjesë të procesverbalit të një inspektori që është marrë nga një raport inspektues: “Kontrollimi inspektues është bërë më 5.VI.1952 në Shkollën fillore “Vllaznimi” në fshatin Leshnicë të Kërçovës. Arsimtari M.P. punon me dy paralele të kombinuara... Materiali i paraparë nuk është kryer... Ana metodike e kënaqshme... Administrata e rregullt... Suksesi në këtë vit shkollor i dobët (2)”. Vitin e ardhshëm më 8 maj 1953, inspektori shkruan kështu: “Arsimtari M.P....materialin e paraparë e ka tejkaluar... Marrë në përgjithësi, e duke pasur në mend ngarkimin e nxënësve në paralele të kombinuara, gjatë këtij viti M.P. ka arritur sukses të mirë (3)”<sup>2</sup>. Ose nga procesverbali tjetër mund të shihet qartë se si inspektori i ka rekomanduar arsimtarit “...S.S.që sa më shumë të përcjellë literaturë pedagogjike...në mësim të aplikojë mjete konkretizuese”<sup>3</sup>.

Duke shqyrtauar dokumentacionin pedagogjik që e kanë mbajtur inspektorë të ndryshëm, erdha në përfundim se inspektorët kanë qenë mjaft aktivë në punën e tyre dhe i kanë kontribuar shumë përparimit të mësimit dhe shmangies së disa formave tradicionale. Po ashtu mund të konkludohet se mësuesit, të vjetër dhe të rinj, me arsimim të formuar dhe pa arsimim të formuar, kanë qenë entuziastë. Organet arsimore, duke e vlerësuar punën e tyre, vazhdimisht gjenin mjete përmotivim.

<sup>1</sup> Arkivi i Shkollës ‘Rexhë R.Zajazi’, f.Zajaz, Kërçovë, Procesverbali me rastin e revizionit të kryer nga ana e inspektorit;

<sup>2</sup> Arkivi i Shkollës fillore “Bashkimi”, f.Leshnicë, Kërçovë, libri i procesverbaleve me rastin e inspektimit të kryer nga ana e inspektorit;

<sup>3</sup> Arkivi i Shkollës fillore “Pavle Tërpevski”, f.Balindoll, komuna e Gostivarit, libri i procesverbaleve me rastin e kryerjes së inspektimit nga ana e inspektorit;

## *2.1. ROLI I SHËRBIMIT ARSIMOR-PEDAGOGJIK NË PËRSOSJEN E KUADRIT ARSIMOR*

Kur tek ne filloi të koncipohet reforma e parë shkolllore, Shërbimi arsimor-pedagogjik zuri vendin e vet në Ligjin e përgjithshëm për shkollimin. Në RS të Maqedonisë për herë të parë filloi të realizohet në vitin 1960 me emërtimin SHËRBIMI ARSIMOR-PEDAGOGJIK NË RP TË MAQEDONISË. Të njëjtin vit u miratua edhe Ligji i parë<sup>1</sup>.

Me miratimin e Ligjit të përgjithshëm për shkollimin, u miratua edhe Ligji për shërbimin arsimor-pedagogjik, më vonë Ligji për organizimin e veprimtarisë për përparimin e edukimit dhe arsimimit, si dhe Rregullorja për organizim, përsosje profesionale dhe pedagogjike të kuadrit arsimor në shkollat fillore dhe të mesme.

Për përsosjen e kuadrit arsimor ishte i ngarkuar Enti Republikan për Përparimin e Edukimit dhe Arsimimit dhe entet komunale, përkatesisht ndërkomunale për përparimin e edukimit parashkollar dhe edukimit fillor dhe arsimimit si shërbim arsimor-pedagogjik, puna dhe ndihma e të cilave vepronë në kuadër të këtij enti. Në RS të Maqedonisë ky shërbim njihet si Enti për Përparimin dhe Studimin Shkollor.

Pas themelimit të Shërbimit Arsimor-Pedagogjik (1956), pranë këtij enti formohet edhe Qendra për përsosje profesionale të kuadrit arsimor.

Qendra për përsosjen e kuadrit arsimor, punën e saj në RS të Maqedonisë e filloi më 9.XII.1957 me elaboratin e përgatitur të miratuar nga ana e Këshillit Republikan të Arsimit.

Ishte vështirë të zbatohet reforma shkolllore, ngase atëherë përvèç mësuesve të kualifikuar punonin edhe mësues me kurse të kryera ose shkolla të tjera, ose mësues të cilët ishin aftësuar nëpër seminare. Kështu nuk mund të realizoheshin të gjitha qëllimet në fryshtë e metodologjisë së re. Enti i Arsimit i RS të Maqedonisë formoi dhe organizoi: Qendrën republikane për përsosje profesionale të kuadrit arsimor dhe Qendrën rajonale, që punonin në kuadër të Entit për përparimin dhe studimin e shkollimit nën mbikëqyrjen e Këshillit republikan të shkollave<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> "Gazeta zyrtare" e RPM-së, nr.16/1960;

<sup>2</sup> Buletini i Entit për përparimin e shkollave nr.2, 1957, f.8;

Qendra për përsosjen profesionale të kuadrit arsimor i kushtoi kujdes të veçantë ndërtimit profesional-metodik dhe ideologjik të kuadrit arsimor dhe miratimit të reformës për transformimin e shkollimit tonë, përmes organizimit të kurseve, seminareve, këshillimeve etj. (Enti republikan për përparimin e arsimimit dhe edukimit organizoi seminare dhe këshillime të atilla, që shihet nga pasqyra që pason)<sup>1</sup>.

VITI	Seminare		Këshillime		Gjith. sem. e këshill.	Viz. sem e kësh.
	numr	vizit.	numr	vizit.		
1957	6	150	-	-	6	150
1958	3	80	3	70	6	150
1959	24	943	2	80	18	1023
1960	16	542	5	275	21	817
1961	15	404	4	256	19	660
1962	11	331	3	473	24	804
1963	10	336	4	125	14	461
1964	5	163	11	497	16	660
1965	13	515	15	710	28	1225
1966	15	820	7	390	22	1210
1967	18	1140	12	590	30	1730
1968	18	900	4	250	22	1100
1969	11	600	10	400	21	1000
1970	28	1400	11	730	39	2130
1971	15	1024	5	300	20	1324
1972	14	1161	14	1280	28	2441
1973	23	1380	8	480	31	1860
1974	37	4472	8	532	45	5004
1975	21	1170	3	216	24	1386
Gjiths.	310	19641	139	1174	433	26235

Tabela nr. 21 - Pasqyra e kandidatëve për përsosje profesionale

Në këto seminare dhe këshillime përpunoheshin tema aktuale ngajeta shoqërore-politike, nga lëmi i edukimit dhe arsimimit, shkencës dhe teknikës, aftësimi pedagogjik-metodik i arsimtarëve, nga lidhshmëria e teorisë dhe praktikës<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> "25 vjet të Entit republikan për përparimin e arsimit dhe edukimit", Shkup, 1981, f.62;

<sup>2</sup> Ibid.f.63;

Të gjitha seminaret i organizonte Enti në bashkëpunim me qendrat ndërrepublikane. Vijuesit, mësuesit, përkatësish arsimtarët që vijonin seminaret dhe këshillimet, nuk fituan kurrrfarë shkalle të arsimimit e edhe përmes mësuesit me arsimim jo të plotë nuk ishte paraparë provimi përfundimtar<sup>1</sup>. Perfeksionimi i arsimimit edhe më tutje mbetet në shkollat normale, vetëm se këto kurse, seminare dhe këshillime ndihmuan mjaft në punën dhe përgatitjet për dhënien e provimeve.

Shërbimi arsimor-pedagogjik në plan të parë kishte përdetyrë t'u ofrojë ndihmë profesionale dhe pedagogjike arsimtarëve në ngritjen e punës cilësore edukative-arsimore.

Përsosja profesionale-pedagogjike e arsimtarëve në shkollat fillore përmes grupet përkatëse zhvillohej në bashkëpunim me Entin dhe arsimtarët e Akademisë Pedagogjike të Shkupit, të cilët ishin të angazhuar përmes mbajtjen e ligjératave nga lëndët profesionale. Përsosja profesionale pedagogjike e arsimtarëve bëhej gjatë vitit shkollor dhe zgjaste së paku 10 ditë<sup>2</sup>.

Të drejtë në përsosje profesionale-pedagogjike kishin arsimtarët që kishin mbushur 2, 7, 12 dhe 17 vjet të përvojës së arsimtarit<sup>3</sup>.

Përmes arsimtarët që nuk kishin mbushur 2 vjet të përvojës arsimore, Shërbimi arsimor-pedagogjik organizonte forma të posaçme përmes përsosje profesionale pedagogjike, siç janë: përcjellja e punës së arsimtarëve më të vjetër, seminare dhe konsultime përmes punës profesionale-metodike etj.

## 2.2. PROVIMET SHTETËRORE-PROFESIONALE TË MËSUESISË

Vitet e para pas luftës në procesin mësimor ishin vite të punës intensive në ndërtimin e shkollës, adaptimin, hapjen e shkollave të reja, organizimin e kurseve analfabetike, aftësimin e kuadrit arsimor etj.

Pamë se pas aftësimit të përkohshëm të kuadrit arsimor përmes kurseve dhe seminareve, u hap edhe Shkolla e parë normale, ku kan-

<sup>1</sup> Buletini i Entit përmes përparimin e shkollës në RPM, nr.2, Shkup, 1957, f.20 (Qendrat rajonale përmes përsosjen profesionale të kuadrit arsimor);

<sup>2</sup> "Gazeta zyrtare" e RSM-së, nr.27, Shkup, 1971, f.458;

<sup>3</sup> Po aty.(neni 9);

didatët-mësues fituan njohuri të gjera për profesionin e tyre të mësuesit.

Pas përfundimit të shkollës dhe pasi kishin kaluar dy vjet si praktikantë në punën në shkollë, të gjithë arsimtarët (kandidatët) me ligj ishin të obliguar të jepnin provimin shtetëror-profesional të mësuesisë<sup>1</sup>.

Provimet shtetërore profesionale përbëheshin nga dy pjesë: pjesa e përgjithshme, ku provimi jepej nga:

1. Gjuha shqipe
2. LNÇ-ja
3. Kushtetuta e RFPJ-së, Judikatura zyrtare, Sistemi ekonomik i RFPJ-së.

Pjesa tjetër, pjesa profesionale përbëhej nga:

1. Puna praktike (hartimi me shkrim dhe mbajtja e një ore)
2. Mbrojtja e punës praktike
3. Organizimi dhe administrata shkolllore
4. Detyrat dhe format organizative të Organizatës së Pionierëve.
5. Mbrojtja me gojë (nga pedagogjia, metodika dhe psikologjia)<sup>2</sup>.

Kandidatët provimin e jepnin para komisionit dhe merrnin nota sipas suksesit të treguar, sipas nenit 12<sup>3</sup>.

Kandidati-praktikant kishte të drejtë të japë provim vetëm tri herë. Me rastin e dhënies së provimeve shtetërore-profesionale, kandidatët merrnin pushim me pagesë prej 20 ditësh, kurse kandidatëve që jepnin për herë të parë provimin, u paguheshin të gjitha shpenzimet nga ana e shkollës. Të gjitha entet komunale mbajnë llogari që mësuesit e tyre të fitojnë kualifikime profesionale, duke u mundësuar kohë dhe literaturë profesionale<sup>4</sup>.

Për dhënien e provimit shtetëror profesional të mësuesisë, ishin caktuar dy afate: afati i parë prej 1.10. deri më 30.12 dhe afati i dytë prej 1.2. deri më 30.4. Për këto afate ishte e nevojshme të paraqiten të jatin provimin së paku 5 kandidatë, edhe përvèç atyre që nuk mund ta jepnin për herë të parë, përkatësisht për herë të dytë.

Provimet profesionale shtetërore kontribuan që arsimtarët të njihen me shkencën pedagogjike në përgjithësi dhe të verifikohen përvoja

<sup>1</sup> "Gazeta zyrtare" e RFPJ, nr.29, 1951, nen 9;

<sup>2</sup> Udhëzime për dhënien e provimit profesional shtetëror për mësues (s.a.), f.1;

<sup>3</sup> Suksesi i kandidatëve në provimin profesional të vlerësuar me notën e përgjithshme: shkëlqyeshëm, shumë mirë, mirë dhe nuk e ka dhënë provimin;

<sup>4</sup> Enti për shkollim pranë Kuvendit të rrëthit të Ohrit "Aktuelnost", nr.4, f.11;

dhe dituria e tyre pedagogjike në profesion. Kandidatët-mësues këtë provim e jepnin në shkollat normale. Pas vërtetimit se e kishin dhënë provimin profesional, kandidatët merrnin të ardhura më të mëdha personale dhe dërgoheshin në vende më të mira shërbimi.

Provimet e këtilla shtetërore profesionale, mësuesit shqiptarë për herë të parë filluan t'i japin më 6 prill 1950, edhe atë kandidatët: Rifat Salush, Shashko Xhevati, Sulejman Alia dhe Sami Ademi<sup>1</sup>. Deri në vitin shkollor 1968/69, provime të këtilla dhanë 310 kandidatë<sup>2</sup>.

Pas ndërprerjes së provimeve shtetërore profesionale, filloi të aplikohet mënyrë tjeter e fitimit të arsimimit permanent.

---

<sup>1</sup> Arkivi i Shkollës Normale, përkatësisht i Gjimnazit “Zef Lush Marku”, Shkup, Libri i procesverbaleve për dhënien e provimeve profesionale shtetërore;

<sup>2</sup> Ibid.;

# V

---

## 1. QEVERISJA SHOQËRORE NË SHKOLLË

Shenjat e para të qeverisjes shoqërore me shkollën datojnë që nga lufta antifashiste, me formimin e KPR-ve<sup>1</sup>. Përveç obligimeve tjera ato ishin të ngarkuara edhe me punën arsimore në territoret e çliruara të Maqedonisë. KPR-të e rretheve, të komunave dhe bashkësive lokale, përkatesisht anëtarët e tyre ishin të ngarkuar të kujdesen për rregullimin e lokalit shkollor, për pajisjen e shkollës me mobilie përkatëse, të kujdesen për mësuesit rreth sigurimit të vendosjes, ushqimit, regjistrimit të fëmijëve etj., në territorin e komunës së tyre.

Këshilltarët e disa KPR-ve lokale që i takonin një qendre shkollore përbënë edhe Këshillin e shkollës dhe mbanin mbledhje mujore me drejtorët e shkollave, ku shqyrtoton çështje të ndryshme lidhur me punën në shkollë<sup>2</sup>.

Pas çlirimit të vendit nga ana e pushtetit popullor kishte tendenca që qeverisja me shkollat në njëfarë mënyre “t'u jepet” trupave me më shumë tipare demokratike. Megjithatë, për arsyet e kuptueshme, disa vite pas luftës nuk mund të flitej për ndërmarrjen e hapave seriozë në drejtim të çlirimit të vërtetë të shkollës nga ndikimi i drejtpërdrejtë i organeve shtetërore. Në këtë fazë të parë, qeverisja me shkollat ishte plotësisht e centralizuar. Shteti përmes organeve të tij, me rrugë administrative, përmes vendimeve, dekreteve, urdhërave, etj., qeveriste me shkollat dhe e orientonte punën e tyre. Shkolla si institucion shoqëror nuk mund të përjashtohej nga kontrolli dhe ndikimi i drejtpërdrejtë nga ana e organeve shtetërore.

<sup>1</sup> Gjatë mbajtjes së Mbledhjes I të ASNOM-it u formuan rreth 500 KNÇ;

<sup>2</sup> M.Ogrizoviq, Zhvillimi i shkollës në territorin e çliruar të Kroacisë, 1941-1945, f.34-36;

Ngjarje vendimtare në drejtim të çlirimit të shkollës nga organet administrative-qeverisëse të shtetit dhe afrimit të tyre faktorëve të cilët për këtë janë të interesuar drejtpërsëdrejti, paraqesin vendimet e Plenumit III të KQ të LKJ-së mbi detyrat në shkollim. Në rezolutën e Plenumit, ndër të tjera thuhet: "Parimi i përgjithshëm i qeverisjes në shkollë duhet të jetë: pavarësimi i organeve më të ulëta dhe i kuadrit arsimor dhe të mësuesisë krahas ngritjes së njëkohshme të luftës ideore dhe ndihmës së kontrollit"<sup>1</sup>.

Së shpejti pas kësaj (në nëntor të vitit 1950) u miratua Udhëzimi për themelimin e këshillave të arsimit dhe shuarjen e komisariateve të mëparshme të arsimit pranë këshillave popullore. Derisa organet e mëparshme të qeverisjes shoqërore të shkollës ishin kryesisht me karakter këshilldhënës, me këtë Udhëzim parashihej që këshillat e reja të kenë autorizime gjatë vendosjes.

Me miratimin e Ligjit kushtetues të 13 janarit 1953, u krijuan bazat juridike për aplikimin e qeverisjes shoqërore në të gjithë lëmenjtë e veprimtarisë, e me këtë edhe në arsim. Si rezultat i kësaj, më 12 janar 1954 u miratua Ligji i përgjithshëm për universitetet, me të cilin u rregullua qeverisja shoqërore me universitetet.

Në fillim të vitit 1955, Kuvendi Popullor Federativ miratoi Ligjin e përgjithshëm për qeverisjen e shkollave. Ky është një nga dokumentet më të rëndësishme që janë miratuar deri më sot, e me të cilin është rregulluar çështja e pavarësimit të mëtejshëm të shkollës. Përzbatimin e qeverisjes shoqërore në shkolla, para miratimit të Ligjit të përgjithshëm për qeverisjen me shkollat, nuk ka ekzistuar baza unike ligjore për zbatimin e tij në rajonin më të gjerë të vendit tonë. Vetëm Ligji kushtetues i vitit 1953 dhe Ligji i përgjithshëm për qeverisjen me shkollat i vitit 1955, krijuan kushte për ndërmarrjen e aksioneve të gjera dhe unike në vijën e zbatimit dhe realizimit të qeverisjes shoqërore me shkollat.

Hapi i ardhshëm paraqet miratimin e Ligjit të përgjithshëm për shkollim i vitit 1958. Me këtë ligj u përcaktua vendi dhe roli i të gjitha organeve të qeverisjes shoqërore të shkollave si dhe marrëdhëniet e tyre reciproke. Me ligjin në fjalë, ndër të tjera është paraparë: "Shkollat dhe entet tjera të edukimit dhe arsimimit janë institucione të pavarura shoqërore të organizuara mbi parimet e vetëqeverisjes shoqërore"<sup>2</sup>. Me këtë, raporti ndërmjet shkollave si njësi themelore admin-

<sup>1</sup> "Komunist", organ i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, nr.1, 1950;

<sup>2</sup> Ligji i përgjithshëm për shkollën, Beograd, 1958, f.2.

istrative në lëmin e arsimit dhe organeve të tjera të vëtëqeverisjes shoqërore është vendosur mbi baza, të cilat shkollave u dhanë pavarësi më të madhe. Në sistemin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave shkollore dhe anëtarëve të këshillave të arsimit u zbatuan parime më demokratike. Në këhillat shkollore, në vend të anëtarëve më parë të emëruar dhe të zgjedhur në tubimet zgjedhore, Ligji i përgjithshëm për shkollimin parashev edhe të drejtën që shkolla me rregulloret e saj të parashohë se cilat organizata, shoqata profesionale dhe institucionale mund t'i zgjedhin anëtarët e këshillit të shkollës. Në qeverisjen me shkollat është paraparë edhe pjesëmarrja e nxënësve. Praktika e emërimit të të gjithë anëtarëve të këshillit nga ana e këshillit ndryshoi. Ligji parashihte që një numër të anëtarëve të këshillit ta delegojnë organizatat sindikale, organizatat e KP, shoqatat profesionale, organizatat shoqërore dhe ekonomike, këhillat e shkollave etj. Këto ndërrime në zgjedhjen e anëtarëve të këshillave kanë të bëjnë si me këhillat komunale, ashtu edhe me këhillat e rrëthit dhe me ato republikane.

Këhillat dhe pleqësitë shkollore të arsimit fituan autorizime të reja dhe të gjera në qeverisjen me shkollen. U bënë ndërrime edhe në metodën e punës së këtyre trupave. Këshilli për arsim i komunës etj., madje edhe në ato raste kur është i autorizuar të marrë vendime për çështje të caktuara, është i obliguar që lidhur me këto t'i konsultojë përfaqësuesit e shkollave përkatëse.

Me organizimin e shërbimit arsimor-pedagogjik në kuadër të organeve përkatëse të qeverisjes shoqërore, Ligji i përgjithshëm për shkollimin e ndërrroi rrënjosht karakterin e inspektimit të dikurshëm.

Arsimtarët në realizimin e qëllimeve themelore të punës edukative-arsimore, u bënë plotësisht të pavarur.

Në qeverisjen me shkollen u përfshinë edhe nxënësit.

Këto ndryshime kontribuan që në zgjidhjen e problemeve shkollore dhe arsimore, në përgjithësi të mobilizohen shtresa të gjera të njerëzve. Sot, shkollat dhe institucionet tjera edukative kanë arritur shkallë të lartë të pavarësisë. Megjithatë, ajo që është arritur në lëmin e qeverisjes me shkollen nuk duhet konsideruar si definitive. Kjo do të ishte në kundërshtim me tendencat e përgjithshme të zhvillimit të qeverisjes shoqërore në vendin tonë.

Procesi i pavarësimit të shkollës vazhdon edhe më tutje. Në favor të kësaj flet edhe Ligji më i ri për financimin e shkollave, i cili jo vetëm që paraqet hap të ri në drejtim të pavarësimit të shkollës, por

njëkohësisht tërheq me vete edhe një sërë çështjesh të tjera lidhur me bartjen e kompetencave organeve administrative shkollore.

## 1.2. KËSHILLI I SHKOLLËS

Një nga organet më të rëndësishme në sistemin e qeverisjes shoqërore me shkollat është Këshilli i shkollës. Ligji i përgjithshëm për shkollën, këshillave shkollore u ka dhënë autorizime të jashtëzakonshme, e me këtë edhe vend të posaçëm sa i përket qeverisjes me shkollat. Pozita dhe roli i këshillave të shkollës do të forcohen edhe më tej me zhvillimin dhe përkryerjen e mekanizmave të administrimit shoqëror me shkolla.

### 1.2.1. PËRBËRJA, MËNYRA E ZGJEDHJES DHE LIGJSHMËRIA NË PUNËN E KËSHILLIT TË SHKOLLËS

Në shkollat e ndryshme të arsimit të përgjithshëm dhe në ato profesionale, zgjedhja dhe përbërja e këshillave të shkollës, në esencë është e ngjashme, edhe pse disa ndryshime janë të pashmangshme, sidomos kur kihet parasysh shkalla e shkollës, kushtet dhe rrethanat tjera. Kryesisht në përbërje të këshillave të shkollës, hyjnë anëtarët të cilët i zgjedhin ose i emërojnë: Këshilli popullor i komunës (i emëron) me propozim të Këshillit arsimor; Këshilli i arsimtarëve nga mjedisi i tij; zgjedhesit nga radhët e qytetarëve; organizatat ekonomike dhe shoqërore, shoqatat dhe institucionet profesionale; në shkollat e mesme nxënësit zgjedhin një numër të përfaqësuesve të tyre përkëshillin e shkollës; sipas pozitës së tij, anëtarë i këshillit të shkollës është edhe drejtor (drejtues i shkollës).

Çështjet se sa anëtarë do të ketë në një këshill të shkollës, çfarë do të jetë përbërja, cilat organizata dhe institacione si dhe sa anëtarë do të zgjedhin përkëshillin e shkollës, përcaktohen me Rregulloren e çdo shkolle. Për çdo rast, mbahet llogari që në këshillat e shkollës të hyjnë vetëm përfaqësuesit e atyre organizatave, institacioneve, organeve etj., të cilët për shkollën përkatëse janë të interesuar drejtpësëdrejti.

Anëtarët e Këshillit të shkollës, kohë pas kohe i njoftojnë trupat të cilët i kanë zgjedhur, për punën e këshillave të shkollës. Anëtarë i këshillit të shkollës i cili nuk e kryen me ndërgjegje detyrën e besuar, mund të revokohet nga ana e atij faktori i cili e ka zgjedhur. Me ligj janë paraparë edhe raste të tjera se kur një anëtar i këshillit të shkollës duhet dhe mund të shkarkohet nga detyra, si dhe ajo se cili mund ta shkarkojë. Kjo, po ashtu ka të bëjë edhe me shkarkimin e këshillave të shkollës në tërësi, nëse nuk i përbushin obligimet dhe detyrat themelore sa i përket shkollës. Pra, në raste të këtilla, Këshilli i shkollës shpërndan Këshillin komunal (të rrëthit). Ndaj vendimit të këtillë Këshilli i shkollës mund t'i ankohet organit më të lartë. Ligji i përgjithshëm për shkollimin rregullon edhe çështjen se kur mund të merret në përgjegjësi një këshill i shkollës.

Organet e administratës të këshillave komunale në territorin e të cilëve gjenden këshillat e shkollës, mund t'i ndalojnë përkohësisht vendimet e këshillave të shkollës për të cilat mendojnë se janë të paligjshme. Lënda i dërgohet këshillit përkatës të arsimit, i cili është i autorizuar për marrjen e vendimit definitiv.

### *1.3. KËSHILLI I ARSIMTARËVE*

Këshilli i arsimtarëve është trup shoqëror-pedagogjik, i cili së bashku me organet tjera udhëheq me shkollën dhe i zgjidh problemet më të rëndësishme nga lëmi i punës arsimore-edukative. Ky është organ profesional për çështje mësimore, edukative dhe arsimore. Sipas kësaj, ky është edhe më përgjegjës për tërë veprimtarinë pedagogjike të shkollës. Organizimi praktik i punës dhe realizimi i problematikës së tërësishme pedagogjike, realizimi i qëllimeve të planprogramit mësimor, gjenden në qendër të veprimitarisë së këshillit të arsimtarëve.

Në mënyrë që kolektivi i arsimtarëve të mund t'u përgjigjet detyrave të veta, është e domosdoshme që ai të jetë i organizuar mirë. Puna e përbashkët në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të njëjtë i afron njerëzit, ndaj mund të pritet se organizimi i kolektivit të arsimtarëve mund të zbatohet lehtë. Megjithatë, në çdo kolektiv veprojnë shumë faktorë të cilët këtë çështje e bëjnë shpeshherë të komplikuar.

Në mesin e shkaqeve që ndikojnë negativisht në kolektivat e arsimtarëve, me çka pengohet ndërtimi i tij si një trup homogjen i edukatorëve të vërtetë, duhet theksuar disa tendenca mikroborgjeze të

formave të ndryshme, e të cilat në praktikë nuk janë dukuri e rrallë. Përvoja ka dëshmuar se kolektivat e arsimtarëve, në të cilat tendencat e këtilla dhe të ngjashme veprojnë në mënyra të ndryshme, janë të paaftë për ta zgjidhur seriozisht cilëndo detyrë.

Vetëm kolektivi unik i arsimtarëve mund të pritet t'i kryejë me sukses detyrat e tij më të rëndësishme. Uniteti, mirëkuptimi reciprok dhe harmonia, të bazuara mbi baza të shëndosha, e të cilat mund të dalin vetëm nga përpjekjet e përbashkëta të realizimit të detyrave edukative-arsimore në shkollë, mund të jenë bazë për marrëdhënie të shëndosha në kolektivat e arsimtarëve. Prandaj, detyrë themelore e të gjithë arsimtarëve, e në radhë të parë udhëheqësve të shkollës, është që prej ditës së parë të punojnë në interes të unitit dhe harmonisë së kolektivit. Në shikim të parë, drejtori mund të luajë rol të rëndësishëm. Nuk janë të rralla rastet që qëndrimi jokonsekuant, i njëanshëm, joparimor dhe në përgjithësi negativ i disa drejtorëve në raport me disa çështje dhe arsimtarë, të jenë shkaktarë kryesorë të helmimit të marrëdhënieve ndërmjet arsimtarëve. Qëndrimi objektiv dhe i drejtë i drejtorit të shkollës, është një nga kushtet e rëndësishme për themelimin e marrëdhënieve të mira në kolektivat e arsimtarëve.

#### *1.4. DREJTORI (UDHËHEQËSI) I SHKOLLËS*

Me Ligjin e përgjithshëm për shkollimin, të vitit (1958), udhëheqësit të drejtpërdrejtë të shkollës - drejtorit, i është dhënë një nga vendet më të rëndësishme në mesin e organeve të tjera udhëheqëse të shkollës. Udhëheqësi i shkollës është udhëheqës i drejtpërdrejtë pedagogjik, disiplinor dhe administrativ. Është anëtar i Këshillit të arsimtarëve, mbledhjet e të cilit i thërrret dhe udhëheq me to. Po ashtu është edhe anëtar i Këshillit arsimor. Vendimet e Këshillit të shkollës mund t'i pezullojë përkohësisht, nëse mendon se janë të parregullta. Vërejtjet në vendimet e ngjashme të Këshillit të shkollës ia dërgon Këshillit të arsimit, i cili është kompetent për zgjidhjen e tyre definitive. Kjo ka të bëjë edhe me vendimet e Këshillit të arsimtarëve.

Meqë udhëheqësi është anëtar i Këshillit të arsimtarëve dhe i Këshillit të shkollës, edhe atë me autorizime të veçanta, ai luan rol të rëndësishëm në koordinimin dhe orientimin e punës së këtyre dy organeve më të rëndësishme të qeverisjes me shkollën. Drejtori është përfaqësues ligjor i shkollës në raport me entet, ndërmarrjet dhe indi-

vidët tjerë. Vendimet që i marrin organet e shkollës bëhen të plot-fuqishme vetëm atëherë kur i nënshkruan drejtori i shkollës. Drejtori është epror i drejtpërdrejtë disiplinor i arsimtarëve dhe nëpunësve të tjerë që punojnë në shkollë. Lidhur me këtë mban llogari që arsimtarët dhe nëpunësit e tjerë të shkollës me kohë dhe me ndërgjegje t'i kryejnë të gjitha obligimet nga fushëveprimi i veprimtarisë së tyre. Në koordinim me arsimtarët, drejtori i shkollës organizon punën e përgjithshme arsimore dhe edukuese në shkollë. Specifika e punës së drejtorit është e atillë saqë në asnjë rast me një punë të tillë nuk mund t'i theksojë të gjitha llojaljojshmëritë dhe shërbimet e detyrave të tij. Këshilli i shkollës, këshilli i arsimtarëve, këshilli i klasës, aktivitetet jashtëmësimore dhe jashtëshkollore të nxënësve dhe arsimtarëve, bashkëpunimi me prindërit, lidhshmëria e shkollës me ambientin shoqëror, puna e organizatave të fëmijëve, pjesëmarja në komisione të ndryshme, organizimi dhe mbajtja e administratës, aktivitetet profesionale, bashkësia e nxënësve, puna kulturore-arsimore në shkollë, sigurimi material i shkollës, problemet e mësimit dhe suksesi i nxënësve, planifikimi i punës, harmonizimi i planeve, vizita në orë të mësimit dhe shumë çështje të tjera, janë lëndë dhe detyrë e punës së përditishme të drejtorit.

#### **1.4.1. UDHËHEQJA ME ADMINISTRATËN SHKOLLORE**

Për zhvillimin normal të punës në shkollë, administrata shkollore dhe mbajtja e saj e rregullt është me rëndësi të posaçme.

Numri i madh i librave shkollorë-administrativë janë dokumente me vlera të përhershme për shkollën. Për këtë arsy, shkollat duhet të kenë administratë të rregulluar mirë.

Çështja e mbajtjes dhe udhëheqjes së administratës në llojet e ndryshme të shkollave, nuk është zgjidhur çdoherë ashtu si duhet. Në disa shkolla me numër më të vogël të paraleleve, afarizmin administrativ-financiar e mban udhëheqësi i shkollës. Në një numër të madh të shkollave këtë punë e kryejnë persona të veçantë. Detyra e drejtorit është të udhëheqë dhe organizojë administratën e shkollës. Mënyra e vjetër e punës, kur drejtori ka qenë më shumë administrator dhe teknik, sot më nuk është në pajtim me pozitën e tij të re. Me Ligjin e përgjithshëm për administrimin shoqëror në shkolla, kjo çështje është

zgjidhur. Me pavarësimin e mëtejshëm të shkollës, administrimi i saj fiton rëndësi gjithnjë e më të madhe. Kjo është sidomos e rëndësishme lidhur me mënyrën e re të financimit të shkollës. Përvoja e deritashme ka treguar se mbajtjes së administratës së shkollës nuk i është kushtuar ajo rëndësi të cilën ajo me të vërtetë e ka. Përkundër dispozitave ligjore të cilat rregullojnë punën se kush mund të emërohet për sekretar (regjisор) i shkollës, disa (e këta nuk janë të paktë) KNÇ me këto vende të punës zgjidhin disa probleme të papunësisë si dhe disa probleme financiare. Në raste të këtilla, për sekretarë emërohen persona me njohuri të mangëta dhe joprofessionale. Në rastet tjera, pozita e sekretarit të shkollës plotësohet përmes dhënieve së honorarit ose paushalit personave që kryejnë punë të tjera. Qëndrimi i këtillë ndaj kësaj çështjeje i ka shkaktuar shumë vështirësi udhëheqësit të shkollës. Drejtorët janë të detyruar që vetë t'i kryejnë punët administrative dhe me këtë t'i lënë pas detyrat e tyre themelore.

## PËRFUNDIM

Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë, pozitën e tyre në emancipimin nacional dhe zhvillimin e përgjithshëm në të gjitha fushat e jetës shoqërore e harmonizuan sipas parimeve të Kushtetutës së RSFJ-së, Kushtetutës së RSM-së, ligjeve, statuteve të komunave dhe bashkësive lokale etj.

1. Shkolla fillore shqipe në RS të Maqedonisë është pjesë përbërëse e sistemit shkollor unik jugosllav dhe ka realizuar qëllime të përbashkëta të edukimit dhe arsimimit të gjeneratave të reja.
2. RS e Maqedonisë, edhe pse bënte pjesë në republikat jo mjaft të zhvilluara, në sferen e arsimit në përgjithësi janë arritur rezultate të rëndësishme, e në këtë konteks edhe shqiptarët gjithsesi duhej të jenë të kënaqur me arritjet në shkollimin e detyruar.
3. Për shqiptarët në RS të Maqedonisë, e drejta për edukim dhe arsimim deri në periudhën e lartpërmendur është siguruar si në institucionet shtetërore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën amtare, ashtu edhe në të gjitha nivelet, duke filluar nga entet parashkollore e deri te institucionet e larta.

Në realizimin e arsimimit fillor në RS të Maqedonisë, rezultate të rëndësishme janë arritur në përhapjen e rrjetit shkollor dhe përfshirjen e obliguesve shkollorë.

Paralelisht me realizimin e shkollës në gjuhën maqedonase është zhvilluar rrjeti i shkollave fillore edhe në gjuhën mësimore shqipe. Që në vitin 1945/46, pra, vitin e parë shkollor në Jugosllavinë socialiste, mësimi në gjuhën shqipe është zhvilluar në 142 shkolla fillore me 15.454 nxënës, me temp të shpejtuar, kurse të kombësítë tjera në RS të Maqedonisë përhapja e rrjetit shkollor ka shkuar pak më ngadalë. Posaçërisht duhet theksuar periudhën e përgatitjeve reformuese ngase filloi shtimi i shpejtuar i numrit të nxënësve si rezultat i rritjes natyrore të numrit të fëmijëve në shkollën shqipe, që përfshiu edhe zgjerimin e shpejtë të rrjetit shkollor.

Organet arsimore të Republikës Socialiste të Maqedonisë kanë bërë përpjekje, që në çdo vendbanim ku ekziston numër minimal i nxënësve (të paraparë me ligj) të hapin shkolla ose klasa për realizimin e arsimimit fillor. Posaçërisht duhet theksuar se në vitin

shkollor 1965/66 në RS të Maqedonisë kanë punuar 74 shkolla të përziera, në të cilat mësimi është zhvilluar në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe serbokroate, përkatësisht kroatoserbe, kurse në vitin 1974/75 kanë punuar 81 shkolla të përziera.

4. Në shkollat fillore për kombësinë shqiptare në RS të Maqedonisë, në vitin shkollor 1975/76, shtimi i numrit të nxënësve në krahasim me vitin 1945/46 shënon indeks prej 420. Rezultatet e arritura edhe në përfshirjen e gjeneratave të obliguesve shkollorë në arsimimin e obligueshëm tetëvjeçar janë tejet impresive, në përqindje 92,7% në gjeneratë.
5. Pas çlirimt kuadri arsimor paraqiste një nga problemet themelore. U fillua me përgatitjen e mësuesve nga radhët e rinisë me arsimim të mesém jo të plotë, të cilët pas përfundimit të kurseve u emëruan si mësues të rregullt. Gjatë pushimeve verore mësuesit vijonin seminaret tremujore. Në periudhën ndërmjet viteve 1945-1962 përmes seminareve dhe kurseve u aftësuan 523 mësues. Atëherë u paraqit nevoja për hapjen e institacioneve në të cilat do të përgatitej kuadri arsimor. Në këtë drejtim, me hapjen e kurseve për mësues, hapen edhe paralelet e para pranë shkollave normale. Nevoja e madhe ka kërkuar që të hapet edhe shkolla e parë normale shqipe në Shkup. Po ashtu hapen paralele për mësues pranë gjimnazeve të Tetovës, Gostivarit dhe Kumanovës.  
Kuadri arsimor për mësim klasor është përgatitur edhe në akademitë pedagogjike.
6. Në periudhën e pasluftës u botuan apo u përkthyen një numër i madh tekstesh për shkollat fillore në gjuhën shqipe. Vetëm në vitin shkollor 1973/74, në gjuhën shqipe u botuan 46 tekste me tirazh prej 949.000 ekzemplarë.
7. Planprogrami mësimor për shkollat fillore në Maqedoni u miratua zyrtarisht në fillim të vitit shkollor 1945/46, i cili viente edhe për shkollat fillore shqipe. Ndërkaq, për historinë e shkollës shqipe më i rëndësishëm është Programi mësimor i vitit 1953, i miratuar në gjuhën shqipe, të cilin e kanë përpiluar pedagogët më të dalluar.
8. Me zhvillimin e edukimit dhe arsimimit fillor u përmirësuan kushtet për shkollimin e nxënësve, sigurimin e teksteve, transportin, ushqimin etj.
9. Edhe përkundër suksesit të arritur në arsimimin dhe edukimin fillor në RS të Maqedonisë, te shqiptarët mbeten të pranishme disa probleme, të cilat, para së gjithash, dalin nga zhvillimi jo i

barabartë ekonomik i disa komunave dhe disa faktorëve subjektivë.



## SUMMARY

The Albanian nationality in the Republic of Macedonia coordinates its status of equality, national emancipation and development in all domains of social life in accordance with the Constitution of Socialist Federative Republic of Yugoslavia and the Constitution of Socialist Republic of Macedonia; then, the laws and statutes of communities and local councils.

The Albanian nationality in Socialist Republic of Macedonia the right of upbringing and education in elementary schools where pupils are taught in their mother tongue; then, teaching in Albanian language on all levels, beginning with kindergarten and elementary school up to the high schools, universities and graduate studies.

In the realisation of the elementary schooling in Socialist Republic of Macedonia, particular results have been achieved in widening the school system, including all the children which should attend compulsory education. Parallelly with the establishment of schools in Macedonian language, the net-work of elementary schools in Albanian language has been developed.

In the academic year of 1945/46 i.e. the first academic year in liberated Yugoslavia, the teaching in Albanian was attained in 142 elementary schools with 15,454 pupils. While the widening of the school net-work with other nationalities in Socialist Republic of Macedonia was rather slow, it was very fast with Albanians. This was particularly stressed in the period of reform preparations because the rapid increasement of the number of pupils as a result of the high birthrate, required rapid expansion of the school net-work.

